

Tetor 2018
Numri: 127
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

*Kurani
Suneti
Uniteti...*

*Parimet
Themelore*



revistaetika



progresibotime

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ

Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Tetor 2018

VITI: XII

NUMRI: 127

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardan Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Çfarëdo pozite që të kemi në jetë, çfarëdo rruge që të kemi përvetësuar në lidhje me marrëdhënien tonë me Islamin, jemi të detyruar të veprojmë me përpikëri në çështjet bazë të të qenët mysliman. Për shembull, një njeri që nuk e ka të saktë akiden/besimin, nuk mund të jetë as dervish, as profesor, as sheh, as nënë, as baba, as biznesmen, as ushtar, as luftëtar dhe as burrë shteti. Për këtë arsye, murshidët e përsosur kanë thënë: "Së pari duhet të rregullosh akiden." Përse? Sepse akide do të thotë kodet themelore të besimit. Ndërsa kodet themelore të besimit Islam do të thonë ta lexojmë saktë jetën dhe gjithësinë, domethënë, ekzistencën tonë në këtë botë. Këto kode janë këndvështrimi themelor. Pra, formën e të lexuarit të jetës dhe universit.

Për shembull, një njeri që nuk e ka përvetësuar siç duhet besimin ndaj Allahut Teala, asgjë të tij nuk mund ta ketë të saktë. Për këtë arsye, pjesa e parë e shehadetit që formon themelin e amentusë së Islamit, fillon me shprehjen e mohimit: "La ilahe – nuk ka zot." Domethënë, Islami sikur thotë: "Së pari pastroje mendjen." Si do të pastrohet? Së pari duhet ta njohësh mikrobin, në mënyrë që të shpëtosh prej tij. Allahu Teala thotë: "Edhe dëshirat e tua mund të bëhen zot. Përpara mund të të dalin faraonë që kanë shpallur se janë zot. Shejtani mund të të kërktojë ta adhurosh. Dashuria mund të të rrëshqasë dhe si rezultat, mund ta duash dikë siç do Allahun. Frika mund të të rrëshqasë, kërkesat për ndihmë mund të të rrëshqasin..." Disiplina e besimit është që të gjitha këtyre t'u thuhet: "Nuk ka zot." Dhe pastaj të arrish te pjesa: "Il-lall-llah – përveç Allahut."

Për shembull, një person që nuk e ka përvetësuar besimin ndaj Ahiretit, pothuajse e ka të pamundur të realizojë një ecje me harmoni në jetë. Nëse një njeri nuk e ka vendosur "disiplinën e Ahiretit" në qendrën e jetës së kësaj bote, nuk mund të ketë ndjesinë për t'u mbrojtur nga gabimi ngaqë nuk e ka të gjallë vetëdijen se do të japë llogari për çdo veprim të tij.

A mund ta kuptojë mjaftueshëm një person që nuk i ka caktuar saktë lidhjet me Muhamedin (s.a.s.), se si mund të përfaqësohet në formën më të bukur Islami në personalitetin e një njeriu? A është e mundur që një njeri, i cili nuk e ka bërë vath në vesh fjalën e Allahut, të bëjë një hartë të saktë për rrugën? Le të bëjmë një pyetje pak më të qartë: Si mund të zbatohet Islami pa pranuar të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), si prijës? Si mund të zbatohet Islami pa e pranuar Librin e Allahut?

Amentuja është besim ndaj Fuqisë që ka vendosur për krijimin tënd, për shpërnguljen tënde nga kjo botë, për frymëmarrjet e tua dhe e cila është sundimtarja absolute e planit të kaderit. Balanca është amentuja. Balanca është Kurani Fisnik. Balanca është i Dërguari i Allahut (s.a.s.).

Gabimet që njeriu bën në jetë burojnë ose nga mosnjohja e balancës, ose nga pamundësia për ta shndërruar balancën në disiplinë të jetës, ose nga përpëlitja në furtunat e kësaj të fundit.

A e njohim mjaftueshëm akiden tonë ne si myslimanë? Për shembull, a kemi marrë ndonjë edukim akideje që çdo bazë e besimit të ketë mundësinë të funksionojë deri në botën tonë të brendshme? A kemi marrë ndonjë edukim të shëndoshë për Kuratin Fisnik ne si myslimanë? A e kemi mësuar rrokje-rrokje jetën shembullore të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), ne si myslimanë? A ndjejmë dashuri për atë? A kemi marrë ndonjë edukim që t'i shndërrojmë në mish e kocka tonat sjelljet e tij të shkëlqyera? Të qenët dervish ka lidhje më vullnetin për ta tërhequr veten në disiplinën e adhurimit. Vallë, a e dimë fikhun, domethënë, ai i dimë gjërat që janë pro dhe kundër nesh në fe?

Përmbajtja

Fluturimi i Chagall-it
Edison Çeraj

14



8



Rregullat e këndvështrimit tonë Islam
ndaj jetës dhe ngjarjeve
Dr. Adem Ergyl

وَمَا ارْسَلْنَاكَ

A mund të zihet me baltë
ai diell udhëzues?
Osman Nuri Topbash

34




12

22



Shpresa është energjia
e jetës sonë në besim
Nuredin Jelldez

- 5 Ndjeshmëria ndaj balancës
Ahmet Tashgetiren
- 10 Karvani i pafundësisë
Idris Arpat
- 12 Kohezion dhe inkoherencë
Nuredin Nazarko
- 16 Dijetarët e rremë të fesë
Prof. dr. Sulejman Derin
- 18 Dy mirësi të rëndësishme
Xhafer Durmush
- 20 Të qenët i hapur ndaj ndikimit
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 24 Fuqia e fjalës
Idris Arpat
- 26 Do të kalojë edhe kjo
Ibrahim Bozbeshpamak
- 28 Përse presim gjithmonë?
Xhihan Tashtan



46

- Burri i moshuar dhe nipi 29
Urtësi
- Vërtetimi që erdhi pas 100 vjetësh 30
Muaz Erdem
- Një Ajet-Një Hadith 32
- El-Muizz - El-Mudhil 40
Ilir Hoxha
- Kultura e televizorit 45
Zahit Genç
- Konservatorizmi 46
Murat M. Aliu
- Detyrat e rinisë myslimane 50
Ferit Piku
- Gratë punëtore që ndodheshin
pranë Pejgamberit (a.s.) 54
Melike Shahan
- Të jesh zonjë në një familje 56
Zahide Topçu

42



Mangësia e vërtetë
është në trup apo në shpirt
Ali Riza Temel

I thoni stresit: Një "coffee break" ju lutem!
Aishe Kurudere

49



Ndjeshmëria ndaj balancës

— Ahmet Tashgetiren —

Kur nxelemi, na ndryshon natyra dhe e humbasim ekuilibrin. Kur hyjmë në luftë, e humbasim balancën. Kur përjetojmë kontradikta interesash, e humbasim qetësinë. Kur torturohemi apo na bëhet padrejtësi, e humbasim ekuilibrin. Kur japim vendim në lidhje me ndonjë të afërmin tonë dhe në lidhje me ndonjë rival tonin, e humbasim ekuilibrin. Kur përjetojmë ndonjë ngjarje të gëzueshme, e humbasim ekuilibrin. Kur bëhemi dervishë, e humbasim jetën. Kur bëhemi luftëtarë, e humbasim xhihadin.

Një herë ambasadorët perëndimorë e pyetën kryetarin e Entit për Çështjet Fetare të Turqisë, Prof. Dr. Mehmet Gërmezin: “Në cilën shkollë marrin mësim këta njerëzit e ISIS-it?” Ai iu përgjigj duke nënkuptuar burgun Ebu Gurejb, që u ndërta pas pushtimit të Irakut: “Në universitetin

tuaj, Ebu Gurejb.” Aty kanë ushtruar aq shumë tortura çnjerëzore ndaj grave dhe fëmijëve sa që njerëzve nuk u ka mbetur mundësi ta ruajnë ekuilibrin.”

Edhe kur rusët e shkatërruan Groznin, bënë tortura çnjerëzore. Për shkak të kësaj, në atë periudhë lindi “lëvizja e rezistencës” që do t’i merrte peng fëmijët rusë. Tmerri izraelit që ushtrohet në Palestinë ka hapur kohën e sulmeve kamikaze që nganjëherë kanë në shënjestër edhe civilët. “Ekuilibri Islam? Kur ndërton natyra, mund të tjetërsohet edhe ekuilibri islam.”

Umeri (r.a.), ka thënë: “Ai që nuk i di ligjet tona të tregtisë, të mos vijë në tregun tonë.” Ndërsa Imam Gazaliu ka thënë: “Njeriu që pranon Islamin në mëngjes e ka obligim ta mësojë faljen e namazit kur të hyjë koha e namazit të drekës.”

Sahabët, domethënë, njerëzit që janë edukuar pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe që e rinovonin besimin e tyre me çdo ajet që zbriste, shpesh herë ndjenin nevojë për të thënë: “Ejani të besojmë një orë.” Ata kishin ndjeshmërinë e një besimi që rinovohej gjithmonë kudo që të gjendeshin.

Nganjëherë edhe shkencëtarët dhe mendimtarët myslimanë të shekullit tonë kanë bërë apel në formën: “Përsëri në Islam.” Kjo thirrje u bë si rezultat i dobësimit dhe i prishjes së marrëdhënieve tona me Islamin dhe i humbjes së ekuilibrave.

Dikur patëm thënë se edhe njeriu mund të përjetojë lodhje në fe pikërisht siç nuk mban më edhe metali. Kështu dhamë mendimin: “Nganjëherë mund të lodhet edhe vetë dhikri i njeriut.” Për shembull, ka një panoramë shpirtërore të cilën e shpreh edhe Kurani Fisnik në formën: “Ngrihen me përtaci për të falur namazin.”

Islami është feja e ekuilibrit dhe balancës

Allahu Teala është ai që e vendos ekuilibrin dhe që kërkon mbrojtjen e tij. Ai na e tërheq vërejtjen duke këmbëngulur: **“Mos e shkelni balancën!”** (Rrahman, 7-8)

Balancën nuk duhet ta shkelim as në marrëdhëniet me gjërat, as në marrëdhëniet me njerëzit, shoqëritë dhe gjallesat e tjera. Të qenët familje ka një balancë. Edhe të qenët medhheb, xhemat, shtet, fëmijë, i ri, i moshuar, burrë, grua, drejtor, etj. e ka një balancë. Në cilëndo fushë të jetës që mund të gjendem, çdo pozicion e ka një balancë. Kjo është feja.

Libri i jetës private të çdo njeriu shkruhet sipas zbatimit të këtyre balancave. Për këtë arsye, fenë duhet ta mësojmë në këtë kuptim dhe duhet ta bëjmë disiplinë të jetës. Edhe të mësuarit e fesë është një punë që kërkon mund, edhe të shndërruarit e saj në disiplinë të jetës. Edhe struktura e mendjes sonë duhet të formohet sipas balancave islame. Kjo çështje mbart një rëndësi jetike. Të njëjtën gjë mund ta themi edhe për balancimin e kodeve personale...

Çfarëdo pozite që të kemi në jetë, çfarëdo rruge që të kemi përvetësuar në lidhje me marrëdhënien tonë me Islamin, jemi të detyruar të veprojmë me përpikëri në çështjet bazë të të qenët mysliman. Për shembull, një njeri që nuk e ka të saktë akiden/besimin, nuk mund të jetë as dervish, as profesor, as sheh, as nënë, as baba, as biznesmen, as ushtar, as luftëtar dhe as burrë shteti. Për këtë arsye,

murshidët e përsosur kanë thënë: “Së pari duhet të rregullosh akiden.” Përse? Sepse akide do të thotë kodet themelore të besimit. Ndërsa kodet themelore të besimit Islam do të thonë ta lexojmë saktë jetën dhe gjithësinë, domethënë, ekzistencën tonë në këtë botë. Këto kode janë këndvështrimi themelor. Pra, formën e të lexuarit të jetës dhe universit.

Për shembull, një njeri që nuk e ka përvetësuar siç duhet besimin ndaj Allahut Teala, asgjë të tij nuk mund ta ketë të saktë. Për këtë arsye, pjesa e parë e shehadetit që formon themelin e amentusë së Islamit, fillon me shprehjen e mohimit: “La ilahe – nuk ka zot.” Domethënë, Islami sikur thotë: “Së pari pastroje mendjen.” Si do të pastrohet? Së pari duhet ta njohësh mikrobin, në mënyrë që të shpëtosh prej tij. Allahu Teala thotë: “Edhe dëshirat e tua mund të bëhen zot. Përpara mund të të dalin faraonë që kanë shpallur se janë zot. Shejtani mund të të kërkojë ta adhurosh. Dashuria mund të të rrëshqasë dhe si rezultat, mund ta duash dikë siç do Allahun. Frika mund të të rrëshqasë, kërkesat për ndihmë mund të të rrëshqasin...” Disiplina e besimit është që të gjitha këtyre t’u thuhet: “Nuk ka zot.” Dhe pastaj të arrish te pjesa: “Il-lall-llah – përveç Allahut.”

Për shembull, një person që nuk e ka përvetësuar besimin ndaj Ahiretit, pothuajse e ka të pamundur të realizojë një ecje me harmoni në jetë. Nëse një njeri nuk e ka vendosur “disiplinën e Ahiretit” në qendrën e jetës së kësaj bote, nuk mund të ketë ndjesinë për t’u mbrojtur nga gabimi ngaqë nuk e ka të gjallë vetëdijen se do të japë llogari për çdo veprim të tij.

A mund ta kuptojë mjaftueshëm një person që nuk i ka caktuar saktë lidhjet me Muhamedin (a.s.), se si mund të përfaqësohet në formën më të bukur Islami në personalitetin e një njeriu? A është e mundur që një njeri, i cili nuk e ka bërë vath në vesh fjalën e Allahut, të bëjë një hartë të saktë për rrugën? Le të bëjmë një pyetje pak më të qartë: Si mund të zbatohet Islami pa pranuar të Dërguarin e Allahut (a.s.), si prijës? Si mund të zbatohet Islami pa e pranuar Librin e Allahut?

Amentuja është besim ndaj Fuqisë që ka vendosur për krijimin tënd, për shpërnguljen tënde nga kjo botë, për frymëmarrjet e tua dhe e cila është sundimtarja absolute e planit të kaderit. Balanca është amentuja. Balanca është Kurani Fisnik. Balanca është i Dërguari i Allahut (a.s.).

Si botë islame po përjetojmë përçarje të mëdha. Edhe bota jonë intelektuale dhe shpirtërore po e merr pjesën e saj nga këto përçarje. Për këtë arsye, duhet t'u hedhim edhe një sy balancave të jetës sonë. Pastaj duhet të përpiqemi që të mos biem në anaforën e shndërrimit në të ligjshme të atyre gjërave që janë të paligjshme...

Gabimet që njeriu bën në jetë burojnë ose nga mosnjohja e balancës, ose nga pamundësia për ta shndërruar balancën në disiplinë të jetës, ose nga përpëlitja në furtunat e kësaj të fundit.

A e njohim mjaftueshëm akiden tonë ne si myslimanë? Për shembull, a kemi marrë ndonjë edukim akideje që çdo bazë e besimit të ketë mundësinë të funksionojë deri në botën tonë të brendshme? A kemi marrë ndonjë edukim të shëndoshë për Kuranin Fisnik ne si myslimanë? A e kemi mësuar rrokje-rrokje jetën shembullore të të Dërguarit të Allahut (a.s.), ne si myslimanë? A ndjejmë dashuri për atë? A kemi marrë ndonjë edukim që t'i shndërrojme në mish e kocka tonat sjelljet e tij të shkëlqyera? Të qenët dervish ka lidhje më vullnetin për ta tërhequr veten në disiplinën e adhurimit. Vallë, a e dimë fikhun, domethënë, ai i dimë gjërat që janë pro dhe kundër nesh në fe?

Le të themi se jemi myslimanë të rinj. A i njohim obligimet e Islamit të cilat quhen “zarurati dinijje”? Në cilën shkallë është vendosmëria jonë për të ndërtuar një jetë në të cilën zbatohen kufijtë e Allahut Teala? Të qenët mysliman është punë serioze. Myslimani është një njeri që e merr seriozisht jetën dhe që nuk e shikon këtë botë si lojë dhe dëfrim. Për këtë arsye, myslimani është një njeri që e di nëse është e pastër apo e ndyrë qoftë edhe gjëja më e vogël që mund të hyjë në jetën e tij. Myslimani është një njeri që e di se librin e veprave të tij mund ta shkruajë vetëm ai, që e di se libri i llogarisë së tij mund të mbrohet vetëm nga ai dhe që e di se do të jetë i vetëm kur të merret në

llogari në gjykatën e madhe. Atëherë, kujt mund t'ia lëmë në dorë llogarinë e Mahsherit?

Ne si botë islame po përjetojmë përçarje të mëdha. Edhe bota jonë intelektuale dhe shpirtërore po e merr pjesën e saj nga këto përçarje. Për këtë arsye, duhet t'u hedhim edhe një sy balancave të jetës sonë. Pastaj duhet të përpiqemi që të mos biem në anaforën e shndërrimit në të ligjshme të atyre gjërave që janë të paligjshme... Të gjitha fushat e jetës sonë duhet t'i fusim brenda kornizës së Islamit... Xhihadin tonë duhet ta sitim në sitën e disiplinës së xhihadit të madh...

Sinqeritetin tonë duhet ta shfaqim brenda kornizës që Allahu është i kënaqur. Asnjëherë nuk duhet t'u bindemi krijesave duke kundërshtuar Allahun (xh.sh.). Bashkimin tonë duhet ta formojmë mbi themelin e garës në mirësi dhe duhet ta shndërrojme në bashkim të të sinqertëve e të të devotshmëve.

Nga mëkatet duhet të ikim siç ikim prej shejtanit. Për këtë arsye, nuk duhet të biem në kurthin e shejtanit i cili thotë: “Sidoqoftë Allahu fal.” – dhe nuk duhet të zhytemi në gabime. Në pesë vaktet e ditës duhet të qëndrojmë në audiencën e Allahut Teala dhe ta testojmë qëndrimin tonë prej myslimani. Brenda nesh vazhdimisht duhet të jetojë emocioni për ta marrë veten në llogari. Çdo punë që do ta bëjmë, duhet ta bëjmë duke u treguar të kujdesshëm pa u shkëputur nga vetëdija e nënshtrimit ndaj Zotit (xh.sh.). Nga Kurani Fisnik dhe nga disiplina e jetës së të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilët janë balancat themelore, duhet të përcaktojmë kornizën kryesore dhe të përpiqemi që personalitetet tona t'i formojmë përsëri sipas kësaj kornizë.

Le të mendojmë se nesër mund të marrim ftesën për t'u shpërngulur nga kjo botë dhe pastaj do të dalim në audiencën e Zotit (xh.sh.), bashkë me librin e jetës sonë. Për këtë arsye, duhet t'ia nisim rrugës duke e marrë librin e jetës sonë në krahë me bindjen se është një libër që do të na bëjë të fitojmë kënaqësinë e Allahut Teala.

Zoti (xh.xh.), e bëftë ecjen tonë në këtë botë një ecje që synon arritjen me sinqeritet te Ai! Gjithashtu edhe në botën e përherëshme na bëftë prej atyre që dalin me fytyrë të bardhë në audiencën e Tij.



RREGULLAT E KËNDVËSHTRIMIT TONË ISLAM

ndaj Jetës dhe Ngjarjeve

— Dr. Adem Ergyl —

Për ne si myslimanë që besojmë se Islami është një kushtetutë jete, është krejt normale që këndvështrimin tonë ndaj ekzistencës, jetës dhe ngjarjeve apo, me një thënie tjetër, parimet e besimit, veprat dhe sjelljet tona së pari të na i caktojnë bazat që janë shprehur në Sunetin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.) dhe në Kuranin Fisnik. Fushën që i cakton rregullat e besimit dhe këndvështrimet tona brenda këtyre bazave e quajmë akidja islame. Përgjatë historisë kanë dalë në pah ndryshime në pranimin dhe metodën e të kuptuarit të këtyre bazave për arsye të ndryshme. Këto përjasje të ndryshme kanë pasur ndikim në formimin e fraksioneve dhe medh'hebeve. Ato që u formuan me themele prej dijeje, me një qëllim të mirë dhe me një metodë të drejtë, formuan medh'hebet e vërteta. Ndërsa ato që u formuan mbi një themel politik, vetjak dhe informacion të mangët/të gabuar me nijet të mirë apo të keq, nxorën në pah medh'hebe, tarikate dhe fraksione të humbura e të devijuara. Në themelin e

këtyre dhimbjeve, përçarjeve, fitneve dhe shkatërtimeve që umeti islam po i përjeton nga dje e deri më sot, në shumicën e rasteve gjenden këto probleme që thamë më lart. Ne këtu nuk do të bëjmë analizën e këtyre problemeve. Në vend të kësaj, dëshirojmë t'i rikujtojmë për vete dhe t'jua rikujtojmë edhe juve disa rregulla sipas këndvështrimit të "Ehli Sunetit" që ka fituar aprovimin e shumicës dërmuese të myslimanëve. Kemi nevojë të qartë për dispozitat që vijnë nga burimet hyjnore dhe profetike, në mënyrë që këmbët të mos na rrëshqasin dhe zemrat të mos na devijojnë nga e vërteta.

Në themelin e kësaj rrëmuje që po përjetohet në ditët e sotme, në përgjithësi gjendet humbja e metodës për ta kuptuar fenë në mënyrë të drejtë dhe për ta zbatuar atë në jetë. Njohja me mangësi e shkençës së Usulu'd-Dinit e cila na tregon se kujt dhe si duhet t'i besojmë dhe mosrespektimi i Usulu'l-Fikhut, domethënë, metodologjisë për t'i kuptuar tekstet fetare të cilat na mësojnë se kë dhe si duhet

ta kuptojmë e pastaj ta zbatojmë në jetë, formon një kaos të vërtetë. Ndoshta në ditët e sotme njëra prej detyrave më të rëndësishme të dijetarëve tanë, të cilët janë prijësit e umetit islam, është rishtjellimi i këtyre dy fushave, thellimi në to dhe vendosja para umetit e një harte rruge në të cilën mund të ecë. Sepse njeriut të çdo kohe, me një gjuhë dhe metodë që mund ta kuptojë, duhet t'i shpjegohet se si mund t'i zbatojë në jetë të vërtetat hyjnore.

Ne në këtë shkrim, brenda mundësive të faqeve të revistës, do të përpiqemi të shfaqim një kornizë të këndvështrimit tonë islam ndaj ekzistencës dhe ngjarjeve duke u nisur nga vërtetimet e dijetarëve myslimanë. Në këtë mënyrë, do të tërheqim vëmendjen edhe ndaj gjërave të duhura, edhe ndaj atyre që nuk duhen. Sigurisht se çdo çështje nuk mund ta shqyrtojmë. Për këtë arsye, do të kufizohemi vetëm me çështjet kryesore të cilat i shohim si të rëndësishme për ditët e sotme. Kështu që i lutemi Zotit (xh.sh.), që të na udhëzojë për të më e drejta!

QËLLIMI I KRIJIMIT TONË

Ne nuk jemi krijuar për të derdhur gjak dhe për të shkatërruar mbi sipërfaqen e tokës, por jemi krijuar për ta ndërtuar jetën në formën më të bukur në çdo fushë të saj në përputhshmëri të plotë me fenë e Zotit (xh.sh.) dhe për të adhuroar vetëm Allahun Teala. Urtësia e ekzistencës dhe e vdekjes sonë është arritja e suksesit në provimin për të nxjerrë në pah veprat dhe sjelljet më të bukura. Pra, para së gjithash, për ta njohur në mënyrë të drejtë Allahun e Lartësuar dhe pastaj për të formuar marrëdhëniet tona me të gjitha krijesat në bazë të dijes, urtësisë dhe drejtësisë duke u thelluar dhe zhvilluar gjithmonë në dije dhe urtësi. Dhe së fundi, për të dalë në audiencën e Zotit (xh.sh.), me fytyrë të bardhë si një mysliman që ka arritur gradën e zemrës së shëndoshë e të dëlirë.

ZOTI YNË ËSHTË ALLAHU

Fjala e tevhidit “la ilahe il-lall-llah” formon qendrën e besimit tonë ndaj Allahut Teala. Ajo do të thotë: “Nuk ka asnjë zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Allahut.” Përveç Allahut Teala asnjë genie tjetër e gjallë apo pashpirt, e dukshme apo e padukshme nuk mund të jetë zot në asnjë mënyrë dhe asaj nuk mund t'i bëhet adhurim në asnjë lloj mënyre. Në krye të mëkateve më të mëdha vjen “shirku” që do të thotë t'i shoqërosh Allahut dikë në adhurim. Ata që i bëjnë shirk Allahut Teala nuk do të falen kurrë.

Qenia dhe natyra e Allahut Teala nuk mund të konceptohet në mënyrë të plotë. Ai mund të njihet vetëm me cilësitë që i ka përshkruar vetë në Kuranin Fisnik apo me gjuhën e të Dërguarve të Tij (a.s.). Esmau'l-Husna / emrat më të bukur të Allahut janë korniza më e rëndësishme e dijes që na e prezanton Atë neve. Emri i thellimit në këtë kornizë dhe të ndjerët e kësaj dijeje deri në gradën ilme'l-jakin, ajne'l-jakin dhe hakka'l-jakin është marifetu'll-llah. Ajo është në raport të drejt për drejtë me gradën e pjekurisë shpirtërore. Përveç kësaj, sigurisht që mund të ketë edhe disa nderime të veçanta ndërmjet Allahut dhe robërve të Tij. Vetëm se këto gjendje janë ndjenja të veçanta për njeriun ndërmjet Allahut dhe robit. Ato nuk duhet t'u tregohen të tjerëve ngaqë nuk kanë asnjë lloj detyrimi prej tyre. Për këtë situatë mund të jepen shumë shembuj.

Siç nuk mund të bëhet fjalë për Allahun Teala që të hyjë brenda asnjë krijese, edhe krijesat (pejgamberët, engjëjt, evliatë, etj.) nuk mund të bëhen Zot cilado qoftë pozita e tyre. Robi është rob dhe Zoti është Zot. Këtu janë pikat e rrëshqitjes së këmbëve të shumë njerëzve. Ata që i kanë bërë zota dijetarët dhe murgjit e tyre, i kanë bërë shirk Allahut (xh.sh.).

Autoriteti për të caktuar haramin dhe hallallin i përket vetëm Allahut Teala. Rregullat e sistemit të jetës i cakton vetëm Ai. Nisur nga këto që thamë, dijetarët janë ata që vetëm i shpallin dispozitat hyjnore dhe që i zbulojnë ato me përpjekjet e tyre. Ata mund të gabojnë në ixhtihadet e tyre (në përfundimet që arrijnë si rezultat i studimeve të tyre). Të gabuarit dhe mangësia i përket njeriut, ndërsa përsosmëria i përket vetëm Allahut. Për këtë arsye, nënshtrimi absolut bëhet vetëm kundrejt Allahut (xh.sh.). Në një vend ku kundërshtohet Allahu i Lartësuar, nuk mund të bëhet fjalë për bindje ndaj krijesës.

E gjithë dija e gajbit që ka të bëjë me fushat jashtë perceptimit tonë i përket vetëm Allahut Teala. Asnjë krijesë, duke përfshirë edhe pejgamberët, nuk e njohin gajbin. Por Allahu Teala disa robërve të Tij mund t'u japë të dhëna nga gajbi aq sa dëshiron Vetë.

Allahu Teala është më afër me të gjitha krijesat se vetvetja e tyre. Në këtë kontekst, nuk ka nevojë për asnjë ndërmjetës për t'u lutur Allahut, për ta adhuroar Atë dhe për t'i kërkuar ndihmë Atij. Ndërsa pejgamberëve, dijetarëve, të urtëve dhe të devotshmëve mund t'u kërkojmë që të na e mësojnë adhurimin ndaj Allahut, të na mësojnë që ta bëjmë

atë në formën më të bukur dhe që t'i bëjnë dua Allahut dhe t'i kërkojnë falje për ne. Kjo gjendje nuk është ndërhyrje ndërmjet Allahut dhe rob-it, por është ndihmë reciproke në mirësi e devotshmëri në rrugën për t'u bërë robër prej të cilëve Zoti (xh. sh.), është i kënaqur.

Njeriu besimtar dashurinë më të madhe e ka për Allahun Teala. Asnjë dashuri tjetër nuk duhet ta kalojë këtë dashuri. Të gjitha dashuritë e tjera duhet të sistemohen sipas kësaj dashurie qendrore.

UDHËRRËFYESI DHE SHEMBULLI YNË ËSHTË I DËRGUARI I ALLAHUT (A.S.)

Muhamed Mustafa (a.s.), është peygamberi i fundit që Zoti (xh.sh.), e ka dërguar si mëshirë për të gjitha botët. Ai është si një kandil që shpërthen dritë dhe që është dërguar për ta nxjerrë njerëzimin nga errësirat në dritë me lejen e Allahut. Ai është usvetun hasene / shembulli më i mirë për ata që i besojnë Allahut e Ahiretit dhe që e përmendin shumë Allahun. Detyra më themelore e tij është që t'i lexojë ajetet e Allahut që së pari t'i zbatojë vetë në jetë, që t'ua mësojë njerëzve hallallin e haramin, dispozitat hyjnore e urtësinë dhe që t'i zhvillojë ata me të gjitha cilësitë e bukura duke i pastruar nga të gjitha llojet e ligësive.

Edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), është një njeri, por jo një njeri i zakonshëm. Ai është një njeri që merr shpallje nga Allahu i Madhëruar. Fjalët dhe veprimet e tij janë të edukuara me shpalljen hyjnore, të rregulluara me anë të saj kur ka qenë e nevojshme dhe të mbrojtura. Në këtë aspekt, ai ka qenë i mbrojtur. Nisur nga kjo, bindja ndaj tij është bindja ndaj Allahut (xh.sh.). Kështu ka thënë Zoti (xh.xh.). Besimtarët nuk kanë të drejtë zgjedhjeje kundrejt ligjit që ka vendosur Allahu Teala. Shfaqja e një nënshtrimi të plotë nga besimtarët pa ndërje asnjë vështirësi nga brenda është vullneti i vetë Zotit (xh.sh.).

Asnjë individ dhe shoqëri që thotë se Kurani Fisnik na mjafton duke e lënë jashtë funksioni të Dërguarin e Allahut (a.s.), kurrë nuk mund të jetë mysliman i plotë dhe asnjëherë nuk mund ta ndërtojë civilizimin islam. Fjalët, veprat, morali, gjendjet dhe sjelljet e tij të bekuara do të jenë rregulla dhe dritë për çdo besimtar që do të vijë deri në Ditën e Kiametit. Ana të cilën duhet ta theksojmë është vlera e lajmit të këtyre informacioneve që kanë ardhur deri në ditët e sotme. Përgjatë të gjithë shekujve shumë dijetarë kanë nxjerrë në pah shumë libra të vyer në këtë fushë. Pasi këto lajme, të cilat ne i quajmë sunet dhe hadith, të vërtetohen se i përkasin atij (a.s.), detyra që i takon besimtarit për të bërë

është që t'i zbatojë në jetë dhe të bëjë një jetë më të gjallëruar me to.

Shembulli më i mirë i zbatimit të Islamit është shfaqur nga ana e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Nisur nga kjo, mai është shembulli që duhet ta marrin në zbatimin e Islamit. Askush nuk ka të drejtë dhe mundësi ta kalojë atë në këtë çështje. Përparimi dhe përsosja shpirtërore fitojnë vlerë dhe kuptim në raport me afrimitetin ndaj pjekurisë shpirtërore të Pejgamberit (a.s.).

Ne besojmë se pasimi i Sunetit dhahiri dhe batini i të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili ka qenë i dashuri i Allahut, do të na bëjë të fitojmë dashurinë e Allahut Teala. Ne pranojmë se sunetet dhahiri që kanë lidhje me ibadetet, veprat, moralin dhe marrëdhëniet i mësojmë nëpërmjet dijes dhe veprave, ndërsa sunetet batini / shpirtërore si dashuria ndaj Allahut, frika ndaj Allahut, sinqeriteti dhe modestia i mësojmë nëpërmjet dashurisë. Ai (a.s.), është krijesa më kulmore ndaj të cilës mund të ndjejmë dashuri ndërmjet të gjitha krijesave. Dashuria dhe respekti që kemi ndaj tij, asnjëherë nuk mund t'i afrohet kufirit të shndërrimit në Zot. Ne besojmë se ai është robi dhe i Dërguari i Allahut dhe e nderojmë dhe e duam me këtë cilësi.

Ndarja e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, nga Kurani Fisnik do të thotë mangësi në njohjen edhe të Kuranit Fisnik, edhe të tij, sepse ai është i pari që e ka predikuar Kurani Fisnik, që e ka shpjeguar, që e ka zbatuar dhe që ka poseduar moralin e tij. Të kuptuarit e Islamit që është feja e fundit prej të cilës është i kënaqur Allahu Teala, të zbatuarit e tij dhe shndërrimin e tij në mish e kocka si një civilizim pa e njohur Hz. Pejgamberin, pa e dëgjuar siç duhet dhe pa e mësuar e dëshmuar jetën e tij me dije, urtësi dhe syrin e zemrës, nuk është gjë tjetër përveçse një imagjinatë boshe. Për këtë arsye, rruga e atyre që përpiqen ta shfaqin si të pavlerë apo ta nënvlerësojnë Sunetin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), asnjëherë nuk të nxjerrë te sirati mustekim / rruga e drejtë.

Sipas besimit tonë edhe shefaati / ndërmjetësimi është i vërtetë në Ditën e Kiametit. Besimtarët edhe në Kiamet do ta shohin dhe do ta ndjejnë, me lejen e Allahut, se ai peygamberi i mëshirës me të vërtetë ka qenë i tillë. E vërteta hyjnore që duhet ta dimë në lidhje me këtë çështje është: Askush nuk do të ketë të drejtë ndërmjetësimi pa lejen e Allahut Teala.

KURANI FISNIK ËSHTË LIBRI I JETËS DHE KUSHTETUTA JONË

Kurani Fisnik është fjala hyjnore plot udhëzim, mëshirë dhe begati që Zoti (xh.sh.), ia ka dërguar të gjithë njerëzimit. Ai është koleksioni i të vërtetave

hyjnore që ka arritur deri te ne pa u ndryshuar dhe për të cilin është premtuar që do të mbrohet deri në Ditën e Kiametit. Ai është një libër mrekulli. Edhe sikur të gjitha krijesat të mblidheshin bashkë, nuk do ta bënin dot një libër të ngjashëm me atë.

Ai, siç shprehen disa njerëz, nuk është një libër historik që ka iluminuar një periudhë të caktuar të historisë, por që nuk mundet ta bëjë këtë në ditët e sotme apo në të ardhmen nisur nga dispozitat që përfshin. Dispozitat e Kuranit Fisnik do të mbeten deri në Kiamet.

Disa ajete të tij janë të lehta për t'i kuptuar të gjithë, domethënë, siç shprehet edhe vetë Kurani Fisnik, janë ajete muhkem. Ndërsa disa ajete të tjera, ngaqë nuk mund të kuptohen lehtë me shikim të parë, janë ajete muteshabih që mund t'i kuptojnë në një lloj mënyre apo që mund t'i shpjegojnë deri në një shkallë të caktuar njerëzit që janë thelluar në dije. Veçanërisht ata që kanë sëmundje në zemër dhe që dëshirojnë t'i komentojnë ajetet e Allahut sipas dëshirave vetjake të tyre, më së shumti u drejtohen këtyre ajeteve të grupit të dytë. Nisur nga këto që thamë, tentativat e ditëve të sotme që i lënë jashtë loje të Dërguarin e Allahut (a.s.), selefët e devotshëm dhe dijetarët tanë të vërtetë duke e nisur rrugën me sloganin "myslimanizmi i Kuranit", ndërkohë që nga njëra anë janë rezultati i një mashtrimi vetjak e djallëzor, nga ana tjetër janë një plan cinik i projekteve për ta shkatërruar Islamin dhe mysli-manët. Rezultati i një iniciative të tillë përfundon me shndërrimin në idhull të dëshirave vetjake dhe formon dyshime serioze në kokat e njerëzve dhe turbullim shpirtëror në emër të Islamit.

Këtë çështje nuk duhet ta harrojmë asnjëherë: Ndërkohë që Kurani Fisnik shfaq ndikimin e tij me shërim dhe mëshirë kundrejt atyre që i besojnë plotësisht dhe që dëshirojnë të përfitojnë prej tij sipas metodës së duhur, ai është edhe një libër që ua shton humbjen shumë të padrejtëve që dëshirojnë ta komentojnë atë sipas qejfit të tyre dhe që nuk i afrohen me edukatën dhe nderimin që meriton. Edhe pse të lexuarit e teksteve të përkthyer të Kuranit është i rëndësishëm nga aspekti i formimit të


kulturës së Kuranit, nuk është i mjaftueshëm për ta kuptuar Kuranin dhe për të nxjerrë dispozita për jetën tonë. Përfitimi nga tefsiret e dijetarëve tanë të cilët kanë fituar mendimin e mirë të umetit dhe që kanë punuar me dijen e tyre, duke i pyetur dhe duke mësuar nga ata, është rruga më e saktë. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë duhet të lexohen përkthimet me shpjegime dhe asnjëherë nuk duhet të tentojmë të kemi guximin për të nxjerr dispozita.

Për ta konceptuar Kuranin Fisnik në mënyrën e drejtë duhet të mësojmë shkencat që janë të domosdoshme në atë rrugë apo të gjendemi nëpër mësimet dhe ligjëratat e dijetarëve që punojnë me dijen e tyre dhe që janë të devotshëm.

Thellësitë e kuptimeve të Kuranit Fisnik hapen sipas pjekurisë sonë shpirtërore. Atyre që i afrohen me njet të dëlirë dhe me zemër të dorëzuar, u hapen shumë dritare, sepse ky libër i lartë, siç është udhëzimi për të gjithë njerëzit, është një udhërrëfyes dhe udhëzimi i plotë edhe për ata njerëzit e devotshëm që dëshirojnë ta zbatojnë fenë në mënyrën më të bukur.

Të komentuarit e Kuranit Fisnik jo me qëllimin për t'ju dorëzuar atij dhe për të përfituar prej udhëzimit të tij, por me qëllim për ta shfaqur atë sikur i pranon mendimet e dikujt prej njerëzve, në një aspekt është tentativë për manipulim të ajeteve të Allahut Teala. Apo siç shprehet i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, është një mëkat i madh që e shpie njeriun deri në mohimin e Zotit.

Marrëdhënia e një njeriu mysli-man me Kuranin Fisnik së pari është një besim i fortë dhe pastaj formimi i një miqësie me të nëpërmjet leximeve të rregullta edhe të teksteve, edhe të kuptimeve të tij. Gjithashtu, kjo marrëdhënie është të punuarit siç kërkon ai, zbatimi i plotë i tij dhe shpirja e mesazheve të tij të përhershme te robërit e Allahut sipas mundësisë.



Kohezion &

Qenia njerëzore vërtitet mes kohezionit dhe inkoherencës ndaj parimeve të epërme. Të marrësh një vendim, të bësh një zgjedhje mes kësaj vërtitje dypolëshe është shumë shtypëse. Shtypja që i bën njeriu vetes në këtë rast vjen sa nga vetja, po aq edhe nga forca përjashtuese e shoqërisë ndaj modus vivendi, që nuk i qëndron mirë modelit sundues në shoqëri.

— Nuredin Nazarko —

Qysh në krye të herës qenies njerëzore, që të jetojë si e tillë, i është dashur të jetë në udhën e përpjekjeve që veprimi i jashtëm të jetë në kohezion me brendësinë. Kjo kërkesë thelbësore shtrohet si *conditio sine qua non*, prej parimeve të epërme. Të jetuarit si qenie njerëzore nuk mund të jetë aq i thjeshtë sa edhe mund të duket. Kush nuk ka përjetuar *sforco* të mëdha në ruajtjen e kohezionit, e ka të vështirë të përthithë kuptimësinë e kërkesës për kohezion.

Kërkesa për kohezion nuk vjen në kundërshtim me natyrshmërinë njerëzore. Nuk mund të jetë antipod i saj, në të kundërt do të ishte dërmuese. Kërkesa për kohezion vjen si mundësi e qashtë për të shkuar gjithmonë e në vazhdim drejt përnjështimit të modus vivendi me vetë parimet. Përnjështimi do të ishte çasti më i ëmbël për qenien njerëzore. Në të njëjtën kohë do të ishte çasti fatal për inkoherencën.

Qenia njerëzore vërtitet mes kohezionit dhe inkoherencës ndaj parimeve të epërme. Të marrësh një vendim, të bësh një zgjedhje mes kësaj vërtitje dypolëshe është shumë shtypëse. Shtypja që i bën njeriu vetes në këtë rast vjen sa nga vetja, po aq edhe nga forca përjashtuese e shoqërisë ndaj modus vivendi, që nuk i qëndron mirë modelit sundues në shoqëri.

Shtypja e vetes nga vetja, është shpërfaqje e dobësisë së brendshme për ta manifestuar në sferën publike raportin që ke zgjedhur të ndërtosh me parimet e epërme. Frika e shënjestrimit, shikimit

shtrembër, mospërfilljes dhe përjashtimit nga rrethet shoqërore ku individi është i përfshirë e detyron të shkojë drejt fshehjes së plotë apo të pjesshme të zgjedhjes që ka bërë.

Fshehja e plotë është sfillitëse. Individi shkon drejt një modus vivendi të dyfishtë. Një në fshehtësi për veten dhe një në publik për rrethin shoqëror ku jeton. Ai që rravgon në këtë stil veprimi, kërkon përshtatshmëri shoqërore të vetë parimeve të epërme me atë çfarë parimet e epërme kërkojnë ta sjellin në natyralitet. Në këtë çast ndodh ardhja në skenë dhe bërja bosht qëndror e inkoherencës. Individi riformulon kuptimësitë e parimeve në kohezion me kërkesat e rrethit shoqëror. Riformulimi i kuptimësive duke iu larguar thelbit të tyre rrjedhon me shkulme të fuqishme mbi vetë individin. Vazhdimisht kryen operacione ripërcaktuese të riformulimeve për të legjitimuar inkoherencën. Vorbulla e riformulimeve dhe ripërcaktimeve bëhet e pandalshme. Kjo rrjedhon me dekonstrukcion të vazhdueshëm të botës së brendshme të qenies njerëzore. Akti final i këtij teatri rezulton me shformimin e fytyrës së hershme të individit. Tashmë i duhet të përdorë



Inkoherencë

Inkoherenca me parimet e epërme është sfidë për këdo, jo thjesht dhe vetëm për atë që është përnjështuar me të dhe heziton apo refuzon ta braktisë folenë që ka ndërtuar mbi themele të luhatshme dhe të paqëndrueshme. Inkoherenca është sfidë edhe për atë individ që kohezionin me parimet e epërme e ka qëllimin përfundimtar dhe përmbyllës.

si mbulojë dizenjo maskash që mbajnë vulën e shkërmogjes së fytyrshmërisë. Pritet vetëm ulja e fundit e perdes dhe largimi i publikut.

Fshehja e pjesshme ndoshta nuk e sjell individin buzë humnerës përdhunshëm, por e sjell ngadalë dhe mund të rrokulliset krejt pahetueshëm. Inkoherenca në fshehjen e pjesshme është shpërfaqje e dyzimit të individit mes guximit dhe frikës për t'u shfaqur në publik. Me ç'duket guximi shkon drejt zbutjes nga frika e të marrurit mbi vete të një barre që përshtatshmëria i kërkon ta braktisë. As nuk e hedh dot, as nuk e braktis dot tërësisht. Për rrjedhojë nuk e ka të vështirë të bëhet pjesë e teatrove ku i duhet të marrë përsipër rolin e shpërfillësit ndaj parimeve të epërme. Ky individ mbetet peng i afrimitetit të vakët ndaj parimeve. E gjen të përkulshëm, të lakueshëm kurdo kur e sheh situatën të arsyeshme ose përfituese në favor të interesit personal. Nuk e gjen të gatshëm për të qenë qëndrestar. Nuk e ka për gjë të përzihet me turmën dhe të hedhë edhe gurin ndaj atyre që jetësimin e parimeve të epërme e kanë vetë jetën.

Inkoherenca me parimet e epërme është sfidë për këdo, jo thjesht dhe vetëm për atë që është

përnjështuar me të dhe heziton apo refuzon ta braktisë folenë që ka ndërtuar mbi themele të luhatshme dhe të paqëndrueshme. Inkoherenca është sfidë edhe për atë individ që kohezionin me parimet e epërme e ka qëllimin përfundimtar dhe përmbyllës.

Pse është një sfidë? Edhe individ i që përpiqet të ngërthejë në kohezion modus vivendi me parimet e epërme në raste të caktuara ka inkoherencë, por kjo është momentale. Pjesa më e rëndësishme është se ky individ rigjeneron vazhdimisht kohezionin i bindur se inkoherenca momentale është thjesht një thyerje, që nuk duhet lejuar të zhytet nën shtypjen e inkoherencës së vazhdueshme.

Kohezioni e sjell individin në gjendjen e transhendimit nga pesha e vetvetes dhe e shtypjes së rrethit shoqëror ku jeton. Çlirimi nga frika e panevojshme dhe kompleksive është një realitet që përjeton ky individ. Qëndrestaria është tipike, përtej luhatshmërive që mund të shfaqen aty – këtu. Kohezioni nuk kërkon prej tij antagonizëm të panevojshëm dhe sipërfaqësor me rrethin shoqëror ku gjendet. Ky individ jeton dhe vepron midis njerëzve dhe jo i arratisur prej tyre. Jetesa në kohezion me parimet e epërme kërkon ndryshimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të vetvetes dhe nga këtu shpërhapje valësh bashkëqëndrore.

Ka gjithmonë pak inkoherencë në çdo kohezion, por nuk duhet lejuar kurrsesi të ketë kohezion në inkoherencë.





— Edison Çeraj —

Fluturimi i Chagall-it

“Të fshijmë të kaluarën”, pohonte Malevitch-i, ndërkohë që po në të njëjtën kohë që bëhej kjo thirrje e llojit revolucionar, Marc Chagall-i pikturonte fshatin e tij të lindjes dhe rrëfente tregime të frymëzuara nga origjina e tij hebraike, me personazhe dhe ambiente krejtësisht “pa lidhje” me kontekstin dhe rrymën e kohës në të cilin jetonte.

Surrealistët e patën pranuar si njërin prej tyre, pavarësisht se arti i tij kishte një atmosferë tjetër nga ajo e surrealistëve, qoftë për nga burimi qoftë për nga forma. Chagall-in nuk e bindi asnjë lëvizje avantgardiste e kohës. Ai shoqërohej me shumë personazhe të këtyre lëvizjeve, madje disa syresh i kishte miq. Ndodhte që i pëlqente krijimet e tyre, madje dhe admironte ndonjë, por muza e tij nuk bëhej asnjëherë xhelozë për këtë, sepse dukej që nuk ndikohej. Ai ishte plotësisht i bindur se bota mitike që kishte (ri)gjetur ishte e mjaftueshme, për çdo nevojë ontologjike e për çdo “ritual kalimi”.

Të përsiatësh sot mbi veprën e Chagall-it, në njëfarë mënyre është provë e asaj se vepra e tij nuk resht së rrëfyeri, jo thjesht për jetën e autorit, por mbi të gjitha për kumtin që heq prej nesh qoftë dhe për pak çaste pluhurin e përditshmërisë, duke na ofruar kështu atë që ofron çdo vepër arti: një botë brenda botës, ose një shteg për t'u arratisur nga e zakonshmja.

Kështu, Chagall-i na kujton idenë e dy sferave të shkëputura, që përkojnë, pavarësisht shpërfaqjes si të kundërta. Këtë pikas Gerard Garouste kur shkruan se “qysh nga ky çast arti ndahet në dy sfera të shkëputura, të cilave u korrespondojnë edhe dy praktika në dukje të kundërta, por që duhen konsideruar si plotësuese të njëra-tjetrës. Sfera e parë është ekstroverse dhe përfshin gjithë procedimin artistik të nisur nga Malevitch-i me *Katrori i Zi*, e çuar më tej nga artistët konceptualë: që zhvillohet, përparon nëpërmjet përmbysjeve, fiton

botën, synon tërësinë dhe universalitetin. Sfera e dytë është introverse dhe kufizohet në sipërfaqen e telajos dhe kohën individuale. Pika e takimit dhe njëkohësisht e dallimit mes dy sferave është dora, e cila në rastin e artit konceptual nuk ka asnjëherë përparësi, nisur nga fakti që mbizotëron paraqitja teknike e imazheve. Ideja nuk ka aspak nevojë të burgoset brenda një telajoje, ajo është e vetëmjaftueshme dhe mund të bredhë në të gjithë botën”, pra mund të ndërkallet në çdo medium.

Synimi i Chagall-it është koha e brendshme, jo ajo konvencionale e përfaqësuar nga kalendari dhe ora. Prandaj ai krijon krejtësisht i patrazuar dhe i pajosur nga dinamikat përreth. Ai e laton me qetësi të habitshme figurën që nxjerr nga një rrëfenjë biblike, pa e vrarë shumë mendjen se çfarë i bënte figurës, fjala vjen, dadaizmi apo kubizmi.

Fillimisht ai jeton subjektin, që shpesh është i trashëguar, dhe si i tillë, si rrëfim i zbuluar, vjen gjithnjë si “përmasa e çdo gjëje”, si burim, që gjithsesi, pas ngashënjimit dhe rendjes pas botës (flirti), i rikthehemi pashmangshëm.

Duhet shtuar se Chagall-i jetonte në një kohë ku kishte nisur superioriteti i imazhit mbi fjalën, dhe pikërisht ai kishte arsye që ato rrëfenja të zbuluara t'i përkthente në gjuhën “e re”, atë të imazhit. Qëndrimi i tij nuk ravijëzohej nga përkatësia në një lëvizje artistike të kohës, por nga çfarë ai ishte dhe kishte të brendashkruar.

Figurat e Chagall-it kuvendojnë përpara nesh për një botë të harruar nga trysnia e “rendit të ri”, i cili vjetërohet që në çastin që shfaqet si “i ri”, ndërkohë që bota që gjakon të zbulojë Chagall-i kujtohet edhe duke u harruar.

Kujtesa është zbulësë.

Pse fluturojnë personazhet e Chagall-it?

Origjina e tij hebreje na jep një çelës që duhet ta provojmë. Ideja mbi parajsën tokësore, besimi se parajsa do jetë “këtu dhe tani”, në tokë, ndryshe nga botëkuptimet e tjera monotesite, dihet që është hebraike. Së këndejmi, çdo hap që duhet hedhur, duhet të ketë qëllim ndërtimin e saj, pikërisht “këtu dhe tani”. Kjo shpejton edhe të famshmen “qëllimi e justifikon mjetin”.

Por, me sa duket, personazhet e Chagall-it nuk i besojnë kësaj parajse në tokë, ndaj dhe fluturojnë, duke iu dhënë Qiellit. Ata kanë nevojë të përkasin “diku”, jo “këtu”.

Përveç kësaj, siç e thamë, ai kishte një lidhje të ngushtë me rrëfenjat dhe përrallat¹, dhe dihet se në përralla nuk ekziston ligji i gravitetit.

Personazhet e tij jetojnë një botë “përtej të mirës dhe të keqes”, pikërisht ngaqë fluturojnë.

Nostalgjia dhe ëndrra

Një rabin duke u lutur me një shall të bardhë hedhur shpengueshëm mbi krye. Me një dorë mban lirshëm tespihet me gurë të bardhë, ndërsa me tjetrën shtrëngon sa një pjesë të shallit, e sa një lloj rripi prej lëkure që ka rëndësinë e vet për ritin, ose dëshmi e një “dobëise” gjatë përgjërimit.

Një personazh tjetër i pikturave të tij është një “hebre në të kuqe”, ku, në fakt, vetëm mjekrën ka të tillë; një dorë në jeshile, tjetrën në të bardhë, ndërsa veshjen me një ngjyrë ndërmjet grisë dhe një jeshileje të ftohtë. Shtëpia në sfond, që është aq pranë dhe aq e vogël (le të nisim me nuancat ëndërrore), ajo po: është pothuajse e gjitha e kuqe; një e kuqe që merr e jep me fytyrën e personazhit, e ky i fundit duket krejt i dorëzuar në këtë marrëdhënie.

Te një tjetër pikturë (*Mbi qytet*) shohim një çift që i janë dhënë shajnisë së meditimit, me sy të ngulitur diku, teksa fluturojnë mbi një peizazh mitik. Një qytet i përhimtë që i mjafton e tashmja.

Pastaj vijnë sërish personazhet që fluturojnë, që synojnë arratinë prej kohës dhe hapësirës së mitizuar nga eskatologjia hebraike, e jo për t’u argëtuar.

Pikërisht në një rast si ky mund të themi se ndërthuret nostalgjia dhe ëndrra, ose ëndërrimi. Domethënë, përmasa e nostalgjisë gërshetohet me atë të ëndrës, duke na dhënë mundësinë të përftojmë realitetin që del syresh: i njëzuar e me prirje njëzues.

Nostalgjia që Chagall-i s’e gjykon dot është ngjizja, korrenti ku feks subjekti. Ai i vëren me kujdes bashkëkombësit e tij që jetojnë me të kaluarën, që “lindin pleq”, siç thoshte Kafka; duke ushqyer parajsën tokësore në besim, mendim dhe veprim, sidomos në veprim. Kurse ëndrra është ajo që priret të zbulojë mesazhin e veprës: nevojën themelore për

t’u shkëputur nga e shkuara, që me sa duket mban peng të ardhmen.

Një tjetër vepër është edhe *Ora*, ku pjesën dërrmuese të sipërfaqes e zë një orë muri me lavjerrës. Piktura mbizotërohet nga okra dhe e verdha. Në një cep majtas qëndron dikush ulur duke shikuar nga dritarja, ku shohim se ka rënë nata. Nuk është vetëm ora që të lë përshtypjen e një mbetjeje në vendnumëro, e një gjendjeje pezull, por edhe e gjithë atmosfera (njeriu që i është dorëzuar veçimit) të përcjell bindshëm këtë ndjesi, me një ngulm disi pezmatues.

Te një tjetër vepër shohim një burrë (me siguri hebre) që i bie violinës. Në sfond kemi përsëri një peizazh qyteti të zhytur në një natë të thellë, por që nuk na pengon të shquajmë shtëpitë e mbuluara nga mbretëria e bardhë e dëborës. Nevoja për melodi është e madhe, ndaj dhe burri është aq i njëzuar me instrumentin e tij, që e mban më shumë si një hajmali sesa si një instrument muzikor. Është një veprim që ngjan më shumë me një rit sesa me një shfaqje artistike. Është pikërisht melodia që i mungon atij grumbulli shtëpish të brishta e të pafajshme, që presin përmasën e munguar prej bujtësve të tyre.

Mund të pohojmë se graviteti i artit të Chagall-it qëndron te nostalgjia, si dhe te kurimi i saj përmes ëndërrimit. Ai bëri atë që mund të bënte, duke qenë i vetëdijshëm se arti nuk është qëllim më vete, por një mundësi drejt qëllimit.

Ilustrimi

Ilustrimi i ngjan një rituali nga i cili nuk përmbushesh kurrë, ose me të cilin nuk je asnjëherë i kënaqur. Është një lloj përkthimi i cili ose na e pasuron përjetimin e tekstit, ose na e cungon duke na izoluar brenda sinorëve të sipërfaqes.

Natyrisht që me Chagall-in ka ndodhur e para. Duket sikur teksti që ai ka marrë përsipër të ilustrojë ka qenë i mangët pa imazhin apo imazhet që i ka kushtuar.

Ilustrimet e Chagall-it janë një shpjegim apo interpretim i munguar mbi veprat në fjalë, siç është rasti me fabulat e *La Fontaine-it* dhe me romanin *Frymë të vdekura* të Gogolit.

Këto ilustrime janë rileximet e tij si shtigje të pashkelura mes fjalës dhe imazhit; si dy botë që në këtë rast plotësojnë njëra-tjetrën, e ngjashme me marrëdhënien midis dy gjinive.

Në fakt, vetë termi “ilustrim” ka diçka që nuk shkon, ka një lloj mangësie, që ne e përligjim me forcën e zakonit, me një konvencion lehtësisht të zhbëshëm me anë të një të vërtete të thjeshtë: ai që ne etiketojmë si ilustrim në këtë rast është një vepër e mëvetësishme arti, ashtu si vetë teksti, po aq sa vetë teksti.

Çdo krijues, në thelb, nuk është gjë tjetër vetëm se një përkthyes/ilustrues i një ideje apo gjendjeje që i zbulohet, e cila e shtrëngon (ethet e krijimit) që t’ua përcjellë atë edhe të tjerëve.

1. Për shembull, ilustrimi i fabulave të *La Fontaine-it*.

DIJETARËT *e rremë* TË FESË

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Përgjatë gjithë historisë, në planin shoqëror për çdo gjë të mirë dhe të vlefshme ka dalë edhe e kundërta e saj. Krahas peygamberëve, evliave dhe dijetarëve që janë burimi i krenarisë së njerëzimit, janë shfaqur edhe peygamberë të rremë, shehlerë dhe dijetarë të rremë të fesë. Gjithashtu, gjithmonë janë shfaqur shfrytëzues të çdo lloj profesioni të pranueshëm në shoqëri si në mjekësi, ushtri, inxhinieri etj. Për këtë arsye, populli ynë e ka përmbledhur këtë çështje në një formë mjaft të urtë:

“Gjysmë doktori të merr jetën, gjysmë hoxha të nxjerr prej feje.”

Kompensimi i mashtrimit në çështjet materiale mund të gjendet në një lloj mënyre, por ata që mashtrohen në çështjet fetare, Allahu na ruajttë, mund të marrin ndëshkimin e përhershëm. Për këtë arsye, të mëdhenjtë e mistikëve, për t'i mbrojtur myslimanët e sinqertë, i kanë shpjeguar deri në detaje cilësitë e mashtruesve në përrshpirtje, veçoritë e sufive të vërtetë dhe veçoritë e sufive që i mashtrojnë njerëzit se gjoja janë mistikë. Të mëdhenjtë e tasavufit kanë qenë shumë autokritikë. Ata kanë vepruar me shumë ndjeshmëri e përpikëri në mbrojtjen e dëlirësisë së rrugës së tyre. Sipas mistikëve, ata që do të marrin ndëshkimin më të madh në Ahiret do të jenë ata që e përdorin fenë për interesa të kësaj bote dhe për të fituar fuqi. Imam Rabbani thotë në lidhje me këtë çështje:

“I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë: “Ata që do të ndëshkohen më së shumti prej njerëzve në Ditën e Kiametit do të jenë dijetarët që dija nuk u ka bërë ndonjë dobi.”¹ Sepse ata, gradën e dijës, e cila është gjëja më e vlefshme te Allahu Teala, e shndërruan në një mjet për të siguruar interesat e përkohshme të kësaj bote si pasurinë, pozitën, partnerin, mikun etj. Ndërkohë kjo botë është diçka shumë e pavlefshme te Allahu Teala. Ta shohësh si të lartë atë që është e ulët dhe ta shohësh si të ulët atë që është e lartë te Allahu është një krim shumë i madh. (Letra e 33-të.)

Sipas mistikëve, nëse ka ndonjë cilësi të ulët që nuk i shkon aspak një pasuesi të tasavufit është dashuria ndaj kësaj bote, sepse synimi i tasavufit është që ta shpëtojë njeriun nga dashuria ndaj kësaj bote provizore. Për këtë arsye, mistikët nuk mund të gjenden në vende ku më së shumti flitet për punët e parave dhe të dirhemëve. Ahmed Jaseviu i përkufizon si më poshtë këta lloj njerëzish që çdo gjë e bëjnë për para: “Shehlerët e rremë



1. Et-Taberani, es-Sagir, nr: 507.

kërkojnë vazhdimisht dhe me pangopësi gjëra prej muridëve të tyre... Ata u vijnë rreth e rrotull muridëve në një formë të ulët dhe duke rënkuar. Në këtë mënyrë marrin ndihmë nga muridët. Nëse muridët nuk u falin gjë dhe nuk i ndihmojnë, zihen me ata dhe u thonë: “Unë u mërzita. Edhe Zoti është mërzitur.”² Këta njerëz që Hz. Ahmed Jeseviu i ka përkufizuar në këtë mënyrë, kanë dalë në pah në periudha të afërta dhe duke e përdorur dashurinë e myslimanëve për t’i shërbyer Islamit, kanë abuzuar me paratë e tyre. Fjala “zihen” që ka përdorur ai është e rëndësishme për të treguar se deri në çfarë përmasash mund ta çojnë çështjen mashtruesit e fesë kur bëhet fjalë për interesat vetjake të tyre.

Ndërsa një cilësi tjetër e prijësve të rremë fetarë është se ata i hapin rrugë përjetimit të kënaqësive e dëshirave vetjake, në vend që t’i hapin rrugë zbatimit të fesë dhe shariatit. Pseudoshehlerët lëre që nuk u vendosin kufij dëshirave vetjake të njerëzve, por i bëjnë ata që të jepen më shumë pas këtyre dëshirave. Për t’i mashtruar pasuesit e tyre dhe për të përfutur sa më shumë prej tyre nga aspekti material, u japin atyre pozitë dhe para, madje u japin edhe fetva për t’i bërë lehtësisht haramet:

“Pseudoshehlerët për të cilët dyshohet se veprojnë sipas dëshirave të tyre vetjake nuk mund të kenë ndikim mbi muridët. Edhe nëse kanë, kjo është vetëm mbështetje për dëshirat vetjake të muridëve. Kjo nuk do të thotë gjë tjetër përveçse errësirë mbi errësirë... Në këtë situatë, siç devijojnë vetë, devijojnë nga rruga edhe muridët që u binden.” (Letra e 23-të.)

Sipas mistikëve, ata që hyjnë në rrugën e fesë domosdoshmërisht duhet të kenë informacion në lidhje me rrugën që kanë hyrë, në mënyrë që të shpëtojnë nga kurthet e shejtanit. Të kuptuarit e shëndoshë të fesë para së gjithash arrihet me një jetë shpirtërore që bëhet brenda kornizës së jurisprudencës islame dhe nën dritën e Kuranit Fisnik e Sunetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Siç ka thënë edhe Imam Maliku: “Kushdo që mëson tasavufin pa mësuar fikun/jurisprudencën islame bëhet zindik/i pafe. Kushdo që mëson fikhun, por qëndron larg tasavufit, bëhet fasik/mëkatar. Kushdo që e bashkon dijen me përshpirtjen, arrin të vërtetën e fesë.”

Zindik do të thotë ai që del nga feja ndërkohë që mendon se është mysliman. Ndërsa fasik do të thotë ai që bie në mëkat. Domethënë, nëse dikush

që hyn në një grup fetar i ka të mangëta informacionet e fikhut dhe akides, mund të dalë lehtë nga rrethi i Islamit. Shkaku kryesor i vështirësive që po përjetojnë në ditët e sotme është e vërteta se ata që dëshirojnë ta zbatojnë fenë nuk kanë njohuri në lidhje me shkencat fetare. Kjo gjendje ka arritur deri aty saqë haramet mund të pranohen lehtë si hallalle në emër të fesë dhe liderët apo udhërrëfyesit tanë, të cilët si detyrë bazë kanë mbartjen tonë të Hz. Pejgamberi, e kanë kaluar edhe Pejgamberin (a.s.). Ndërkohë, nëse njihet plotësisht akidja e Ehli Sunet ve’l-Xhematit, myslimani mund të shpëtojë lehtësisht nga çdo lloj mendimi ekstrem.

Sipas dijetarëve e rëndësishme është që të zbatohet sheriatit. Përderisa jeta e njeriut të jetë në përputhje me fikhun, domethënë, me Kuranin dhe Sunetin, mosshfaqja e ndonjë zbulimi apo kerameti nuk është mangësi. Në lidhje me këtë çështje, Imam Rabbani transmeton këtë fjalë të Haxhe Ahrarit:

“Nëse na jepet çdo lloj gjendjeje shpirtërore, por bota jonë nuk është në përputhje me besimin e Ehli Sunetit, të gjitha ato gjendje nuk i konsideroj gjë tjetër përveçse torturë dhe humbje. Ndërsa pasi të jem në përputhje me besimin e Ehli Sunetit, kurrë nuk mërzitem nëse ngelem i privuar plotësisht nga gjendjet (e tilla mistike).”

Si përfundim, mashtrimi i njerëzve duke përdorur fenë nuk është një ngjarje e re që ka dalë në pah vetëm në kohën e tanishme, por përgjatë gjithë historisë ka pasur njerëz të tillë që e kanë bërë këtë vepër të ulët. Krahas kësaj, ata që i tregojnë si të këqija të gjitha grupet fetare duke u nisur nga disa shembuj negativë, nuk veprojnë me nijet të mirë. Si mund t’i shohim si të dëmshme mejtepet shpirtërore që kanë edukuar shumë miq të mëdhenj të Allahut si Abdulkadir Gejlanin, Bahauddin Nakshibendin, Mevlanën, Junus Emrenë dhe Akshemseddinin! Në kohën e tyre kanë dalë edhe shumë pseudoshehlerë të cilët janë përpjekur të kalojnë nga pozita e shehut për te pozita e mbretit. Por as shteti, as populli në atë periudhë nuk hoqën dorë nga rruga e tasavufit duke parë këta shembuj të këqij. Me një thënie tjetër, halli i atyre që thonë ta djegim jorganin për një plesht, në fakt nuk është pleshti, por është përçmimi i të zotit të shtëpisë. Allahu Teala i mbrojtë të gjithë myslimanët nga udhërrëfyesit e rremë dhe e shtoftë numrin e dijetarëve të vërtetë të fesë!

2. Fakrname, fq. 74.



DY MIRËSI TË RËNDËSISHME

— Xhafer Durmush —


Sot dëshiroj që suren Kurejsh ta lexojmë përsëri. Në këtë sure thuhet: “(Shkatërrimin e njerëzve të elefantit Allahu e bëri) **për të mbrojtur fisin Kurejsh, për t’i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë. Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie** (Qabes), **i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike.**” (Kurejsh, 1-4)

Me anë të kësaj sureje, fisit Kurejsh në veçanti dhe besimtarëve në përgjithësi u kujtohet kjo: Dhënia e kushteve që sigurojnë jetën dhe sigurimi i mbrojtjes për ta vazhduar atë duke e shpenzuar në paqe, e bën të detyrueshëm adhurimin ndaj Allahut Teala, i Cili i ka falur këto. Ky falënderim dhe adhurim i Allahut vjen në krye të mirësive, sepse feja jonë sublime i konsideron si domosdoshmëri të jetës së njeriut jetesën në siguri duke u plotësuar nevojat themelore dhe lirinë për të shkuar ku të dëshirojë njeriu. Në këtë mënyrë ka treguar se zhvillimi intelektual dhe shpirtëror do të përparojë pasi të plotësohen këto nevoja themelore. Nisur nga këto, Allahu i Lartësuar e ka njoftuar popullin e kurejshëve për obligimet e tyre ndaj Tij pasi ia kujton mirësitë që ia ka dhënë dhe të cilat i përmendëm më sipër, sepse njerëzit përpiqen t’i zbatojnë detyrimet e besimit, të mendoj-

në për të hedhur hapa në zhvillim të trashëgimisë kulturore dhe t’u drejtohen aktiviteteve që kërkojnë akumulim intelektual dhe përkushtim shpirtëror vetëm pasi të sigurohen kushtet jetike.

Para së gjithash, le ta themi këtë: Ne jemi të obliguar t’i mendojmë në një kuptim të gjerë detyrat për të qenë rob ndaj Allahut Teala në një mjedis në të cilin gjendet baza për të cilën flitet në suren Kurejsh. Ne jemi të obliguar të veprojmë me vetëdijen se adhurimi që përmendet këtu nuk përbëhet vetëm nga kryerja e ibadeteve që janë farz. Për shembull, duhet t’ia dimë vlerën paqes dhe sigurisë, duhet ta ndjejmë veten përgjegjës për mbrojtjen e këtyre, duhet të jemi të zgjuar kundrejt kurtheve të ndryshme që tentojnë ta prishin bashkimin dhe unionin tonë dhe duhet të mendojmë shumë se çfarë mund të bëjmë për vëllezërit tanë në fe në gjeografinë tonë shpirtërore...

Krahas këtyre, nuk duhet të harrojmë se vendosja e paqes dhe sigurimi i mirëqenies nuk janë qëllime përfundimtare, por përkundrazi janë mundësi që e plotësojnë jetën e ibadetit dhe të nënshtimit ndaj Zotit (xh.sh.), me një prehje të plotë, sepse, në momentin kur njeriu ta pandehë mundësinë/



mjetin si një qëllim, fillon të devijojë nga rruga. Për këtë arsye, mirësitë që ia ka dhënë Allahu Teala, fillojnë ta llastojnë. Për shkak të kësaj, fillon ta harrojë se qëllimi i ekzistencës së tij është nënshtrimi ndaj Allahut dhe adhurimi i Tij.

Surja Kurejsh i kujton njeriut të sotëm që po sprovohet me mirëqenie, përgjegjësinë e adhurimit e cila është e rëndë, por edhe aq e nderuar. Më i rëndësishëm se të gjithë është fakti që kjo sure na tregon se një jetë shoqërore të sigurt dhe në paqe mund ta formojmë vetëm duke e mbajtur të gjallë “vetëdijen e adhurimit”. Kjo është gjëja që duhet të kujtojmë edhe sot. Domethënë, ne kemi përgjegjësinë për të treguar se Islami është ndërtuesi i një jete shoqërore me paqe dhe garantuesi i saj. E vërteta është kjo se Islami e ndalon padrejtësinë. Ai i urdhëron të gjitha mirësitë që quhen “ma’ruf”, i ndalon të gjitha ligësitë që përmblihen me fjalën “munker”, inkurajon për bashkim dhe e sheh si të papranueshëm egoizmin. Në këtë mënyrë, i jep rëndësi një jete sociale me nivel të lartë që funksionon me drejtësi pasi është ndërtuar mbi vëllazërinë dhe virtetet që i plotësojnë të gjitha këto që thamë.

Feja jonë e bukur i jep vlerë dinjitetit të njeriut. Në Kuranin Fisnik vrasja e një njeriu me të padrejtë apo nxjerrja e përçarjes konsiderohet mëkat sikur të vrasësh të gjithë njerëzinë. (Maide, 32) Pastaj thuhet: “Ndëshkimi për vrasjen me qëllim të një besimtari është Xhehenemi i përherëshëm.” (Nisa, 93) I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë në hytben e lamtumirës: “*Siç janë të shenjta*

ditët e haxhit, muajt haram dhe Meka e Nderuar, kështu janë të paprekshme edhe jeta, pasuria dhe nderi juaj.” (Buhari, Megazi, 77)

Po, “ne nuk mund t’i numërojmë dot mirësitë hyjnore që na janë dhuruar”. (Ibrahim, 34) Edhe nëse nuk e ngremë kokën asnjëherë nga sexhdja, prapë se prapë nuk mund ta kryejmë as falënderimin e ndonjëres prej këtyre mirësive. Ne këtu deshëm të kujtonim vlerën e vetëm dy mirësive.

Ato që fliteshin kur u hap fjala në një kuvend për mirësitë që na kujtohen në këtë sure, i bënë përshtypje një vëllait tonë sirian që gjendet si mysafir në vendin tonë. Edhe ne u përpoqëm t’i përmblihdhim me të gjithë mundësinë tonë ato që na kujtohen në këtë sure. Pastaj ai tha: “Gjithmonë duhet t’ua dimë vlerën këtyre dhe t’i ruajmë.” Ligjërata jonë mori fund me lutjen që e përsëriti disa herë: “Allahumme emmin hadhihi’l-bilade daimen / o Zot, bëje të sigurt këtë vend gjithmonë!”

Tani le t’u themi me gjithë zemër “Amin” lutjeve të këtij vëllait tonë dhe shumë të tjerëve si ai. Ne besojmë se mirësitë nuk do të na merren nëse ua dimë vlerën.



Lexo-Mendo!

DERA E BEGATISË

Në suren A’raf thuhet: “*Sikur banorët e atyre qyteteve të besonin dhe të ruheshin prej gjynaheve, Ne do t’u dërgonim bekime nga qielli dhe toka, por ata mohuan, prandaj i dënuam për atë që bënë.*” (A’raf, 96)

Ky ajet fisnik ka zbritur pas disa ajeteve që njoftojnë se disa prej umeteve të kaluara janë sprovuar me disa vështirësi, në mënyrë që t’u zbuteshin zemrat, sepse politeistët mekas e shtuan mohimin dhe kryeneçësinë pas zbritjes së ajeteve në fjalë. Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (a.s.), iu përgjërua Zotit (xh.sh.): “Më ndihmo duke e sprovuar këtë popull zullumqar me thatësirën në kohën e Jusufit (a.s.)!” Kur thatësira që zgjati për vite të tëra i lodhi shumë mushrikët, ata i kërkuan të Dërguarit të Allahut (a.s.), që të lutej. Me begatinë e lutjes së tij ranë shirat dhe zbriti ajeti që ia kemi dhënë përkthimin më sipër.¹

Nga ajeti fisnik kuptojmë këtë: Mëkatet tërheqin zemërimin hyjnor. Ato bëhen shkak për poshtërim në këtë botë dhe ndëshkim në Ahiret për të zotin e tyre. Ndërkohë, në atë që është e begatë gjendet kënaqësia e Atij që e ka dhënë dhe kënaqësia e atij që e merr. Për këtë arsye, bollëku jo gjithmonë është begati.

Në këtë ajet tregohet se dyert e begatisë hapen me besim dhe devotshmëri (duke iu bindur Allahut dhe duke bërë kujdes ndaj zemërimit të Tij). Kjo do të thotë se përderisa ka respekt dhe bindje nga poshtë-lart, do të zbrësë mëshirë dhe begati nga lart-poshtë. Kjo është e njëjtë edhe për marrëdhëniet ndërmjet njerëzve. Nisur nga këto, bindja nuk e lë jashtë funksioni mendjen dhe vullnetin. Mosnjohja e rregullave nuk është liri, përkundrazi, këtu dëshirojmë ta shënojmë se kjo është robëri ndaj nefsu’l-emmare / nefsi që urdhëron të keqen.

1. Buhari, Tefsir, 30, 44.



Të qenët i hapur ndaj ndikimit

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Çdo fe në vetvete posedon një tërësi dhe sistematikë. Për këtë arsye, fetë mund të konceptohen dhe përjetohen vetëm brenda vetvetes së tyre. Të copëtuarit është në kundërshtim me esencën dhe cilësinë e tyre. Fetarët që mund të hyjnë në këtë rrugë (në rrugën e copëtimit të fesë), nuk i pret gjë tjetër përveç se shkatërrimit. Këtë të vërtetë ajetet fisnike e shprehin si më poshtë:

“...Mos vallë, një pjesë të Librit (Teuratit) e besoni, kurse pjesën tjetër e mohoni?! Cilido prej jush që vepron kështu, do të ndëshkohet me poshtërim në këtë jetë, ndërsa në Ditën e Kiametit do të dërgohet në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja.” (Bekare, 85)

Dihet se popujt e mëparshëm, prej të cilëve duhet të marrim mësim të ndryshme, kanë qenë të prishur dhe të paqëndrueshëm nga aspekti i besimit dhe adhurimit. Ndërkohë që prej tyre nuk është kërkuar një çrregullim i tillë, por vetëm njësimi i Zotit (xh.sh.) dhe singëriteti në këtë besim. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: **“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të singërtë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë.”** (Bejjineh, 5)

Të krishterët e përziën besimin e tevhidit dhe adhurimin ndaj Allahut me elemente të tjera dhe e shndërruan në trinitet. Çifutët e “privatizuan” Zotin dhe e bënë karakteristik vetëm për popullin e tyre. Pasi erdhi i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, si një argument dhe udhërrëfyes, i lëshoi ata në një mosmarrëveshje të thellë dhe rivalitet të pakuptimtë. Për këtë arsye, ata u zvarritën drejt një dileme të madhe në ndjenja dhe veprime.

Kjo gjendje e dhimbshme i bëri ata që t'i luftonin myslimanët dhe të përpëliteshin në ndjenjat e padurimit kundrejt tyre. Për shkak të këtyre, tentuan t'u prisnin rrugën myslimanëve.

Ndërkohë që nga njëra anë Zoti i Lartësuar na i shpjegon gjendjet e tyre në Kuranin Fisnik, nga ana tjetër i paralajmëron myslimanët kundrejt rreziqeve që mund t'u vijnë nga Ehli Kitabi për sa i përket karakteristikës dhe virtytit të tevhidit në besim dhe unitetit në shoqëri:

“Thuj: “O ithtarët e Librit! Pse e pengoni nga rruga e Allahut atë që beson e përpigëni ta shtrembëroni (atë rrugë), ndërkohë që jeni dëshmitarë (se kjo është rruga e vërtetë)? (Dijeni se) Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprave që ju bëni!” O ju që keni besuar! Nëse i bindeni një grupi nga ata që u është dhënë Libri, ata do t'ju kthejnë në jobesimtarë, pasi patët besuar. E si mund të mos besoni kur juve ju lexohen shpalljet e Allahut dhe midis jush ndodhet i Dërguari i Tij?! Kush mbahet fort pas (fesë së) Allahut, sigurisht që është i drejtuar në udhë të mbarë. O ju që keni besuar! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!” (Al Imran, 99-102) Për ta arritur një jetë të tillë plot respekt dhe një përfundim të mirë / Husni hatime, bëhet ky apel: **“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani!..”** (Al Imran, 103)

Ky paralajmërim dhe apel që u bëhet myslimanëve për të jetuar me këtë Islam tregon se do të ketë zhvillime negative sa i përket ndikimit nga popujt e mëparshëm dhe ndjekjes së rrugës së tyre. Këto lloj ndryshimesh nga njëra anë tregojnë ndjenjën e padurimit, ekzistencën e përpjekjeve të veçanta dhe të planifikuara dhe ndikimin e tyre te besimtarët. Nga ana tjetër nuk mund të mohohet se ky është rezultati i gjendjes së myslimanëve që janë të hapur ndaj këtij ndikimi.

Paralajmërimi i të Dërguarit të Allahut (a.s.)

Sado që të jenë të prishura gjendjet dhe qëndrimet e Ehli Kitabit / pasuesve të feve të mëparshme, i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, na ka lajmëruar se me kalimin e kohës, për shkak të ndikimit sociologjik, myslimanët do të

përpiqen t'u ngajjnë atyre. Pastaj na ka bërë këtë paralajmërim:

Ebu Said el-Hudriu (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Ju do ta ndiqni pëllëmbë për pëllëmbë dhe hap pas hapi rrugën e atyre që kanë qenë para jush. Madje do ta ndiqni aq shumë sa që nëse ata hyjnë në vrimë të hardhucës, edhe ju do të tentoni të hyni pas tyre.”* Transmetuesi Ebu Saidi (r.a.), thotë: “E pyetëm: A çifutët dhe të krishterët do të jenë ata që do t'i ndjekim kaq shumë, o i Dërguari i Allahut?” Pejgamberi (a.s.), u përgjigj duke shtruar këtë pyetje: *“Kush mund të jetë tjetër përveç atyre?”* (Buhari, Enbija 50; Muslim Ilm 6)

Dijetarët shprehen se ky ndikim negativ dhe imitim nuk do të jetë në kufër, por në mëkate. Shprehjen absolute të hadithit më së shumti e komentojnë me shfaqjet në jetën sociale. Të menduarit se nuk do të jetë shkak për devijim nga aspekti i besimit ndjekja e gjurmëve të të tjerëve deri në këtë gradë, pra deri në prishje dhe mëkate, nuk mund të jetë gjë tjetër përveçse një shpresë dhe dëshirë optimizmi. Domethënë, madhësia e rrezikut kurrë nuk është e vogël apo zvogëluar me komentin “ndjekje në mëkate”.

Fjala “senen” që përmendet në hadithin fisnik do të thotë ecuri, stil i jetës, zakon dhe traditë. Konsiderimi si aftësi, mjeshtëri apo me një shprehje të re, civilizim dhe zhvillim ndjekjen e rrugës apo gjurmëve, domethënë, ndjekjen e formës së jetesës së umeteve të mëparshme si çifutët dhe të krishterët pa i dhënë aspak rëndësi vështirësisë së kësaj qoftë edhe në veprat më të papranueshme si “hyrja në vrimën e hardhucës”, padyshim se është shkatërrim dhe humbje e identitetit dhe personalitetit si individ e si umet. Kjo do të thotë që identitetin e veçantë dhe të lartë që na e ka dhënë Kurani Fisnik dhe Suneti ta ndërrojmë me një identitet të huaj. Asnjë lloj justifikimi nuk është i mjaftueshëm për ta shfaqur si të pranueshëm dhe logjik këtë falimentim dhe shkatërrim. Zgjidhja për këtë është lidhja me Kurantin Fisnik dhe Sunetin në çdo fushë e në çdo kohë, përpjekja për t'u kapur fort pas tyre dhe mbrojtja e identitetit me çdo çmim.

APELI PËR BASHKIM

Ja pra, pikërisht në këtë pikë na del përpara thirrja e Allahut të Lartësuar për bashkim: *“(O ju që keni besuar!) Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani!..”* (Al Imran, 103)

Fakti që Allahu i Lartësuar u drejtohet myslimanëve duke u thënë: *“O ju që keni besuar! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”* – dhe menjëherë pas këtij jep urdhrin: *“(O ju që keni besuar!) Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani!..”*, nxjerr në pah rëndësinë e madhe që ka edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër që

myslimanët të jenë në identitetin original të tyre si myslimanë dhe si rezultat ta ruajnë unitetin në shoqëri.

Pasi Allahu Teala në vazhdimësi të këtyre urdhrave ua kujton mirësitë dhe nderimet e Tij myslimanëve të asaj kohe, u ka treguar atyre dhe si rezultat edhe brezave të myslimanëve që do të vijnë pas tyre rrugën e mbrojtjes së shoqërisë së bashkuar duke u shprehur: *“Le të dalë prej jush një grup/kuadër që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara!..”* (Al Imran, 104)

Funksioni i kuadrit që i theksohet domosdoshmëria e ekzistencës së tij në ajetin fisnik është caktuar me të qenët e tij përfshirës i të gjitha shtresave të shoqërisë në thirrjen për mirësi e në emri bil-ma'ruf ve nehji anil-munker dhe me të qenët e tij në vijën: *“Mbahuni fort për litarin/librin/fenë e Allahut”*. Në ajetin që vijon është urdhëruar që myslimanët të mos bëhen si ata që janë përçarë dhe janë ndarë në çështjen e fesë ndërkohë që çdo gjë është e qartë”. Myslimanëve u është kërkuar që të mos e nxjerrin në plan të parë ndarjen dhe copëtimin duke bërë thirrje për medh'heb, fraksion grup apo diçka tjetër. Për këtë arsye, myslimanët duhet të kenë shumë kujdes që të mos e shndërrojnë si thirrje të xhematëve të tyre shërbimin dhe detyrën e tebligut/predikimit që do të thotë shpirje e Islamit te njerëzit, apo me një shprehje tjetër, informim i robërve të Allahut me fenë e fundit të Tij. Myslimanët para së gjithash duhet të fokusohen te fakti se, për sa njerëz janë bërë shkak që ata të pranojnë Islamin, sepse sihariqi që i Dërguari i Allahut (a.s.), kur i ka thënë Aliut (r.a.): *“Nëse bëhesh shkak që një njeri të arrijë udhëzimin dhe të zgjedhë Islamin, është më e mirë për ty se sa posedimi i pasurisë më të vlefshme të kësaj bote.”* (Buhari, Fedailu'l-as'hab, 9), është në kontekstin fe-besim-umet. Futja e këtij sihariqi në një kornizë të ngushtë dhe tentativa për ta praktikuar në atë mënyrë, sjell probleme serioze dhe lëkundje të mëdha edhe nga aspekti i besimit, edhe nga aspekti i tërësisë, bashkimit dhe fuqisë së umetit ngaqë i zvarrit njerëzit deri në pikën e shenjtërimit dhe të imitimit të njerëzve të cilët nuk janë të mbrojtur nga gabimet /gajri ma'sum. Për sa i përket kësaj pike, rëndësi jetike ka që të bëjmë kujdes, në mënyrë që të mos ndikohemi nga mendimet e miqve të shkuajdesur dhe armiqve tradhtarë, sepse ne jemi të kënaqur me Allahun për Zot, me Islamin për fe dhe me Muhamedin (a.s.), për pejgamber. Ne asnjëherë nuk kërkojmë alternativa për këto vlera. Ne e pranojmë dhe pohojmë se vëllazëria islame është më e lartë, më e mjaftueshme dhe më primare se çdo lloj lidhjeje tjetër.



Shpresa

është energjia e jetës sonë në besim

— Nuredin Jëlldëz —

Shpresa është ushqim edhe për foshnjën, edhe për të moshuarin. Çfarë nuk ka humbur ai që ka humbur shpresën? Ai që humb shpresën, humb edhe besimin, edhe identitetin.

Ne jetojmë me një trup që përbëhet nga mishi dhe kockat. Ato që hamë dhe pimë shndërrohen në mish dhe kocka. Mangësia në ushqim bëhet shkak për rënien apo sëmurjen e trupit tonë. Kjo është e vërteta e dimensionit tonë fizik.

Bota jonë shpirtërore dhe identiteti ynë prej besimtari, i cili është identiteti ynë i vërtetë, qëndron aktiv me vepra të mira dhe adhurime duke filluar që nga besimi. Ndërkohë që ushqimi mban të gjallë trupin tonë, veprat e mira mbajnë të gjallë strukturën tonë shpirtërore.

Ndërsa ajo që e shpëton nga mbytja në jetën e kësaj bote identitetin tonë prej besimtari, i cili është rezultati i përbashkët i trupit dhe shpirtit tonë, është shpresa. Ne kemi sytë që e shikojnë horizontin aq sa kemi shpresë. Kur të na mbarojë shpresa, mund të na mbarojë edhe trupi, madje edhe besimi. Këtë e tregon edhe ajeti i Kuranit Fisnik i cili shprehet: **“Vetëm qafirët e presin shpresën nga mëshira e Allahut.”**

Shpresa është ushqim edhe për foshnjën, edhe për të moshuarin. Çfarë nuk ka humbur ai që ka humbur shpresën? Ai që humb shpresën, humb edhe besimin, edhe identitetin. Të shpresuarit për të marrë frymë edhe një herë tjetër, është emri i shpresës për të qëndruar në jetë. Kjo është kështu për secilën prej mirësive të kësaj bote dhe të botës tjetër. Xheneti dhe çdo gjë që është premtuar prej tij, janë për ta mbajtur të gjallë këtë shpresë. Shpresa te Allahu është esenca e besimit. Falja e namazit të mëngjesit dhe mbajtja e agjërimit të muajit të Ramazanit me shpresën për të hyrë në Xhenet është dallimi i njeriut besimtar.

Rënia dëshmor duke e shpresuar shpërblimin nga Allahu është dallimi i njeriut besimtar. Përpjekja për të lexuar qoftë edhe një ajet më shumë nga Kurani Fisnik është për të marrë një sevap më shumë. Edhe kjo është një shpresë. Falja e namazit farz duke i shtuar edhe dy rekate nafile, do të thotë ta mbash shpresën në gjendje të gjallë. Të njëjtën gjë mund ta themi edhe për haxhin, edhe për zekatin.

Shpresa është energjia e jetës sonë në besim. Siç është e vërtetë se ata që e shkëpusin shpresën nga jeta materiale mund të tentojnë për të bërë vetëvrasje, kështu është e vërtetë se edhe ata që e shkëpusin shpresën në çështje që kanë të bëjnë me besimin tentojnë të bëjnë vetëvrasje shpirtërore. Përpjekja e shejtanit të mallkuar duke na thurur mijëra dredhi për të na larguar nga Allahu, Ahireti, Xheneti dhe mirësitë e tij, duke na hedhur në pesimizëm, me të vërtetë është e tmerrshme. Nëse besimtarët si individë bien në pesimizëm, atëherë si pasojë e kësaj edhe umeti bie në pesimizëm. Çdo lloj bisede apo fjalimi që e nxjerr në pah pesimizmin, ia shteron energjinë besimit tonë.

Ne si shoqëri besimtare jemi të obliguar ta mbrojmë shpresën tonë ndaj Allahut siç jemi të obliguar për t'i mbrojtur xhamitë në lagjen tonë. Mbrojtja e xhamisë dhe mbrojtja e shpresës ndaj Allahut Teala duhet të bëhet çështje e edukimit modern në këtë botë që po vlon nga luftërat. Shpresa jonë ndaj fuqisë së Allahut, ndaj përhershmerisë së fesë së Tij, ndaj të vërtetës se sheriatit do të sundojë dhe ndaj faktit se në Ahiret do të shfaqet drejtësia absolute, duhet të hyjë në veshët tanë si ezanet përgjatë ditës dhe nga aty të zbrësë në zemër.

Nëse themi se njerëzit janë aq sa shpresat që kanë në zemrat e tyre, nuk gabojmë aspak. Ndryshimi ndërmjet shpresës për Xhenetin që kishin të parët e këtij umeti me shpresën për Xhenetin që kanë pasardhësit e tyre është si ndryshimi ndërmjet veprave të tyre.

Shpresat që ata kishin për Allahun dhe Xhenetin dhe besimi që kishin për gjërat që ua premtoi i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, në disa situata u shndërruan në debate filozofike ndërmjet brezave të mëvonshëm. Besimi dhe shpresa që kishte brenda tij ndaj premtimeve besimtari që tha: “Nuk mund të pres për të shkuar në Xhenet qoftë edhe për aq kohë sa të ha këtë bistak.” – është si një thesar që ka humbur në ditët e sotme. Si mund të shihet një njeri që vrapon drejt Xhenetit në një vend ku ka humbur shpresa?

Po të mos kishin shpresa te gjera sahabët e rinj, Allahu qoftë i kënaqur me ta, a mund t’ia dedikonin rininë e tyre përhapjes së Islamit duke ecur nëpër shkretëtirë? Të gjithë prej tyre bënë një jetë sikur e kishin para syve edhe Xhenetin, edhe Xhehenemin. Kur dëgjonin ajetet që flisnin për Xhenetin, ndjeheshin sikur kishin mundësi t’i zgjasnin duart dhe të merrnin një grusht ujë nga lumenjtë e tij. I Dërguari i Allahut, (a.s.), u tregoi atyre për dexhalin. Ata u kthyen pas dhe panë nëse ishte apo jo pas tyre. Kjo tregonte besimin që ata kishin ndaj haditheve që dëgjonin dhe shpresën për realizimin e atyre fjalëve të Hz. Pejgamberit.

Pesimizmi është një gjendje në të cilën e ndjen veten të mbaruar. Kjo është një e vërtetë duke filluar që nga pesimizmi në jetën tonë private e deri te pesimizmi në lidhje me të nesërmen e fesë sonë. Në këtë rrugë duhet të ecim duke u mbushur çdo ditë me një energji të re krahas të gjitha vesveseve të shejtanit. Edhe qendrat që na pompojnë pesimizëm duhet t’i njohim si pika që nuk janë të dobishme për ne.

Shpresa jonë duhet të ecë në të njëjtën gradë me besimin tonë, sepse ne jemi me Allahun. Çdo gjë është e Atij. Edhe dispozitat Ai i vendos. Nëse i besojmë dikujt, ne i besojmë Atij. Për këtë kemi shpresë të plotë. Ne e shohim shpresën si një energji të pashterueshme. Në të vërtetë, e tillë është.

Fuqia e fjalës

— Idris Arpat —

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: **“Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqsas fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, që t’ua vënë veshin. Fjala e keqe është si pema e keqe me rrënjë të shkulura, e paqëndrueshme për ekzistencë. Allahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme në këtë botë dhe në botën tjetër, kurse keqbërësit i shpie në humbje; Allahu bën ç’të dojë.”** (Ibrahim, 24-27)

Fjalë do të thotë thënie që del nga goja, që përbehet nga rrokjet dhe që shpreh kuptim. Ndërsa tajjibe do të thotë fjalë e mirë, e këndshme, e bukur, sublime dhe hallall.

Ndërsa shprehja “fjalë e bukur – e drejtë”, nisur nga natyra e saj, mbart kuptimin e propozimit, mendimit apo të edukimit të dobishëm e të përherëshëm që thërret te e mira dhe e bukura në aspektin moral. Ngaqë secili prej mesazheve të Allahut Teala, nisur nga qëllimi përfundimtar i tyre, përbëhen nga një thirrje e mirë dhe e drejtë në aspektin moral, termi “fjalë e bukur – e drejtë” në të njëjtën kohë tregon edhe mesazhet e Allahut (xh.sh.).

Në jetën tonë të përditshme fjala zë një vend mjaft të rëndësishëm. Njerëzit merren vesh duke folur, ndërsa kafshët duke i marrë erë njëra-tjetrës.

Fjala ndikon te ai që e dëgjon sipas natyrës dhe vlerës së saj. Ndërkohë që fjala e mirë jep ndikim të mirë dhe pozitiv, edhe fjalët e zakonshme japin ndikim të zakon-

shëm. Ndërsa fjalët e këqija e shkatërrojnë dhe e kalbin shoqërinë. Meqë gjendja është kjo, nëse njeriu nuk do të jetë krimbi i njeriut por miku i tij, sigurisht se duhet të thotë fjalë që falin mirësi, shëndet dhe lumturi. Të gjithë e dinë se “fjala e mirë rrjedh si ujë, shëtit nëpër të gjithë botën dhe i gjelbëron të gjitha vendet ku kalon”. Ndërsa përgojimet dhe thashethemet u hapin plagë në zemër dhe ua shkatërrojnë botën shpirtërore si atyre që i thonë, si atyre që i dëgjojnë.

Kurani Fisnik thotë se fjala e bukur ngrihet për te Allahu Teala (Fatir, 10) dhe se ato që e ngrënë janë veprat e mira. Krijuesi i Lartësuar thotë në Librin e Tij: **“Thuaju, robërve të Mi, që të flasin atë që është më e mira...”** (Isra, 53)

Nëse u kushtojmë vëmendje ajeteve fisnike që i kemi dhënë të përkthyer më sipër, do të vihet re se edhe fjala është një ushqim. Pra, është ushqim për mendjen dhe zemrën, sepse fjala e bukur e cila është përngjarë me pemën, nuk është përngjarë me një pemë të zakonshme, por me një pemë frutore. Siç i japin shëndet frutat e mira njeriut, edhe “kelimetu’t-tajjibe / fjala e mirë” i jep njeriut mprehtësi në mendime dhe thellësi e çiltërsi në ndjenja. Gjithashtu i jep edhe mundësinë për të zgjeruar vizionin dhe imagjinatën. Nisur nga kjo, njeriu duhet t’i thotë fjalë me vlerë bashkëbiseduesit të tij sikur të jetë duke e nderuar me fruta të shijshme e jo të kalbura. Njeriu duhet të mos përdorë fjalë që e bëjnë kokën lëmsh, që e ndyjnë zemrën dhe që e ulin nivelin. Si ka thënë hoxha jonë: **“Ngrije fjalën, jo zërin!”** Edhe



i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili ka qenë mëshirë për botët, ka thënë: "...Ai që beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit, ose të flasë mirë, ose të heshtë." Kur ka thënë se "fjala e mirë është lëmoshë", është shprehur se edhe fjala e keqe mund ta zvarrisë njeriun me fytyrë për tokë drejt Xhehenemit. Siç kanë thënë edhe të urtët: "Ka fjalë që ndërpret luftën, ka fjalë që pret kokën."

Fusha e përfshirjes së fjalës është tepër e gjerë. Duke filluar që me Kuranin Fisnik dhe hadithet e të Dërguarit të Allahut (a.s.), të dhënat shkencore, shembujt, historitë, poezitë, aforizmat, fjalët e urta, veprat letrare, etj. të gjitha janë fjalë. Këto aq sa janë ushqimi i ndjenjave dhe mendimeve të njeriut, janë edhe baza për të dhënë vendime të sakta dhe si rezultat, për të bërë një jetë se më të mirë. Edhe shkencat dhe mendimi nuk duhet të bëjnë xhirim në vend, por duhet të zhvillohen paralel me jetën që ndryshon dhe zhvillohet nga dita në ditë. Zoti i Madhëruar na ka mësuar një lutje: "**Thuaj: O Zot ma shto dijen!**" (Taha, 14) Libri ynë i shenjtë shpesh herë thotë: "Ku janë ata që e vrasin mendjen dhe mendojnë?"

Nëse bota islame nuk dëshiron të ngelet pa ushqim, parime e balanca dhe nëse dëshiron të bëhet mëshirë për botët duke marrë për shembull të Dërguarin e Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, atëherë është e obliguar të mos ngopet me dije, urtësi dhe mendim. Ajo duhet të vazhdojë të thotë: "O Zot, ma shto dijen!" – edhe në moshën nëntë vjeçare, edhe në moshën nëntëdhjetë vjeçare. Kështu duhet ta pranojmë këtë.

Ndërkohë që bota përparon dhe shejtani nuk bën pushim, lëreni të ngelurit mbrapa, por edhe qëndrimi standard është një tragjedi. Umeti i Muhamedit (a.s.), është i obliguar të vazhdojë në prodhimin e dijes, mendimit dhe artit. Ai është i obliguar që dijen ta shndërrojë në fuqi dhe fuqinë ta vërë nën urdhrin e besimit për ta praktikuar dhe ruajtur drejtësinë e Allahut Teala në sipërfaqen e tokës. Për këtë është i detyruar dhe i obliguar. Një qëndrim tjetër i kundërt me këtë nuk do të jetë gjë tjetër përveç zvarritje në çdo vend si të poshtëruar apo shkatërrim në dynjanë që e dizajnojnë të tjerët. Ata që nuk i besojnë fuqisë së fjalës dhe që nuk përpiqen për ta forcuar fjalën, detyrohen të dëgjojnë fjalën e fuqisë së dikujt tjetër. Madje këtë do ta bëjnë duke u ulur në gjunjë.

Ne jemi të detyruar ta marrim seriozisht jetën dhe të hyjmë brenda saj me të gjitha fuqitë, aftësitë, brezat, të kaluarën dhe të ardhmen tonë. Kjo çështje nuk ka vend për shaka. Nëse nuk veprojmë me seriozitet, të djallëzuarit na e shkatërrojnë këtë botë të mrekullueshme që na e ka dhënë Allahu Teala

dhe na e nxjerrin për hundësh qumështin që kemi pirë nga nënat tona. Historia është e stërmëshur me shembuj që na e tregojnë këtë të vërtetë.

Miq të nderuar! Siç e shikojmë, fjala është objekt i rëndësishëm. Allahu i Lartësuar ka zbritur fjalën nga qielli në tokë dhe ka dëshiruar që njeriun ta mbajë brenda kufijve të të vërtetës dhe të drejtës. Ai (xh.sh.), nuk ka lejuar që kryevepra e tij të shkojë dëm. Në këtë mënyrë, ka dëshiruar që robin e Tij ta mbajë në vende prej të cilave është i kënaqur në këtë botë dhe në botën tjetër. Këto punë nuk mund të bëhen pa ajetet e Kuranit Fisnik, pa Sunetin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), pa dije, pa urtësi, pa art dhe pa letërsi. Atyre që pandehin se bëhen, jeta u ikën nga duart. "Ose do të punosh fort, ose do të ngelësh duarbosh."

Nisur nga këto që thamë më sipër, të gjithë dynjanë dhe çdo gjë që ka në të duhet ta studiojmë mirë. Atë që na bën dobi duhet ta marrim dhe atë që nuk na nevojitet duhet ta lëmë. Asnjëherë të mos harrojmë se Allahu Teala nuk i ka krijuar pa qëllim mendjet e mëdha dhe zemrat e gjera. Nëpërmjet atyre Ai dëshiroi që njerëzve t'u jepte mirësi dhe ta lartësonte jetën. Mjafton që ne ta dimë se kë duhet të marrim dhe kë duhet të lëmë.

Nëse umeti i Muhamedit (a.s.), nuk ia del mbanë për të arritur pikën kulmore në fjalë, nëse nuk e arrin mirësinë e të kuptuarit dhe të konceptuarit, atëherë do të thotë se nuk do ta arrijë dot një jetë me dinjitet dhe begati. Siç e shikoni, ata që nuk mund t'i bëhen bisht sëpatës, bëhen sëpatë në majë të bishtit dhe e shndërrojnë vendin në lum prej gjaku. A njerëz shumë të kufizuar dhe të shkretë duhej të nxirrte umeti i Muhamedit (a.s.), në vend që të nxirrte burra të dijes, shkencës, mendimit dhe artit? A njerëz zullumçar që presin koka para kamerave dhe që i shpërthejnë në ajër me dhjetëra njerëz që nuk i njohin do të nxirrte kjo fe që fillon me urdhrin: "Lexo!" A nuk kemi bërë gabime shumë të mëdha në ndonjë vend?

Miq të nderuar! Unë mendoj kështu:

Sido që të jenë kushtet, ne duhet të vazhdojmë t'i japim botës njerëzore ushqimet e mendjes dhe të zemrës dhe parime lartësuese e përparuese. Ne nuk po jetojmë në botën e ankesave dhe psherëtimave, por në botën e provës.

Kush nuk dëshiron të shkojë drejt varrit duke jetuar ditë të mira e të begata? Të qenët mëshirë për botët nuk është një punë që mund ta bëjnë të gjithë, por një punë që mund ta bëjnë vetëm burrat e vërtetë.

Do të kalojë edhe kjo!

— Ibrahim Bozbeshpamak —

Në ajetin fisnik thuhet: **“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit.”** (Bakara, 155) Sprovat janë masa e sinqeritetit të ajetit “li ja’budun / që të më adhurojnë” (Dharijat, 56), i cili është qëllimi i dërgimit të njeriut në këtë botë. Apo siç thuhet në një shprehje të urtë: “Dallimi ndërmjet Ebu Bekrit dhe Ebu Xhehlit.” Edhe të dërguarit dhe të devotshmit që kanë ardhur para nesh janë sprovuar. Gjithashtu janë sprovuar edhe njerëzit e sinqertë, edhe njerëzit e mirë.

Nuhu (a.s.), u sprovua një mijë vjet me një popull të tërbuar dhe të padrejtë (Nexhm, 52). Populli i tij e mbulonte kokën me anteri, i mbyllte veshët dhe e ndryshonte rrugën me një inat prej fëmijërie kundrejt thirrjes për te Zoti (xh.sh.), që i bënte ai me këmbëngulje fshehurazi dhe haptazi, natën dhe ditën. (Nuh, 5, 7, 9) Nuhu (a.s.), u tradhtua nga pjesëtarët e familjes së tij, pra nga bashkëshortja dhe djali i vet. Ai u gjuajt

me gurë dhe u tall nga populli i tij. Allahu Teala e shkatërroi popullin e pamend me fatkeqësinë e rrëkesë (Kamer, 11, 12), e shpëtoi atë dhe ata që i besuan atij (Shuara, 119) dhe për shkak të durimit të tij, e lavdëroi duke u shprehur: “Paqja qoftë për Nuhun në të gjitha botët.” (Saffat, 79)

Hudi (a.s.), u sprovua me një popull të llastuar. (Fussilet, 15) Pra, me popullin e Adit që mburrej më kopshtet, bahçet dhe shtëpitë e gdhendura nëpër gurë. (Araf, 60, 66) Populli i llastuar u shkatërrua me një furtunë të zhurmshme. (Kamer, 19) Ndërsa Hudi (a.s.) dhe ata që i besuan atij, shpëtuan me mëshirën hyjnore. (Hud, 58)

Salihu (a.s.), u sprovua me një popull të tërbuar. Pra, me popullin e Themudit që bënte një jetë të kënaqshme me burimet, kopshtet, të mbjellat dhe vreshtat e tij. (Shuara, 146-152) Ai u akuzua nga populli i tij me mburrje, mashtrim dhe llastim (Kamer, 25) dhe me fat të keq (Neml,



47). Ky popull i tërbuar u shkatërrua kur tentoi për t'i zhdukur nga faqja e dheut Salihun (a.s.) dhe familjen e tij. (Araf, 78) “Ai dhe ata që i besuan atij shpëtuan me shfaqjen e mëshirës (së Zotit).” (Hud, 66)

Ibrahimi (a.s.), u sprovua me Nemrudin zullumqar. (Bakara, 258) Gjithashtu u sprovua edhe me babain e tij që e mohonte Zotin (xh.sh.) (Merjem, 46) dhe me dashurinë e fëmijës. (Saffat, 112) Ai i kaloi sprovat me mbrojtjen e të drejtës, me trimërinë kundër mohuesve, me ndjeshmërinë në çështjen e namazit dhe të pasardhësve (Ibrahim, 40), me butësinë, me afrimitetin shpirtëror ndaj Zotit dhe me përkushtimin ndaj Allahut Teala. (Hud, 75) (Bakara, 124) Atij iu la një kujtim i mirë dhe iu dha selam deri në Kiamet. (Saffat, 108, 109) Ai u shpërblye me pejgamberët që erdhën nga soji i tij (Jusuf, 6) Po ashtu u shpërblye me të qenët gjysh i Hatemu'l-Enbija, Muhamedit (a.s.).

Luti (a.s.), u sprovua me një popull të pamoralshëm. (Enbija, 74)

Jakubi u sprovua me ndarje dhe përmallim. (Jusuf, 18)

Jusufi u sprovua me robërim (Jusuf, 20), me nder (Jusuf, 23) dhe me burg (Jusuf, 35)

Musai (a.s.), u sprovua me Faraonin e tmerrshëm dhe gjakatar. (Shuara, 27) U sprovua me popullin e tij materialist që e udhëzoi duke e shpëtuar nga Faraoni. (Bakara, 67-69; Ta-ha, 85.)

Isain (a.s.), deshën ta ekzekutonin. (Nisa, 157)

Ka pasur edhe të tjerë që janë vrarë, janë gurrëzuar, janë tallur dhe janë hedhur në gropat me zjarr. Ka pasur prej atyre që janë vënë në pozitë shumë të vështirë, që janë syrgjynosur dhe që janë ekzekutuar. Që të gjithë i kaluan sprovat me armët e shpresës dhe durimit. Dikush prej tyre ra dëshmor dhe shkoi në Xhenet. Ndërsa dikush tjetër prej tyre jetoi dhe e shndërroi botën në një parajsë.

Më shumë fatkeqësi përjetoi i Dërguari i Allahut, Muhamedi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të. Ai u përgënjeshtroi nga populli i tij si një pejgamber pa baba dhe pa nënë. Atë e gjuajtën me gurë në Taif. U bojkotua në Shibi Ebu Talib. Në rrugën e tij u hodhën papastërti dhe ferra. Shokët e tij të zgjedhur u rrahën me

kërbaç. U sulmua në Bedr, Uhud, Hendek dhe Hunejn. Humbi fëmijët dhe shokët e kauzës. U përzu nga vendlindja dhe u tradhtua, por asnjëherë nuk hoqi dorë nga rruga e tij dhe bëri durim. Gjithmonë shpresoi dhe fliste për çlirime të mëdha edhe pse kishte pranë vetëm 3-5 veta. Këtë e bëri edhe në ditën e Hendekut kur të gjitha ushtritë e ligësisë po vinin për ta sulmuar. Njerëzit e injorancës që i kishin përlyer duart me gjak dhe që betoheshin për ta vrarë njëri-tjetrin, me udhëzimin e tij arritën një pjekuri të madhe në mirësjellje. Në këtë mënyrë, u themelua civilizimi i virtyteve.

Tashmë le të vijmë te ditët tona: Në të katër anët e botës islame ka gjak dhe lot. Numri i muhaxhirëve thuhet se është me miliona. Vendet islame që po digjen, nuk dihet se kujt po i shërbejnë. Vazhdimisht ka bomba që shpërthejnë, të shtëna armësh që nuk pushojnë asnjëherë dhe britma për ndihmë. Me qindra mijëra zemra të vogla kanë ngelur jetimë. Zemrat myslimane po akuzohen për terror, pra, islamofobia po ekzagjerohet dhe po mbahet në rend të ditës nga armiqtë duke u vlerësuar si një mundësi e vyer për ta. Edhe ne pra po akuzohemi siç kanë qenë akuzuar ata që kanë ardhur para nesh.

Në ditët e sotme janë të njohura ndërmjet nesh “tevekkuli / mbështetja te Zoti (xh.sh.)”, me dembelizëm dhe shprehja e ardhjes së kohës së fundit. Literaturat tona flasin për një klasë që i komentonte dhimbjet e lindjes në periudhën e themelimit të Shtetit të Lartë Osman si përpëllitjet e vdekjes dhe anarkinë e shkatërrimin e bërë nga kryqëzatat e mongolët si shenja të Kiametit. Nga ajo klasë e deri te ditët e sotme kanë kaluar tetë shekuj.

Le të mos bëhemi tellallë të Kiametit! Edhe ne po kalojmë sprovën tonë si ata që kanë qenë para nesh. Nëse durojmë në besimin tonë dhe kapemi fort pas shpresës, edhe ne do të fitojmë siç kanë fituar ata që kanë qenë para nesh. (Al Imran, 139)

Sa shumë peripeci dhe ditë të vështira kanë kaluar besimtarët! Andaj, edhe këto do të kalojnë. Ajo që na takon të bëjmë është që të durojmë me shpresë për ato që na ndodhin duke thënë: “Do të kalojë edhe kjo.”

PËRSE PRESIM GJITHMONË?

— Xhihan Tashtan —

Teksa me duart e tij të vogla po mbante vishnjat që i kishte mbledhur gjyshi, shikoi me kuriozitet sytë e plakur të tij dhe i tha: “Gjysh, përse kemi pritur muaj të tërë për të ngrënë vishnjat? Unë dua që të ha vishnje gjithmonë...” Gjyshi po shikonte larg në horizont, pas degëve të gjelbra... Tashmë pyetjen “Përse presim gjithmonë?” po e dëgjonte nga nipi i dashur, të cilin e kishte pritur për nëntë muaj që të dilte nga barku i nënës e të ndriçonte botën... Përse?... Teksa gjyshi e merrte nipin e vet në prehër, ata po niseshin për një udhëtim nga bota makro për në atë mikro, një udhëtim gjysh-nip...

Prej ku duhet të fillonte? Cili “frut” ishte pritur për herë të parë? Syri i gjyshit shikonte shekujt më përpara, në momentin e parë të filmit tonë, në momentin e krijimit të universit... Për një çast i shkuan sytë tek nipi që po hante vishnje dhe i tha: “Trimi im, thuaj Bismillah. Sepse lulja e parë që lulëzoi në univers dhe fruti i parë që u poq, ishin vetë krijimi i gjithësisë pas ‘bëhu! dhe ajo bëhet.’” (Jasin, 82)

Gjyshi vazhdoi të shikonte buzëqeshjen e skuqur të nipit teksa po i shpjegonte për një pritie që filloi 13,7 miliarda vite më përpara. Shkenca dhe teknologjia vazhdonin të bënin kërkime në lidhje me këtë temë, gjyshi fliste me gjuhën e Kuranit. I tregonte se si qielli dhe toka që kishin qenë të ngjitur, u ndanë prej njëri-tjetrit (Enbija, 30), fliste për miliona vitet kur njeriu nuk ishte krijuar akoma, bile nuk ishte as qenie e denjë për t’u përmendur. (Insan, 1) Më pas kalonte tek kalimi i frytit më original dhe unik, të njeriut...

“A do të dëshiroje që pema e vishnjës të jepte fruta vetëm një herë në dyzet vite?”- pyeste gjyshi...
 “Jo, unë dua që të ha vishnje në çdo stinë”- ngërdheshej nipi. Gjyshi kishte marrë përgjigjen e dëshiruar. “Allahu ka krijuar bimë që çelin lule vetëm një herë në dyzet vite. (Agave Franzosini). Sikur edhe pema e vishnjës të

kishte të njëjtën cilësi, ti do ta shijojë këtë pemë të xhenetit, vetëm një herë në jetë.”

“A i do shumë fluturat?”- ishte pyetja e dytë. Gjyshi e dinte shumë mirë se sa kishte qarë nipi nga hidhërimi i fluturës (Luna moth) që gjeti në oborr e që ngordhi pas disa ditësh. Sa mirë që kishte ardhur vera e mund të vraponte me gëzim pas fluturave. “A e di se Allahu ka krijuar një flutur që lind vetëm një herë në 17 vite dhe vdes brenda pak ditësh? (Cicadas) A do të doje të kaloje plot 17 vite duke pritur fluturat e tua të dashura e pastaj ato të zhdukeshin brenda pak ditësh?” Dukej qartë që nipi nuk e donte një gjë të tillë...

“Ja pra, që prej krijimit të universit, ne i kemi pritur vazhdimisht këto ‘fruta’ të mira e të bukura. Kjo nuk është bota ku mund të kemi çdo gjë. Njeriu që mërzhitet, sepse nuk i plotëson dot disa prej dëshirave të tij, do të mërzhitet përsëri kur dëshira të plotësohet e pastaj të largohet. Pra, kjo botë është njoftim i jetës së përjetshme. Shija e vërtetë e vishnjave që ti mezi i pret, nuk është ajo që të ngel në gojë por shija që të mbet në zemër, ajo që të tregon se kjo që sapo provove është vetëm një shembull i atyre që të presin në një kopsht të pafund. Lulet që çelin për t’u vyshkur pas disa kohësh, janë pëshpëritja e kopshtit të përjetshëm, të atij që nuk vyshket kurrë. Mos u mërzhit nga largimi i fluturave, bukuria e flatrave të tyre është një kujtim i vogël i fluturimit të përjetshëm në bahçen e lumturisë...”

“Do të bëj një pyetje të fundit”- i thoshte gjyshit teksa dielli po perëndonte dhe po përgatiteshin për të shkuar në shtëpi. “Cili është fryti më i ëmbël dhe më i bukur, ai i cili i jep jetë gjithkujt që e provon?” ... E puthi dhe e përqafoi nipin me dashuri... “Ai fryt është Pejgamberi ynë i nderuar (a.s.)... Ai i cili u prit me miliarda vite nga vetë gjithësia. Ai është fryti më i bukur...”



BURRI I MOSHUAR DHE NIPI



Një burrë i moshuar ishte ulur para kasolles së tij bashkë me nipin e vet. Të dy së bashku po shikonin dy qenë që po ziheshin me njëri-tjetrin. Njëri prej qenëve ishte i bardhë, ndërsa tjetri ishte i zi. Këta dy qenë vazhdimisht ziheshin me njëri-tjetrin para kasolles së gjyshit të fëmijës.

Këta ishin dy qenë që gjyshi i fëmijës i mbante gjithmonë pranë. Ndërkohë që fëmija e shikonte të mjaftueshëm vetëm njërin për mbrojtjen e kasolles, nuk po e kuptonte dot mbajtjen edhe të tjetrit. Pastaj ai donte ta kuptonte edhe pse njëri kishte ngjyrë të bardhë dhe tjetri kishte ngjyrë të zezë. Andaj e pyeti me kureshtje gjyshin:

Gjyshi buzëqeshi në një formë prej të dituri dhe i tha:

“Ata janë dy simbole për mua, bir. Simboli i të mirës dhe të keqes. E mira dhe e keqja luftojnë vazhdimisht brenda nesh njëllor si këta dy qenë që po i shikon. Kur i shoh ata, në mendje gjithmonë më vjen kjo që të thashë. Për këtë arsye, gjithmonë i mbaj pranë.”

Fëmija mendoi se nëse ka një betejë, duhet të ketë edhe një fitues. Kështu që i bëri edhe një pyetje tjetër gjyshit:

“Gjysh i dashur! Cili e fiton këtë betejë sipas teje?”

Gjyshi e pa nipin me një buzëqeshje të ëmbël dhe ia ktheu:

“Cili? Ai që e ushqej më mirë, bir!”

NJË THËNIE

“Ata që nuk marrin detyrë në zgjdhje, bëhen pjesë e problemit.”

(Goethe)

NJË LUTJE

“... (O Zot) jepu begati mirësive që më ke dhënë! Më mbroj nga e keqja e gjërave që ke vendosur të bëhen, sepse Ti jep vendim dhe askush nuk mund të thotë gjë për vendimin Tënd!..”

(Tirmidhi, Vitr, 10)

FAKTE INTERESANTE

- Fëmijët rriten më shumë në pranverë.
- Diametri i Diellit është 109 herë më i madh se i Tokës (1.5 milion km). Vëlltimi i Diellit është 1.3 milion herë më i madh se i Tokës. Masa e Diellit është 333.000 herë më e rëndë se masa e Tokës.
- Një plesht mund të hidhet në një lartësi 150 herë më të madhe se vetja e tij. Për ta arritur këtë largësi, njeriu duhet të hidhet afërsisht 30 metra.

Vërtetimi që erdhi *pas 100 vjetësh*

Muaz Erdem

Ajnshtajni i cili na e ka ndryshuar përsëri për-qasjen tonë ndaj gjithësisë edhe tani siç ka bërë edhe para njëqind vjetësh me Teorinë e Përgjithshme të Relativitetit, i ka mahnitur edhe një herë tjetër shkencëtarët me zgjuarsinë e tij tepër të mprehtë. Gjëja më e rëndësishme që bënte ai ishte të imagjinuarit. Uroj që edhe në botën islame, siç ka pas ndodhur edhe më parë, të edukohen përsëri breza që e kanë të gjerë botën e imagjinatës, kureshtarë dhe të etur për dije!..


Çdo trup qiellor që ka masë në hapësirë ushtron forcë graviteti. Madje, edhe një top që mund të kemi në dorë, ushtron forcën e gravitetit mbi Tokën. Kur e lëshojmë topin nga dora, ai bie në Tokë, sepse masa e tokës është shumë më e madhe se masa e topit. Për këtë arsye, fuqia e gravitetit që topi ushtron mbi Tokë as që mund të krahasohet me gravitetin e Tokës.

Në sajë të ligjit të gravitetit të Njutonit, tashmë e dimë se përse topi bie në tokë apo përse Toka rrotullohet rreth Diellit. Por mjetet matëse shumë të përpikta që janë shpikur bashkë me zhvillimin e teknologjisë, kanë filluar të vërtetojnë gjëra që

nuk mund t'i shpjegonte dot ligji i gravitetit i Njutonit. Ligji i Njutonit tashmë gabonte. Njëri prej këtyre gabimeve ishte orbita e Mërkurit. Orbita e Mërkurit nuk mund të llogaritej në mënyrë të saktë me ligjin e Njutonit për shkak të disa devijimeve të vogla të saj. Kjo situatë vazhdoi kështu deri kur doli në pah një burrë që quhej Albert Ajnshtajni.

Në vitin 1915 Albert Ajnshtajni na e ndryshoi për-qasjen tonë kundrejt hapësirës me Teorinë e Përgjithshme të Relativitetit që e zhvilloi. Ajnshtajni tha se trupat e përkulin hapësirën në varësi të masës së tyre. Pikërisht siç e përkul çarçafin një sferë hekuri që mund të vendoset mbi të. Sipas këtij mendimi, topi në të vërtetë nuk tërhiqet nga Toka. Toka e përkul hapësirën përreth saj dhe topi lëviz drejt vendit të përkulur në hapësirë.

Ligji i Njutonit nuk e shpjegon dot edhe ndikimin e dritës nga graviteti, sepse drita është pa masë dhe për këtë arsye nuk mund të pritët që trupat me masë të tërheqin diçka që është pa masë. Ndërsa Teoria e Përgjithshme e Relativi-



tetit e Ajnshtajnit e shpjegon këtë krejt lehtë me përkuljen e hapësirës. Sepse drita ngaqë ecën në hapësirë përkulet së bashku me hapësirën.

Zgjuarsia e mprehtë e Ajnshtajnit përsëri nuk kishte qëndruar rehat. Kështu që në mendje i kishte mbetur një pyetje: Vallë, a në moment apo afërsisht pas tetë minutash do ta ndjenim nëse dielli do të zhdukej? (Koha e arritjes së dritës së diellit në tokë është afërsisht tetë minuta.)

Me anë të teorisë që Ajnshtajni e formoi duke u nisur nga kjo pyetje, hodhi në pah mendimin se forca e gravitetit përhapet në hapësirë në formë dallgësh dhe se këto dallgë përhapen me shpejtësinë e dritës, sepse shpejtësia më e madhe në gjithësi është shpejtësia e dritës.

Edhe pse Ajnshtajni e nxori në pah në vitin 1916 ekzistencën e valëve/dallgëve gravitacionale, vërtetimi i ekzistencës së këtyre dallgëve ishte i pamundur me teknologjinë e asaj kohe. Kjo vazhdoi kështu deri kur u ndërtua Observatori i Valëve Gravitacionale për Matjen e Interferencave me Lazer. Kjo strukturë që emrin e shkurtuar e ka LIGO, përbëhet nga dy dedektorë. Njëri detektor gjendet në Livingston, ndërsa tjetri gjendet në Hanford. Shkaku i parë që gjenden dy dedektorë është parandalimi i matjes së gabuar që mund të bëjë një detektor për shkak të faktorëve mjedisorë. Ndërsa shkaku i dytë është caktimi se nga vijnë dallgët/valët që priten të maten.

Dedektorët që u ndërtuan në SHBA me 14 Tetor morën një sinjal të rëndësishëm nga 1.3 miliard vite dritë larg. Sinjali tregonte valët e mëdha gravitacionale që i formonte në hapësirë bashkimi i dy vrimave të zeza gjigande. Kur ky sinjal u hodh në grafik, po të ishte vetëm një vijë e drejtë, atëherë do të thoshte se valët gravitacionale nuk mund të vëzhgoheshin, por dallgëzimi në grafik vërtetonte ekzistencën e valëve/dallgëve gravitacionale. Ajnshtajni përsëri kishte të drejtë edhe pse pas 100 vitesh.

Padyshim se ky zbulim i mrekullueshëm është zbulimi më i madh në historinë e astronomisë pas zhvillimit që Galileo i bëri teleskopit për të parë trupat qiellor. Në sajë të këtij zbulimi tashmë gjithësinë mund ta vëzhgojmë dhe studiojmë edhe nga rrugë të tjera. Pra, jemi ballë për ballë me një fizikë të re.

Krahas së gjithash, Ajnshtajni i cili na e ka ndryshuar përsëri përqasjen tonë ndaj gjithësisë edhe tani siç ka bërë edhe para njëqind vjetësh me Teorinë e Përgjithshme të Relativitetit, i ka mahnitur edhe një herë tjetër shkencëtarët me zgjuarsinë e tij tepër të mprehtë. Gjëja më e rëndësishme që bënte ai ishte të imagjinuarit. Uroj që edhe në botën islame, siç ka pas ndodhur edhe më parë, të edukohen përsëri breza që e kanë të gjerë botën e imagjinatës, kureshtarë dhe të etur për dije!..

*"Kush është besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet
sinqerisht Allahut, duke qenë bamirës dhe zbatues i fesë
së pastër të Ibrahimit, të cilin Allahu e ka çmuar mik të
ngushtë?!"*

(Nisa, 125)

Një Ajet

Nëpërmjet këtij ajeti, Allahu na bën të qartë se feja e vetme autentike e pastër është feja islame. Besimtari më i mirë në këtë fe, është ai që i dorëzohet Atij me sinqeritet të plotë, duke e besuar si Krijuesin dhe Gjykatësin e çdo gjëje në këtë botë dhe në botën tjetër, duke qenë vepërmirë e i sin-qertë në çdo veprim që kryen. Ky ajet i bën thirrje gjithë njerëzimit në përgjithësi dhe myslimanëve në veçanti, që të mos mjaftohen vetëm me besimin teorik, por t'i dorëzohen plotësisht Allahut, duke zbatuar me përpikmëri dhe sinqeritet fenë e Ibrahimit, që Allahu e ka vlerësuar në Kuran si mikun e Tij. Duke iu drejtuar njerëzve me një pyetje retorike, Allahu pohon se besimtar i mirë është ai që beson Atë dhe vepron sipas normave të vendosura prej Tij, duke qenë i sinqertë në besim dhe veprim. Që një vepër të jetë e vlefshme tek Allahu, duhet të plotësojë dy kushte: e para, të jetë sipas normave të vendosura nga Allahu Teala ose i Dërguari i Tij dhe e dyta, të jetë e sinqertë, duke iu dedikuar vetëm Allahut. Nëse vepra humb njërin nga këto kushte, bëhet e pavlefshme. Kur personi nuk plotëson kushtin e sinqeritetit, quhet hipokrit, kurse kur nuk plotëson kushtin e saktësisë, konsiderohet i devijuar, prandaj Allahu e ka cilësuar se zbatuesi i veprës duhet të jetë ndjekës i fesë së pastër të

Ibrahimit (a.s.). Kur besimtari i plotëson të dyja kushtet, arrin gradën e "ihsanit", që do të thotë, ta adhurosh Allahun, sikur e shikon. Nëse ti nuk e sheh Atë, të jesh i bindur se Ai të shikon ty. Pra, të ndjesh mbikëqyrjen e Allahut në çdo veprim dhe moment. Kushti më i vështirë për t'u plotësuar nga besimtarët e pastër, mbetet sinqeriteti. Sinqeritet do të thotë që çdo vepër ta bësh vetëm për hir të Allahut dhe ta mbash zemrën larg syfaqësisë, përfitimeve dhe interesave personale. Pejgamberi (a.s.), në një hadith thotë: "Kush përfiton dituri, jo për hir të Allahut, por për të arritur disa qëllime në këtë botë, nuk do ta ndjejë aromën e xhenetit, në ditën e gjykimit." (Ebu Davudi) Të gjitha veprat vlerësohen sipas sinqeritetit. Një vepër e vogël dhe e parëndësishme në dukje, arrin nëpërmjet sinqeritetit, gradat më të larta tek Allahu. Për veprat, sinqeriteti është në rolin e shpirtit. Veprat nuk mund të bëjnë dot pa sinqeritetin. Allahu i ka urdhëruar të gjithë pejgamberët dhe popujt e tyre, që ta adhurojnë Allahun me sinqeritet dhe sipas mënyrës që u është komunikuar pejgamberëve: "E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zeqatin. Kjo është feja e drejtë." (Bejine)

Resulullahi (sal-lallahu alejhi ve slem) ka thënë:

"Allahu nuk shikon formën trupore dhe fizionominë tuaj, por zemrat tuaja."

(Buhari)

RRETH TRANSMETUESIT:

Ky hadith transmetohet nga sahabiu i nderuar, Abdurrahman ibn Sahr, i njohur me emrin Ebu Hurejra. Ebu Hurejra (r.a.), e pranoi islamin në vitin e shtatë, pas emigrimit të myslimanëve në Medine. Ai qëndronte gjithmonë pranë Profetit (a.s.), duke treguar një zell të madh për të mësuar thëniet e tij. Është sahabiu që ka transmetuar më shumë hadithe profetike, plot 5374. Nga këto, 609 gjenden edhe në koleksionin e Buhariut edhe të Muslimit. Ka ndërruar jetë në moshën 78 vjeçare në Medine.

KOMENTI I HADITHIT

Njerëzit janë të prirur t'i vlerësojnë të tjerët nga pamja e jashtme. Në përgjithësi njerëzit që janë të bukur, të pasur, të pushtetshëm dhe të famshëm, janë më të vlerësuar në mesin e gjithë njerëzve të tjerë, kurse të varfërit dhe njerëzit jo të bukur nuk vlerësohen. Në fakt, këto janë kritere vlerësuese për njerëzit që janë larg botës shpirtërore. Kurse Allahu Teala, i vlerëson njerëzit nga veprat dhe sjelljet që burojnë prej zemrave të tyre. Kriteri kryesor për vlerësimin e njeriut është bukuria dhe pasuria shpirtërore dhe jo bukuria dhe

pasuria materiale. Dhe më e rëndësishmja është, kur kjo bukuri dhe pasuri shpirtërore pasqyrohet me sjellje të mira dhe ibadet të sinqertë. Kryerja e veprave të mira dhe të sinqerta janë cilësitë që nxjerrin në pah vlerën e vërtetë të njeriut dhe e lartësojnë atë tek Allahu Teala. Duke përforcuar hadithin e mësipërm, Allahu Teala thotë në Kuran: "As pasuria juaj, as fëmijët tuaj nuk do t'ju afrojnë më shumë te Ne, por vetëm ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira (e meritojnë këtë). Ata do të kenë shpërblim të shumëfishtë për atë që kanë bërë dhe do të jenë të sigurtë në banesa të larta (në xhenet)". (Sebe, 37)

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Allahu i vlerëson ibadetet dhe veprat e tjera të mira, sipas qëllimit dhe sinqeritetit.
2. Ajo që ka vlerë dhe rëndësi tek njeriu, është pasuria dhe bukuria shpirtërore.
3. Ajo që i bën të pranueshme dhe të vlefshme veprat, është zemra. Prandaj i duhet dhënë rëndësi asaj, duke e pastruar dhe ruajtur nga ndjenjat e këqija, si zilia, urrejtja etj.

Mjë Hadith



A MUND TË ZIHET ME BALTË AI DIELL UDHËZUES!

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

FORMA PRAKTIKE E MORALIT TË BUKUR

Allahu (xh.sh.), e përshkruan kështu në Kuran të dashurin e Tij, Pejgamberin Muhamed r:

“Pa dyshim se ti je me moral të lartë.” (Kalem, 4)

“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.” (Enbija, 107)

I Madhi Zot, shkallën më të lartë të moralit dhe të devotshmërisë ia paraqiti njerëzimit nëpërmjet portretit të Pejgamberit të Tij shembullor. Ai (a.s.) ishte mrekullia e artit të Zotit e shpalosur në formën e njeriut. Ishte shembulli më i mrekullueshëm për të gjithë njerëzimin dhe zgjidhja më e mirë praktike për çdo çështje.

Në lidhje me këtë, Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Jam dërguar për të plotësuar moralin e bukur.” (Muvatta, Husnul-Hulk, 8)

Për këtë arsye gjithkush synon pasimin me de-

votshmëri të moralit dhe mirësisë së të Dërguarit të Allahut (a.s.). Kurani na njofton se, madje edhe një grup prej xhindëve erdhën tek i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe dëgjuan prej tij leximin e Kuranit.

Ai (a.s.) nuk është pejgamber vetëm për njerëzit por edhe për “Thekalejn”, domethënë për të dy botët, për botën e njerëzve dhe atë të xhindëve... Ai është mëshirë për të gjithë botët...

Ai (a.s.) do të jetë dëshmues mbi të gjithë pejgamberët (a.s.) Ditën e Mahsherit. Ai (a.s.) është vula e profetëve. Ai (a.s.) është mësuesi i njerëzimit.

Për këtë arsye gjithkush magjepset prej tij.

Madje edhe ata të gjorë që nuk i besuan mesazhit dhe fjalëve të tij.

Armiku më i madh i të Dërguarit të Allahut (a.s.), Ebu Xhehli thoshte:

“Ne e dimë që ti je i besueshëm dhe i drejtë. Por ne nuk e duam atë që ti ke sjellë.”



Domethënë ai, edhe pse egoja nuk e linte, e kishte pranuar të Dërguarin e Zotit (a.s.) në ndërgjegjen e tij.

Sipas kuptimit të shprehjes “mirësi është ajo që ta vlerëson edhe armiku”, edhe sot ka shumë mendimtarë dhe filozofë perëndimorë, të cilët pranojnë dhe vërtetojnë këto cilësi të Pejgamberit (a.s.).

Ja për shembull njëri prej tyre:

MË I MADHI NË HISTORI

Shkencëtari amerikan Michael HART në vitin 1979 përgatiti një studim me anë të kompjuterit. Qëllimi ishte të zgjidhte 100 personalitetet më të mëdha të të gjitha kohërave dhe t'i radhiste ato.

Kështu që, shkroi në kompjuter aftësitë, përpjekjet, veprat dhe sukseset e njerëzve të mëdhenj të cilët kanë lënë gjurmë në histori. Në fund të këtij studimi, i cili zgjati për disa muaj, programi kompjuterik zgjodhi emrin më të madh në bazë të të dhënave të regjistruara në memorien e tij. Emri i përzgjedhur në mënyrë objektive nga kompjuteri ishte Muhamedi (a.s.). Ata që përgatitën këtë studim ishin të krishterë, ndërsa Jezusi, sipas Islamit Isai u, zuri vendin e pestë.

Pas këtij studimi edhe revista franceze Le Point e shpalli Pejgamberin (a.s.) “Personazhi i vitit” në vitin 1979. Ndërsa me 29 dhjetor 1979 gazetata shkruanin për këtë studim dhe e shpjegonin kështu arsyen e asaj radhitjeje:

“Edhe pse Pejgamberi (a.s.) ka jetuar një mijë e katërqind e sa vjet përpara (571-632), ndikimi i tij në botë ka qenë jashtëzakonisht i lartë dhe miliona njerëz vazhdojnë akoma të ecin në gjurmët e tij.” (Revista Zafer, 97/3-8).

Ky ndikim i madh është një përforcim i qartë hyjnor dhe një konkluzion i rëndësishëm së tij si një pejgamber i vërtetë.

Ky ndikim i madh është një konkluzion i parqitjes së një karakteri dhe morali të veçantë.

Në botë kanë pasur ndikimin e tyre për një kohë të shkurtër edhe filozofë apo politikanë të ndryshëm. Duke tërhequr pas tyre masën e popullit dhe duke u mbështetur në fuqi të mëdha materiale, kanë sunduar njerëz të tillë si Aleksandri i Madh, Nemrudi, Faraoni, Marksi, Hitleri etj. Shumë nga këta ose kanë përjetuar dështimin akoma sa ishin

të gjallë, ose janë harruar nga historia pas një kohe të shkurtër pas vdekjes.

Pejgamberi (a.s.) dhe burrat e devotshëm kanë gjithmonë një vend të veçantë në zemrat e njerëzve. Modeli i rrugëtimit të tyre është për njerëzit një portë shpëtimi, qetësie, lumturie dhe mëshire. Ndjekja e gjurmëve të tyre është bërë shkak i një jete të mbushur plot me mirësi.

Historiani francez Lamartine është njëri nga ata dijetarë që ka përshëndetur dhe përgëzuar karakterin dhe triumfet e pashembullta të Pejgamberit të Zotit (a.s.).

DIFERENCË E PAKRAHASUESHME

“Nëse madhësia e qëllimit, mungesa e mjeteve dhe madhështia e përfundimit do të ishin tre komponentët matës të njeriut gjeni, kush do të kishte guximin të krahasonte figurat më të mëdha të historisë moderne me figurën e Muhamedit (a.s.)?” (A. De Lamartine, L'histoire de la Turquie)

Le ta shpjegojmë pak këtë fjali:

Truri i njeriut mund të studiohet në tre aspekte të ndryshme:

1. Cili është qëllimi i këtij personaliteti të madh?
2. Ky person çfarë mjeteve posedon?
3. Cili është përfundimi i përpjekjeve për të arritur qëllimin e tij me këto mjete? Sa e lartë është përqindja e suksesit të tij?

Qëllimi i Pejgamberit (a.s.) përfshinte të gjithë botën dhe ishte qëllimi më i madh i të gjithë shekujve. Qëllimi i tij ishte kënaqësia e Krijuesit, realizimi i shpalljes hyjnore, përfaqësimi i profesisë së të Madhit Zot. Ai posedonte mesazhin e udhëzimit për njerëzimin dhe lumturisë në të dy botërat, mesazhi i tij ishte aq i madh sa kjo botë dhe tjera. Qëllimi i tij nuk ishte imponimi i diçkaje tek njerëzit, por fitimi i zemrave të tyre. Ai kishte disa ideale madhështore, vendosjen e drejtësisë, zhdukjen e padrejtësisë, themelimin e vëllazërimit dhe të sakrificës reciproke ndër njerëz.

Sa i përket mjeteve dhe mundësive që posedonte;

Pejgamberi (a.s.) ka ardhur në këtë botë jetim, është rritur jetim dhe deri në moshën dyzet vjeçare kur i erdhi profecia, nuk ka pasur asnjë përkrahje

tjetër përveç mbështetjes shpirtërore dhe materiale të gruas së tij Hatixhes. Shumica e pasuesve të tij ishin të varfër dhe të dobët. Nuk kishte as pasuri për të harxhuar në realizimin e synimeve të tij. Në të shumtën e rasteve nuk kishte çfarë t'u dhuronte të tjerëve përveçse një buzëqeshje të ngrohtë. Si ai ashtu edhe shokët e tij shpeshherë ishin të detyruar të shtrëngonin fort barkun nga uria që kishin, ndërsa në udhëtimet e largëta tre vetë hipnin me radhë në një deve në mungesë të mjeteve të udhëtimit.

Nëse do të bënim një krahasim në mes të pejgamberëve të Zotit, Muhamedi (a.s.) nuk pati mrekulli të ngjashme me erërat në urdhrin e Sulejmanit u dhe as me shkopin e Musait u, me të cilin ndante detin apo nxirrte ujë prej shkëmbit. Por ai (a.s.), nuk posedoi asgjë tjetër përveç një zemre e cila synonte qetësimin e njerëzve me erërat e dashurisë dhe zbutjen e zemrave të ngurta me lotët dhe djersën e derdhur me vepra të mira dhe të hallallit.

Në këtë synim të madh dhe mundësi të vogla:

Përgjigjen e pyetjes se cili ishte përfundimi material dhe shpirtëror i mesazhit të të Dërguarit të Allahut (a.s.) mund ta gjejmë të qartë në momentin e hutbes së lamtumirës:

Nga një shoqëri paraislamike e emëruar "injorante" në të cilën foshnjat femra groposeshin të gjalla, adhuroheshin idhujt, shpërthenin luftërat ndër fise dhe ku nuk ekzistononte asnjë formë ligji politik apo shoqëror, lindi një popull madhështor, besimtar, i ndërgjegjshëm, i moralshëm, i mëshirshëm, sakrifikues, luftëtar i nderit dhe i vëllazërueshëm në fe.

Një territor madhështor i cili në fillim ndikoi mbi të gjithë gadishullin arabik, më pas u dërguan delegatë në Etiopi, Irak dhe në Sham, brenda 30 viteve u arrit nga Semerkandi në Kajravan e pas disa shekujsh shtriu ndikimin e tij të ndritur në të gjithë kontinentet e globit.

Një ndikim që nuk shuhet, një ndikim që nuk zhduket kurrë deri në Ditën e Kiametit.

Një qytetërim i cili rinovohet vazhdimisht dhe që prodhon figura të larta në çdo kohë.

Ka lindur burra të drejtë si Omeru'l-Faruku, Omer bin Abdulazizi, Selahaddin Ejjubi, Alparsllani, Muhamed Fatihu, Sulltan Sulejmani.

Një popull i cili i dërgoi në shkallët më të larta jetësore dhe i vendosi në jetë cilësitë njerëzore të mëshirës, dashurisë, butësisë dhe sakrifikimit. Një popull në të cilin nuk gjendej një i varfër për të marrë zekatin. Një vend me klimë të qetë ku nuk ka nevojë për psikiatri. Tempull i zemrave të lidhura fort njëra me tjerën si një zinxhir i hekurt, aty ku mërzitja dhe depresioni nuk gjejnë të çarë për të depërtuar brenda.

Çdo qytetërim prodhon formën e njeriut të vet. Ndërsa ajo formë e njeriut posedon cilësitë dhe karakterin e civilizimit, në të cilin lind dhe rritet që do të thotë se është gjithmonë në përshtatje me të.

Civilizimi islam i themeluar nga Profeti (a.s.), është maja më e lartë e arritur ndonjëherë në historinë e njerëzimit. Shkaku i kësaj arritjeje është përputhja e formës natyrore e të pastër të krijimit të njeriut me diturinë, madhështinë, urtësinë hyjnore.



Të gjitha këto arritje të këtij ymeti të ndriçuar nga bota shpirtërore profetike, ishin si rezultat i përcjelljes në çdo hap të jetës së të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili ishte si një Kuran i gjallë.

Suksesi i pakrahasueshëm në misionin e arritur nga Pejgamberi i Zotit, Muhamedi (a.s.), me mundësi të pakta dhe mjaft të dobëta, është një tregues i qartë i karakteristikave të tij të larta, si dhe moralit të tij shembullor.

MAHNITJA PAS PERSONALITETIT TË TIJ

Njerëzit mahniten gjithmonë pas personaliteteve të mëdha.

Për këtë shkak njerëzimi është gjithmonë në kërkim. Në kërkim për të gjetur shembullin e veçantë nga të tjerët, udhëzuesin ideal, të përsosurin.

Adresa më e drejtë dhe më e natyrshme e kësaj nevoje janë pa dyshim profetët dhe njerëzit e mirë të Zotit. Ata me veprat, me fjalët dhe me ndikimin e tyre të lindur nga sinqeriteti dhe çiltërsia, arrijnë të fitojnë zemrat dhe shpirtërat e pastër në mes të njerëzve.

I dërguar si mëshirë për botën, Pejgamberi ynë i dashur, Muhamedi (a.s.) ishte vula plotësuese e karvanit të profetëve të Zotit, pishtari ndriçues i të devotshmëve dhe të dashurve të Zotit. Në përrudhën e shkurtër 23 vjeçare të misionit të tij si

profet, ai (a.s.) arriti të edukojë me mijëra burra të cilët u quajtën sahabë (shokët e Pejgamberit). Ai diell udhëzues nuk kishte pasues vetëm nga fisi Kurejsh apo fiset e tjera përreth. Pas tij vrapuan edhe Selman el-Farisiu, Suhejb er-Rumi, Uveys el-Karani e shumë e shumë të ngjashëm me ta.

Fytyra e Pejgamberit (a.s.) ishte aq e ndritur dhe aq mahnitëse, saqë një nga dijetarët hebrej të asaj kohe, Abdullah bin Selami t kur e kishte parë fytyrën e të Dërguarit të Allahut (a.s.) kishte thënë:

“Kjo fytyrë nuk gënjen.”

Më pas kishte pranuar Islamin.

Bota shpirtërore dhe përsosmëria e personalitetit të Pejgamberit (a.s.) ishin në atë shkallë të lartë, saqë dy mbretërit e mëdhenj të asaj kohe e pranuan dhe u përlën përballë së vërtetës së mesazhit të tij, edhe pse nuk patën kurrë mundësinë ta shikonin atë nga afër. Mbreti i Etiopisë, Nexhashiu, pranoi Islamin. Ndërsa perandori i Bizantit, Herakliu, edhe pse nga frika e humbjes së pushtetit nuk e shprehu dot haptas, në ndërgjegjen e tij e kishte pranuar mesazhin dhe të vërtetën e profecisë së Muhamedit (a.s.).

Ndërsa sahabët, shokët e nderuar të Pejgamberit (a.s.), kudo që shkuan, ndriçuan si kandilat e mesazhit islam duke urdhëruar për të mirën dhe duke ndaluar të keqen. Në këtë mënyrë u bënë shkak që kjo botë dhe bota e pafundme e Ahiretit të bëhen vendbanim i lumtur për miliona e miliona njerëz.

Ashtu sikurse në shekullin e parë të Islamit, edhe në shekujt më pas, përpara kësaj përhapjeje të shpejtë të dritës së Islamit u paraqitën pengesa të ndryshme.

KURTHET E SHPIFJEVE DHE PADREJTËSIVE

Njohja e Islamit dhe e Pejgamberit (a.s.), përhapja e ideve të reja dhe simpatia e treguar ndaj fesë dhe të Dërguarit të Allahut (a.s.) i shqetësonte së tepërmi këto grupe:

- Tiranët të cilët nuk dëshironin të humbisnin interesat dhe pushtetin e tyre të dhunshëm...
- Ata të cilët pretendonin të ishin artistët dhe

dijetarët e vërtetë, u befasuan që me ardhjen e dritës së Islamit dhe zhdukjen e errësirës; injoranca, dembelizmi dhe imoraliteti i tyre do të dilte në shesh...

- Udhëheqësit ziliqarë të feve të shpikura apo të ndryshuara gjatë rrjedhës së historisë...

- Ata të cilët shpirtin e kishin të mbushur me mohim dhe dyfytirësi; të shoqëruar nga verbëria dhe injoranca...

Këta fatkeqë vazhdimisht shpifnin kundrejt Pejgamberit të Zotit, Muhamedit (a.s.).

Ata që në fillim e thërrisnin Pejgamberin (a.s.) el-Emin (i besueshmi), më pas filluan t'i thonë mashtrues.

Ata që pasurinë dhe paratë e tyre ia dorëzonin Pejgamberit (a.s.) për t'ua ruajtur dhe nuk kishin asnjë dyshim në besueshmërinë e tij, më pas filluan të pretendonin se ai (a.s.) po shpifte ndaj Allahut Y.

Gjatë rindërtimit të Qabes së bekuar, ata të mjerë të cilët u grindën mes njëri-tjetrit dhe si zgjidhje menduan të rrëmbenin shpatat, kur e panë atë burrë të hynte në derën e Qabes, u qetësuan dhe e zgjodhën si gjykatës të grindjes, për shkak të mençurisë dhe maturisë që posedonte. Ishin po ata njerëz që më pas do t'i thonë “i çmendur”.

Edhe pse nuk e kishin dëgjuar kurrë të shkruante apo recitonte ndonjë poezi, për t'i përngjarë ajetet e Kuranit me vargjet e poezive, thanë: “Ai nuk është pejgamber, por poet”.

Thjesht për të mohuar mesazhet e mrekullueshme të ardhura prej Zotit të Gjithësisë, madje duke e ditur shumë mirë të vërtetën, i thanë: “magjisttar”.

Personaliteti i ndritur i Pejgamberit (a.s.) i thau të gjitha ato kënetat dhe ferrat përreth e arriti të mbjellë në tokën e pastër të zemrave, trëndafilat e qëndisur me emrat e sahabëve, shokëve të tij më të mirë.

Të ngjashme me ato që përjetoi Pejgamberi i Zotit (a.s.) i përjetoi edhe ymeti (populli) i tij gjatë gjithë historisë.

*“Nëse
madhësia e
qëllimit, mungesa
e mjeteve dhe madhështia
e përfundimit do të ishin tre
komponentët matës të njeriut
gjeni, kush do të kishte guximin
të krahasonte figurat më të
mëdha të historisë
moderne me figurën e
Muhamedit (a.s.)?”*



Ndërsa drita e Islamit përhapej në çdo cep të botës duke zhdukur errësirën e dhunës dhe të padrejtësive, disa klerikë të cilët frikësoheshin nga humbja e posteve apo detyrave që kishin, filluan të nxitnin e të organizonin njëra pas tjetrës fushatat famëkeqe të kryqëzatave. Në anijet e tejmbushura me ushtarë, Islami u shpjegua në formën më të errët dhe më negative.

Feja më e pastër monoteiste, Islami, u paraqit tek ata si “fe pagane”.

U përhapën gënjeshtret se gjoja pakicat e krishtera, si ato të grekëve dhe armenëve, jetonin nën dhunën apo persekutimin e myslimanëve, megjithëse në shtetin islam mbrohej me të drejtë liria e besimit dhe fesë. Nën ndikimin e këtyre shpifjeve, kur erdhën ushtarët e kryqëzatave ushtruan masakrat më të egra mbi popullin e Kudsit (Jeruzalemit).

Madje edhe në luftën e Çanakkale-së, myslimanët e Indisë dhe Pakistanit u mashtruan nën parullat se gjoja “po shkojmë në ndihmë të Kalifit (udhëheqësit mysliman)” dhe u dërguan kundër myslimanëve.

Dje mundësitë dhe mjetet ishin më të pakëta, andaj edhe shpifjet nuk kishin shumë ndikim. Ndërsa sot, nën petkun e artit, mendimit të lirë, kinemasë dhe karikaturave, ushtrohet një propagandë e rrezikshme ofendimesh dhe keqinterpretimesh.

Me anë të depërtimit të ofendimeve të pamoralshme synohet që të pengohet orientimi i mbarë njerëzimit drejt Pejgamberit të Zotit, Muhamedit (a.s.), shembullit më të mirë, poseduesit të moralit më të bukur dhe më madhështor, për të cilin njerëzimi ka nevojë, ashtu siç ka nevojë për ujë dhe oksigjen.

Ne e dimë që vendin e fesë, besimit dhe gjendjes shpirtërore nuk mund ta zërë asgjë. Ideologjitë e ndryshme si ajo e komunizmit apo pozitivizmit, të cilat pretendonin shkatërrimin e fesë, falimentuan me kohë. Kristianizmi, si një fe së cilës i ka kaluar koha, e devijuar dhe e lënë pas dore, tani nuk gjen më vend as në zemrat e të krishterëve. U mendua se vendin e tij mund ta zinin besimet e Lindjes së Largët, por edhe ato nuk arritën ta përballojnë etjen dhe urinë që ndjen natyra e pastër njerëzore. Me gjithë këto intriga dhe shpifje të mbushura me smirë e xhelozë, përsëri Islami vazhdon të tërheqë mendjet dhe zemrat e njerëzve nga çdo cep i botës.

Islami është adresa e vetme e shpëtimit në këtë botë dhe në Ahiret. Ata që sot pretendojnë se janë

themeluesit e civilizimit modern dhe marrin kura- jon të hedhin fjalë kundër të Dërguarit të Allahut (a.s.), nuk kanë themeluar asgjë tjetër, përveçse mbretërinë e injorancës, brenda së cilës vuajnë pasojat e ndërgjegjes dhe shpirtit. Morali është zhdukur, urrejtja dhe armiqësia ndërmjet të pasurit dhe të varfërit është rritur, familja është shkatërruar, ndërsa fëmijët vrapojnë pas drogës dhe alkoolit në kërkim të lumturisë së humbur.

Të gjitha këto dukuri tregojnë se Islami është zgjidhja e vetme, kurse rruga e vetme e botës përrëndimore të zhytur në shkatërrimin moral dhe shpirtëror, është përvetësimi i këtij sistemi madhështor. Filmat kundrejt personazhit të Pejgamberit (a.s.), tentativat për të djegur Kuranin Famëlartë, çetat e formuara nga mllefi dhe urrejtja kundrejt kësaj feje, kanë vetëm një qëllim, pengimin e drejtimit të njerëzve nga Islami;

QËLLIMI ËSHTË PARANDALIMI I SUKSESIT

Por me lejen e Allahut kurrë nuk do t’ia arrijnë. Sepse në ajetin e Kuranit thuhet kështu:

“Ata dëshirojnë ta fikin dritën (fenë) e Allahut me gojën e tyre, por Allahu ka vendosur vetëm që ta përsosë dritën e Vet, edhe sikur mohuesit ta urrejnë këtë gjë.” (Tevbe, 32)

Është për t’u çuditur se si në të gjitha vendet e botës në të cilat popullsia myslimane është dominuese, të krishterët në mënyrë direkte ose indirekte ushtrojnë ose ndihmojnë në ushtrimin e aktiviteteve të ndryshme të terrorit, pushtimit apo anarkisë, duke derdhur gjak myslimani...

E megjithatë, të gjitha këto poshtërsi që ata vetë bëjnë, mundohen t’ia hedhin Islamit dhe Pejgamberit të kësaj feje, Muhamedit (a.s.). Mundohen me mish e me kockë që Islamit ta tregojnë si një fe të egër, të vështirë, të rëndë apo të prapambetur.

Provuan me të gjithë forcën e tyre të errët që t’i bëhen perde asaj drite, ta përbaltin me shpifje atë diell ndriçues. U munduan t’i presin degët pemës që jep fruta.

Por atij nuk arritën t’i bëjnë dot asgjë. Me ato fjalë të ndyra, nuk përlyen gjë tjetër, përveç gojës së tyre. Balta në ato duar njollosoi veç karakterin e tyre të ndyrë.

I vetmi pejgamber dhe i vetmi njeri të cilit i njihet e tërë jeta në histori, madje edhe në detajet më të vogla, është Muhamedi (a.s.). Të gjitha fjalët, veprat dhe mendimet e tij janë regjistruar në çdo moment duke u kthyer kështu në monumente të krenarisë për mbarë njerëzimin. Jeta e tij (a.s.) do të jetë si

shembull për të gjithë brezat e ardhshëm deri në Ditën e Kiametit.

Kështu që:

Nuk ka asgjë për t'u çuditur me sjelljet ofenduese të Ebu Xhehlëve dhe Ebu Lehebëve të kohës, kundrejt Pejgamberit të Zotit (a.s.).

Dihet se hajduti dyqanin e argjendarisë synon të vjedhë. Pema që ka fruta goditet me gurë.

Ashtu sikurse Ebu Xhehlët e djeshëm, edhe pardshtësit e sotëm të injorancës nuk kanë lënë vend pa kërkuar në jetën dhe në karakterin e Pejgamberit (a.s.), por nuk kanë gjetur asgjë, qoftë edhe një detaj të vogël, për të kritikuar.

Duke qenë kështu, nuk kanë gjetur zgjidhje tjetër, veçse të qetësojnë urrejtjen e tyre me anë të shpifjeve dhe intrigave.

Këto intriga do të zgjasin në një mënyrë apo tjetër deri në Ditën e Kiametit.

Por ajo që ne duhet të pyesim është kjo:

Çfarë detyre kemi ne si ymeti i Muhamedit përballë këtyre shpifjeve?

Ata me këto sjelljet e tyre, mundohen të mbulojnë të vërtetën e Pejgamberit (a.s.). Me anë të zhurmës që krijojnë, dëshirojnë që fjala e Kuranit të mos dëgjohet. Me ato paraqitje të ndyra, mundohen t'i tërheqin shikimet nga drita e moralit më të mirë të botës.

Atëherë, ajo që na takon ne të bëjmë, është t'ia paraqesim njerëzimit të Dërguarin e Zotit (a.s.), në formën e tij më të denjë.

Ndërsa rruga për ta arritur këtë gjë është, njohja dhe përfitimi sa më shumë prej tij (a.s.).

TË JETOJMË ME TË...

Jeta e Pejgamberit (a.s.), u plotësua në vitin 632. Sot nuk jemi në gjendje që ta mbrojmë atë (a.s.), në aspektin fizik. Por, ashtu sikurse çdonjëri nga ne është dëshmitar i Zotit në tokë, edhe si ymeti i të Dërguarit të Zotit (a.s.), jemi të obliguar që të mbrojmë moralin, personalitetin dhe Sunetin e Profetit (a.s.).

Ta duash atë, do të thotë të jesh me të në zemër, në fjalë e në vepër. Në hadithin e tij të bekuar thuhet:

“Njeriu është me atë që do.” (Buhariu, Edeb, 96)

Në fytyrën e secilit prej nesh duhet të reflektojë buzëqeshja e tij.

Nga fjalët tona duhet të derdhen vetëm modestia dhe çiltërsia e tij.

Në veprimet tona duhet të mishërohet sinqeriteti, pastërtia dhe devotshmëria e tij.

Me faljen, mëshirën, dashurinë, bujarinë, sakrificën, modestinë dhe qëndrueshmërinë tonë, le të përpiqemi të fitojmë sadopak prej moralit të tij të lartë.

Ai u dërgua si mëshirë për botët.

Ne, besimtarët, duhet të sillemi me mëshirë dhe dhembshuri ndaj çdo krijese, duke përfaqësuar me dinjitet Profetin (a.s.) dhe duke qenë pionierët e buzëqeshjes në fytyrën e ndritur të Islamit.

Ky përfaqësim me dinjitet i të Dërguarit të Allahut, ishte shkak që të parët tanë të fitonin zemrat e njerëzimit në mbarë botën.

Një nga shembujt e pafund është ky:

Sulltan Fatih Mehmeti, pasi e çliroi Bosnjën, dërgoi në ato zona njerëz të zgjedhur, të cilët përfaqësonin me dinjitet bukurinë dhe nurin e Islamit. Boshnjakët u magjepsën kur panë të mishëruar në komshinjtë e tyre myslimanë moralin dhe karakterin e lartë të Pejgamberit (a.s.), vendosën që më pas të pranonin të qetë Islamin.

Kështu ka ndodhur edhe çlirimi i Kosovës nga Sulltan Murati.

Devotshmëria jonë, forma jonë praktike, morali dhe e gjithë ekzistenca jonë duhet të arrijë në atë shkallë të përfaqësimit të Pejgamberit (a.s.), sa që kur njerëzit të dëgjojnë shpifjet që bëhen ndaj atij profeti të madh apo të krahasojnë shpifjet e trillimet me moralin tonë madhështor, atëherë nuk do të arrijnë të mendojnë gjë tjetër, përveçse të thonë: “Përderisa ymeti i këtij Pejgamberi është kaq i çiltër, kaq i bukur dhe kaq i veçantë, kushedi se sa i madh, sa i përkryer dhe sa madhështor do të ketë qenë ai vetë!”

O Allah!

Duke na bërë pjesë të ymetit të më të dashurit Tënd, Ti na dhe dhuratën më të madhe. O Allah! Plotësoje mirësinë Tënde mbi ne duke na bërë prej atyre të cilët përfitojnë prej zemrës, prej moralit kuranor, prej Sunetit të tij të bekuar dhe na bëj të denjë për ymetin e tij...

O Allah!..

Na mundëso që të Dërguarin e Nderuar (a.s.), ta paraqesim dhe ta tregojmë në formën më të bukur tek njerëzit të cilët akoma nuk e kanë njohur atë. Na jep sukses në realizimin e kësaj përgjegjësie të madhe. Duke qenë kjo motoja e jetës tonë, na bashko me të Dashurin Tënd në Xhenet.

Amin!..



EL-MUIZZ - EL-MUDHIL

AI QË EDHE TË NDERON, EDHE TË POSHTËRON

Ilir Hoxha

Është shumë e vështirë të zgjedhim midis mirësive që na ka falur Zoti ynë i Madhëruar. E për cilën prej mirësive të Tij mund të themi, “mund të bëhej edhe pa të”? Mirëpo ekzistojnë disa njerëz, të cilët vijnë para të tjerëve për nga aspekti i vlerës së ekzistencës sonë. Për shembull, edhe nëse jeton në fshat, edhe nëse jeton në qytet, qofsh punëtor apo drejtor, nëse je i respektuar dhe i lartë në shoqërinë ku bën pjesë, të ka peshë fjala e të njihen vlerat, shkurtimisht, nëse je “i çmuar”, kjo vjen në krye të të gjitha mirësive. Në hierarkinë e nevojave njerëzore, pas nevojave themelore biologjike dhe psikologjike, vijnë nevojat sociale, ku bën pjesë edhe cilësia e të qenit “i çmuar”. Kjo cilësi është një manifestim i emrit hyjnor “el-Muizz”: **“Thuaj (o Muhamed): «O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë.»**” (Al-i Imran, 26.)

Fjala “Muizz”, është mbiemër që rrjedh prej rrënjës “Izzet” dhe do të thotë, “Ai që të nderon, e të vlerëson”. Ndërsa fjala “Mudhil”, rrjedh prej rrënjës “Zillet”, që është e kundërta e fjalës “Izzet” dhe do të thotë, “Ai që të poshtëron”. Për shkak se këta dy emra janë plotësues të njëri-tjetrit, ata përmenden gjithmonë së bashku, njësoj siç përdoren edhe emrat “Kabid-Basit” dhe “Hafid-Rafi”.

Kur themi, “Allahu edhe të nderon, edhe të poshtëron...”, ajo që duam të themi, nuk është një nderim apo poshtërim ashtu siç e kuptojmë ne në bazë të kriterëve të kësaj bote. Nderi që jep Allahu, është nderi i veçantë që njeriu bart për shkak të të qenit njeri. Pra, është diçka shpirtërore. Dhe atë që nuk e arrin dot këtë nderim, nuk mund ta bëjë të respektueshëm e të nderuar asnjë forcë e jashtme (pozitë, pasuri, prejardhje, etj.). Ata që nuk e dinë

se cilat janë kriteret e vërteta të nderit dhe poshtërimin, mund ti kuptojnë ato nga gjendja e tyre kalimtare në pamjen e jashtme. Në situata të tilla, ndodh që mendjemadhësia të pandehet nder, ndërsa modestia poshtërim. Mos ngatërrimi i nderimit me mendjemadhësinë dhe i poshtërimin me modestinë, ka një rëndësi jetike. Dhe për të theksuar rëndësinë e dijes në dallimin e këtyre, Elmallëllë Hamdi Jazër shprehet se, një madhështi pa dije, herët a vonë do të kthehet në poshtërim.

NGA SE VARET TË QENIT I NDERUAR APO I POSHTËRUAR?

Në fakt, të jesh i nderuar apo i poshtëruar, është diçka relative, sepse çdo njeri, mund të jetë i lartë në krahasim me dikë dhe i ulët në krahasim me dikë tjetër. Në këtë mënyrë, këto dy emra manifestohen tek të gjithë ne. Pra, njeriu mund të jetojë situata ku nderi dhe poshtërimi janë të ndërthurura me njëra-tjetrën. Në fakt, këto dy rrugë i janë ofruar njeriut që në krijimin e tij, si një nga zgjedhjet që ai duhet të bëjë. Kushdo dhe cilëndo rrugë të zgjedhë, Allahu ia lehtëson atij atë rrugë. Ato që na bëjnë neve të nderuar ose të poshtëruar, janë sjelljet tona. Ata që kanë sjellje të mira nuk do të poshtërohen kurrë. Dhe këtë e mësojmë nga ajeti 26 i sures Junus: **“Ata që bëjnë vepra të mira, do të kenë shpërblim të mirë, madje edhe më tepër! Fytyrat e tyre nuk do t’i mbulojë as errësira, as poshtërimi. Ata do të jenë banorë të Xhenetit, në të cilin do të banojnë përherë.”**

Vlerësimi i vetvetes, si i nderuar apo i ulët, nga ana e njeriut, është një nga treguesit më të rëndësishëm në lidhje me vlerën e tij të vërtetë. Poshtërsia e atyre që pandehin se janë të nderuar dhe vlera e atyre që e kuptojnë se janë të ulët, gjenden në një thellësi të atillë, saqë janë të fshehur nga shikimet



sipërfaqësore. Por Allahu nuk ka nderuar asnjë rob të Tij, më tepër se atë, të cilit i ka dhuruar vetëdijen për të treguar poshtërsinë e egos/vetes së vet dhe nuk ka poshtëruar asnjë tjetër, me tepër se atë, të cilit i ka dhënë ndjenjën e iluzionit se është i lartë/i nderuar.

Sipas Imam Gazaliut, i cili njihet për analizën e hollësishme që i bën aspekteve më komplekse të sjelljeve të njeriut, poshtërsia lind prej çdolloj varësie. Ndërsa “nderi” varet nga shpëtimi prej presioneve të egos dhe prej zinxhirëve të inyorancës. Sipas tij, i pasuri i vërtetë, është ai që ka shpëtuar prej poshtërimit të nevojës. Nëse njeriu është i vetëmjaftueshëm dhe nuk ia shtrin dorën askujt, ai është i nderuar. Por nëse është lakmitar dhe ia ngul sytë gjërave të tjerëve, ai është i ulët. Njerëz të tillë, e shohin gjithmonë fitimin dhe lumturinë e tyre në dorën e të tjerëve dhe jetojnë vazhdimisht me një ndjenjë nevoje. Nëse zemra mbushet me lakmi të kësaj bote, e bën njeriun interesaxhi, koprrac dhe të pandershëm. Për rrjedhojë, edhe Allahu i Madhëruar var në qafën e këtyre njerëzve zinxhirin e poshtërimit.

Sipas mistikëve, atyre që dëshiron t'i nderojë, Allahu i Madhëruar u jep një moral që mbështetet në një besim pa dyshime dhe vetëmjaftueshmëri. Po ashtu, ai i nderon ata duke u falur asketizmin (zuhdin), që nënkupton qëndrimin larg prej pavlefshmërisë së dëshirave kalimtare. Këta janë njerëz të sinqertë dhe me dinjitet, të cilët nuk devijojnë në rrugë të jashtëligjshme për të plotësuar nevojat dhe dëshirat trupore dhe nuk i afrohen gënjeshtërisë e dyfytërsisë. Egoja e tyre e nderuar, i ruan ata prej çdolloj paturpësie. Por nëse dëshirat mbizotërojnë egon, ato e bëjnë njeriun të veprojë pa pasur kujdes ndaj hallallit apo haramit, gjë e cila i hap rrugën poshtërimit. Ndërsa qëndrimi larg cilësive të këqija që e poshtërojnë njeriun në të dyja botët, si dyfytërsia, koprracia, lakmia dhe smira, dhe shtypja e këtyre cilësive sapo të shfaqen pak në thellësi të egos sonë, është një domosdoshmëri jetike.

Për shkak të inyorancës, ndonjëherë njeriu e kërkon nderin në gjëra të gabuara. Për rrjedhojë, ai adhuron gjëra të ndryshme përveç Allahut dhe shpreson që ato t'i falin nder dhe mirësi. (shih. Merjem, 81; Nisa, 139.) Mirëpo, për shkak se “nderi” i takon vetëm Allahut, ata që kërkojnë nder dhe

respekt, duhet t'i kapërcejnë idhujt e ndryshëm para të cilëve përkulen njerëzit dhe të ngjiten tek Allahu, duke iu përkulur vetëm Atij. (shih. Nisa, 138-139; Fatir, 10; Munafikun, 8...)

Për këtë arsye, ne duhet të bëjmë kujdes ndaj atyre prej të cilëve frikësohemi dhe ndjejmë respekt përveç Allahut, në mënyrë që të mos e kalojmë dozën e frikës dhe respektit ndaj tyre. Ky është kusht i domosdoshëm për ruajtjen e nderit tonë, sepse idhujtaria/shirku është niveli më i ulët i poshtërsisë dhe buron prej frikës dhe respektit të tepërt që ushqehet ndaj të tjerëve përveç Allahut.

PERSONAT TEK TË CILËT MANIFESTOHEN KËTA EMRA

Sipas Sadreddin Konevi, Allahu i Madhëruar, me emrin e tij “Muizz”, e ka bërë njeriun të nderuar që në krijimin e tij. Por kur njeriu bëhet arrogant duke pandehur se ky nderim është aftësi e tij, atëherë ai ulët/poshtërohet para Allahut. Për këtë arsye, nderi, që është mirësi e Zotit tonë, e bën njeriun edhe zotëri edhe kusar... Se cili do jetë ai, varet nga mënyra si do ta përdorë njeriu atë “nder”.

Në sajë të manifestimit të këtij emri, njeriu i beson vetes në kuptim pozitiv. Ai nuk e kërkon suksesin tek shkaqet jashtë vetes, por brenda vetes dhe të gjithë ndihmën e orienton drejt egos së vet. Dhe pikërisht atëherë ai njeri bëhet i nderuar. Mirëpo, kur ai përpiqet të bëjë padrejtësi me nderimin, që është manifestim i emrit Muizz të Allahut, atëherë tek Allahu nuk ka njeri më të poshtër se ai.

Duke filluar prej familjes sonë, nderi i çdo institucioni ku bëjmë pjesë, varet nga secili prej nesh si njerëz të nderuar që i dalim për zot përgjegjësive tona. Për këtë arsye, liderët nuk duhet të sillen në atë mënyrë që të bëhen shkak që njerëzit që kanë nën vete të ndihen të poshtëruar, por përkundrazi, duhet t'i nderojnë ata në mënyrë që ata të ndihen krenar që bëjnë pjesë e atij institucioni. Ndonjëherë, mund të jetë e vështirë të jetosh me një njeri me dinjitet e nder. Por për shkak se ky virtut është cilësia më e vlefshme që mund të ketë një njeri, ne duhet të përqendrohemi tek mirësia që ka ai dhe nuk duhet të heqim dorë nga ky qëndrim për lehtësira të vogla dhe interesa të cekëta.

Mangësia e vërtetë është në trup apo në shpirt?

— Ali Riza Temel —

Në lidhje me mangësitë fizike dhe shpirtërore, të cilat vijnë që prej lindjes, poseduesi i tyre nuk ka asnjë faj. Nëse ndonjë mangësi është shkaktuar si rezultat i zgjedhjeve të gabuara dhe veprimeve të prindërve, mëkati për këtë u përket atyre. Njerëzit me aftësi të kufizuara të këtij lloji tërheqin mëshirën hyjnore. Përkujdesja për këta njerëz është detyrë e njerëzve të shëndetshëm. Ndihamë që mund t'u jepet atyre nga një aspekt është zekati dhe falënderimi ndaj Zotit (xh.sh.), për shëndetin që na ka dhënë. Edhe mangësitë që nuk burojnë nga gabimet e njeriut dhe që kanë ndodhur pas lindjes, janë në të njëjtën kategori. Edhe mangësitë që shkaktohen për shkak të gabimit të të zotit, sigurisht që nuk mund të lihen krejt pa përkrahje. Por përparësi kanë mangësitë që vijnë nga krijimi dhe që nuk shkaktohen nga gabimet e njerëzve.

Allahu i lartësuar i sprovon robërit e Tij me njëri-tjetrin. Pasuria, varfëria, sëmundja, shëndeti, rinia, pleqëria, etj. të gjitha janë sprovë për njerëzit. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: **“...Ne i kemi bërë disa prej jush të jenë sprovë për të tjerët. A do të jeni të durueshëm ju? Zoti yt i sheh të gjitha.”** (Furkan, 20)

Ai që sheh të verbrin ai di vlerën syrit, ai që sheh topallin ia di vlerën këmbës dhe ai që sheh të sëmurin ia di vlerën shëndetit. Këto lloje gjendjesh bëhen shkak që njeriu ta falënderojë Zotin (xh.sh.). Nisur nga ky aspekt, njerëzve me aftësi të kufizuara iu kemi borxh një falënderim, sepse ata na kujtojnë vlerën e mirësive që posedojmë dhe falënderimin që duhet ta shfaqim ndaj Allahut Teala për to. Falënderimin që duhet t'ua bëjmë atyre, duhet ta realizojmë duke i ndarë mirësitë dhe mundësitë me ta, e jo thjeshtë vetëm me gjuhë. Falënderimi i pranuar nuk është ai që bëhet me gjuhë, por ai që bëhet me vepër.

Allahu (xh.sh.), nuk e ngarkon askënd me një barrë që nuk ka fuqi ta përballojë. Për këtë arsye, njerëzit me aftësi të kufizuara si i verbri, topalli, i sëmuri, i moshuari, i varfri, etj. nuk janë ngarkuar me disa prej detyrave. Për shembull, i varfri nuk është i obliguar me dhënien e

zekatit. **“Nuk është gjynah për të verbrin, as për të çalin, as për të sëmurin...”** (Nur, 61)

Ne duhet të shfaqim interesim ndaj këtyre njerëzve me mangësi apo siç thuhet me një shprehje të re, duhet të bëjmë një ndarje pozitive. Ai që është i fuqishëm dhe i shëndetshëm, në të vërtetë i plotëson vetë nevojat e tij. E rëndësishme është që t'i kapim për dore ata që janë të pafuqishëm dhe me aftësi të kufizuara. Gabimet që burojnë prej këtyre nuk konsiderohen si gabimet e njerëzve të tjerë.

Kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ishte i preokupuar duke i ftuar në Islam politeistët e parisë së kurejshëve, për shkak se e vrenjti fytyrën kundrejt Abdullah ibn Mektumit, i cili nuk e pa situatën dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut! A mund të m'i mësosh edhe mua disa gjëra prej atyre që t'i ka mësuar Allahu?”, u qortua nga Allahu Teala. Kurdo që i Dërguari i Allahut (a.s.), e shikonte këtë person, ia shtronte pelerinën e tij përpara dhe e lavdëronte duke i thënë: “Tungjatjeta, personi që u bë shkak për të më qortuar Zoti!”

Krahas mangësive dhe njerëzve me aftësi të kufizuara që i shprehëm më sipër, ka edhe mangësi dhe njerëz me mangësi që asnjëherë nuk falen dhe nuk mëshirohen, madje ata tërheqin edhe urrejtje. Verbëria dhe shurdhimi si, të mos e shohësh të vërtetën, të mos e dëgjosh të vërtetën dhe të mos e thuash të vërtetën, ngaqë bëhen me vullnet dhe inat, janë edhe shumë të rrezikshme, edhe shumë të vështira për t'u shëruar. Njerëzit që i kanë këto mangësi zgjedhin të veprojnë me to me dijeni dhe vullnet të plotë. Ngaqë ata nuk i kuptojnë sëmundjet e tyre, nuk mendojnë për t'u mjekuar. Për shkak se këta i përdorin për keq aftësitë që ua ka dhënë Allahu Teala, janë njerëz zullumqarë. Për këtë arsye, tërheqin urrejtje në vend të mëshirës. Siç shprehet edhe vetë Zoti (xh.sh.), këta janë krijesat më të këqija: **“Krijesat më të këqija para Allahut janë ato që janë shurdhe dhe memece (ndaj të vërtetës) e që nuk kanë arsye.”** (Enfal, 22)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka shprehur gjendjen e vërtetë prej memeci dhe rrezikun e saj duke thënë: **“Ai që hesht kundrejt padrejtësisë është shejtan pa gjuhë.”** Ata që kanë sy, por që nuk e shohin të vërtetën, ata që kanë gjuhë, por që nuk e thonë të vërtetën dhe ata që kanë veshë, por që nuk e dëgjojnë të vërtetën, janë njerëz që kanë dalë prej humanizmit me vullnetin e tyre. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: **“Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë, që zemrat e tyre të mendojnë dhe**

veshët të dëgjojnë? Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor.” (Haxh, 46)

“Ne kemi paracaktuar për Xhehenemin shumë xhinde dhe njerëz, sepse ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi. Pikërisht këta janë të shkujdesurit.” (A'raf, 179)

Njerëzit e përmendur në ajetin e mësipërm janë bërë prej banorëve të Xhehenemit ngaqë i kanë përdorur për keq aftësitë që u janë dhënë. Kafshët janë më lart se këta ngaqë nuk kanë përgjegjësi. Nëse aftësitë njerëzore që i ka dhënë Allahu Teala nuk përdoren sipas vlerave morale dhe humane, atëherë kjo është tradhti ndaj amanetit hyjnor. Pra, nga një aspekt është dalje nga natyra njerëzore.

Ata që i kanë zemrat e verbra e shohin të vërtetën si të gabuar dhe të gabuarën si të vërtetë. Nëse këta zgjidhen si udhërrëfyes, atëherë kjo do të thotë të vraposh drejt humnerës. Sa bukur që ka thënë Hz. Isai: “Lërinia ata! Ata janë udhërrëfyesit e verbër të të verbërve. Nëse i verbri e ndjek të verbrin, që të dy bien në gropë.” (Mateo, 15/14) Verbëria që synohet këtu dihet se është verbëria shpirtërore. Allahu Teala thotë në ajetin fisnik: **“...Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor.”** (Haxh, 46)

Disa dijetarë e kanë konsideruar si mekruh prirjen e të verbrit në namaz, sepse ai mund të mos e ketë parë papastërtinë që mund t'i ketë rënë në trupin dhe rrobat e tij. Ndërsa ata që i kanë të verbër sytë e zemrës, nuk i dallojnë dot mëkatet. Kështu që të këqijat u duken të mira dhe të mirat u duken të këqija. Allahu i ka cilësuar politeistët si papastërti. (Tevbe, 28) Sepse burimi i vërtetë i papastërtisë është verbëria shpirtërore. Kur Hz. Isai e shpjegoi fjalën që tha më sipër, u shpreh: “Sepse mendimet e këqija, vrasjet, imoralitetet, prostitucioni, vjedhjet, dëshmitë e rreme dhe fyerjet dalin nga zemra. Këto janë gjërat që e ndyjnë njeriun.” (Mateo: 15/19)

Sa bukur ka thënë Mevlana: “Kur ta shohësh njeriun, shikoje të vërtetën e tij! Mos e shiko atë si Iblisi që e pa si ujë e dhe! Përtej dheut ka me qindra mijëra bahçe trëndafilash. Ti mos shiko njeriun e krijuar nga balta! Shiko shpirtin që i është fryrë! Mahnitë ndaj atij shpirti! Nëse do të ecësh, ec drejt Atij që të ka dhënë këmbët! Nëse do të shohësh, shiko veprat e Atij që të ka dhënë sytë dhe përpiqu ta shohësh Atë!”

Në të gjithë botën dhe në vendin tonë është shpallur java e njerëzve me mangësi fizike dhe aftësi të kufizuara. Me rastin e kësaj jave organizohen disa aktivitete. Gjithashtu merren masa për ndihma pro këtyre njerëzve me mangësi. Kjo sigurisht që është diçka e bukur. Por gjithashtu duhet të caktohen edhe kohë dhe programe të veçanta për mangësitë shpirtërore që njerëzit kanë në shpirt, sepse mangësitë shpirtërore janë më të rrezikshme se mangësitë fizike. Këto mangësi ndoshta nuk vihen re në shikim të parë, por plani i pasmë i kësaj çështjeje është mjaft i rëndësishëm. Nëse këto nuk kuptohen që në fillim, por ngelet vonë si në rastin e qelizave kancerogjene të rrezikshme, do të thotë se çdo gjë ka marrë fund. Sëmundjet si urrejtja, smira, mashtrimi, përgojimi dhe armiqësia i kalbin shpirtrat. Ndërsa ata që i kanë shpirtrat e kalbur, dalin nga natyra njerëzore dhe bëhen si të tërbuar. Sytë që janë të verbuar prej tërbimit, nuk e shohin dot të vërtetën. Zëmrat që nuk ngopen me ushqimin shpirtëror, gjithmonë ndjehen të uritura. Flakët e tërbimit ua kaplojnë horizontin si flaka që i hidhet dru pa pushtim. Për shkak të kësaj, bota jonë kthehet në Xhehenem. Burimi kryesor i dhimbjeve dhe tragjedive që po përjetojmë është verbëria, shurdhimi dhe uria shpirtërore.

Trupat janë si kafshë transporti për shpirtrat. Kafsha e transportit është e rëndësishme, por vetëdija që e drejton kafshën në drejtimin që dëshiron është edhe më e rëndësishme. Thuhet se kali hingëllon sipas të zotit të tij. Kali që nuk ka një kalorës të rregull nuk është i dobishëm për asgjë. E gjithë çështja është zburimi i shpirtit dhe mjekimi i sëmundjeve shpirtërore.

Sa bukur ka thënë Mevlana: “Hidhi pak parfum edhe shpirtit, në vend që t’i hedhësh gjithmonë vetëm trupit! Sidoqoftë trupi do të kalbet dhe do të bëhet dhe.” I përhershmi gjithmonë është më i rëndësishëm dhe më i vlefshëm se i përkohshmi.

Ndërkohë që përparojmë në rrugën e Allahut, humanizmit, të vërtetës dhe të drejtës, më së shumti janë pengesat shpirtërore që na ndalojnë në raport me ato fizike. Krahas atyre njerëzve të shëndoshë

që nuk morën pjesë në luftë duke shpikur pretekste boshe edhe pse nuk kishin ndonjë mangësi fizike, shikojmë njerëz që insistojnë për të marrë pjesë në luftë edhe pse kishin mangësi fizike. Begatia e Stambollit, Ebu Ejjub el-Ensariu (r.a.), nuk nguroi për të shkuar në xhihad edhe në kohën kur ishte shumë i moshuar. Edhe sjellja e Amr ibn Xhemuhut, i cili ishte prej ensarëve, ishte shumë interesante. Edhe pse shqeponte shumë, deshi të merrte pjesë në luftën e Bedrit, por u ndalua nga bijtë e tij. Kur shprehu dëshirën për të marrë pjesë në luftën e Uhudit, bijtë e tij përsëri tentuan ta ndalonin duke i thënë se nuk mund të shkonte në atë gjendje. Për këtë arsye, ai shkoi te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut! Bijtë e mi duan të më ndalojnë që të mos marr pjesë në luftë bashkë me ty. Beto hem në Allahun se unë dua të hyj në Xhenet me këtë gjendjen time prej topalli.”

I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: “*Allahu nuk të ka ngarkuar ty me këtë. Xhihadi nuk është farz për ty.*” Ndërsa bijve të tij u tha: “*Mos e ndaloni babain tuaj! Ndoshta Allahu e shpërblen atë me martirizim.*” Amr ibn Xhemuhu (r.a.), e mori armën, u largua nga shtëpia dhe iu përgjërua Allahut: “O Allah! Ma mundëso të bie dëshmor! Mos më kthe pranë familjes duke më privuar nga martirizimi!” Allahu

Teala ia pranoi lutjen dhe ai ra dëshmor. Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, tha: “*Beto hem në Allahun, me fuqinë e të Cilit jetoj, se e kam parë atë duke hyrë në Xhenet duke shqepuar.*”

Ka shumë njerëz që janë të shëndetshëm fizikisht, por të mangët shpirtërisht. Gjithashtu ka edhe shumë njerëz të tjerë që janë të mangët fizikisht, por të shëndetshëm shpirtërisht. E rëndësishme është që t’i kemi edhe shëndetin shpirtëror, edhe shëndetin fizik. Ne duhet të përpiqemi ta plotësojmë çdo mangësi dhe t’i afrohem me butësi çdo njeriu që ka ndonjë mangësi. Ndërkohë asnjëherë nuk duhet të harrojmë se ata që kanë mangësi shpirtërore kanë edhe më shumë nevojë për mjekim. E lusim Allahun Teala të na japë ndriçim të syve e të zemrës dhe shëndet në shpirt e në trup!



Ka shumë njerëz që janë të shëndetshëm fizikisht, por të mangët shpirtërisht. Gjithashtu ka edhe shumë njerëz të tjerë që janë të mangët fizikisht, por të shëndetshëm shpirtërisht. E rëndësishme është që t’i kemi edhe shëndetin shpirtëror, edhe shëndetin fizik. Ne duhet të përpiqemi ta plotësojmë çdo mangësi dhe t’i afrohem me butësi çdo njeriu që ka ndonjë mangësi. Ndërkohë asnjëherë nuk duhet të harrojmë se ata që kanë mangësi shpirtërore kanë edhe më shumë nevojë për mjekim.



Kultura E TELEVIZORIT

— Zahit Genç —

Disa objekte, mjete etj., janë ose të mira ose të këqija në varësi të përdorimit të tyre. Ndërsa disa të tjera, sido që të përdoren gjithmonë janë të dëmshme për njeriun, ngaqë në strukturat e tyre gjendet e keqja. Këtë mund ta themi edhe për vetë njeriun, edhe për ndonjë organ të tij. Siç mund të bëjmë punë të mira me duart, mund të bëjmë edhe punë të këqija me këto gjymtyrë. Aq sa është e mirë një dorë që ledhaton një fëmijë apo një jetim, aq e keqe është edhe një dorë që ngrihet për të goditur një njeri me të padrejtë.

Një mjet tjetër i shekullit tonë që është shumë influencues në edukim, që u drejtohet syve e veshëve, që është shumë i rëndësishëm dhe shumë i përhapur, është televizori që e dini të gjithë. Disa programe që u shfaqen njerëzve me anë të kanaleve televizive në ditët e sotme, është e pamundur të themi se janë të dobishme nëse i analizojmë nga aspekti i dijes, besimit, edukatës dhe moralit. Asnjë njeri me mendje të shëndoshë nuk i konsideron të dobishme këto programe. Mendimtari dhe shkrimtari i madh, Xhemil Meriçi thotë në lidhje me këtë temë: “Unë nuk e pranoj një fenomen që quhet kultura e televizorit. Televizori është një lloj afioni që është shpikur për njerëzit rrugaçë që e kanë humbur dinjitetin dhe që asnjëherë nuk e kanë fituar zakonet për të lexuar dhe menduar.”

Këtë po e them me shumë keqardhje: Në ditët e sotme me qindra mijëra gjimnazistë, dhjetëra mijëra studentë dhe të diplomuar, nuk kanë dijeni për këtë shkrimtar të madh. Ndoshta nuk kanë lexuar as edhe një rresht nga shkrimet e këtij shkrimtari.

Xhemil Meriçi thotë se libri ka qenë, është dhe

do të mbetet mbartësi i kulturës. Gjithashtu thotë: “Kultura e televizorit është një mashtrim që e kanë shpikur ata që kanë vendosur t’i ndërpresin lidhjet me kulturën. Televizori është një lodër djallëzore që e ka futur në vatrën tonë të gjithë imoralitetin e perëndimit.”

Pasi Xhemil Meriçi humbi sytë fizikë, iu hapën sytë e zemrës. Atij i ndodhën shumë ndryshime në botën e besimit dhe të mendimit. Ai mbron mendimin se televizori nuk do ta bëjë perëndimor njeriun tonë, por ka për ta zhytur duke u shprehur: “Ata që e pandehin të vjellin e kapitalizmit si një ushqim i shëndetshëm, janë të predispozuar për të vuajtur nga stomaku.”

Në ditët e sotme, veçanërisht në vendin tonë, koha e harxhuar që kalohet duke ndjekur televizor është shumë e madhe. Programet e televizorit patjetër duhet të përshtaten me vlerat e besimit, moralit dhe traditës sonë. Ato duhet të jenë cilësore dhe nuk duhet të na e çojnë dëm kohën.

Sot televizori është më shumë i dëmshëm se sa i dobishëm. Ne jemi të obliguar ta mbrojmë veten e pasardhësit tanë dhe të mos harrojmë se nesër do të japim llogari për çdo gjë.

Asnjëherë nuk mund ta harroj këtë fjalë që e ka thënë një dijetar i madh mysliman për sëmundjen e televizorit që i ndyn sytë e zemrat tona dhe që e shkatërron kohën e jetën tonë: “Dëmin që armiqët tanë nuk na e kanë bërë dot për një vit ndaj besimit dhe moralit tonë, na e ka bërë televizori.” Unë mendoj se ne duhet të mendojmë thellë rreth kësaj fjale.



Konservatorizmi

— Murat M. Aliu —

Etimologjikisht termi apo shprehja konservatorizëm rrjedh nga fjala latine “conservatore” që do të thotë të *mbrosh* apo *ruash* diçka. Nga perspektiva e ideologjisë politike konservatorizmi synon mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme dhe të brendshme të cilat synojnë apo shkaktojnë ndryshimin formal ose material të strukturave politike, shoqërore dhe ekonomike tradicionale. Në këtë kontekst konservatorizmi është produkt i paradigmës modern dhe procesit të modernizimit, përkatësisht kjo ideologji shpërfaqet menjëherë pas Revolucionit Borgjez Francez. Ndërsa si një *stil, qëndrim, mënyrë e të menduarit* apo *tradihtë e të menduarit* rrënjët e konservatorizmit mund të shkojnë deri në antikitet, përkatësisht mund të gjenden në pikëpamjet dhe ligjerimet filozofike të Aristotelit. Shprehja (termi) “conservator” në Periudhën e Mesjetës është përdorur në kuptimin e mbrojtjes së disa ligjeve dhe grupeve të caktuara shoqërore. Hyrja në literaturën shkencore si koncept politik e filozofik të konservatorizmit ka ndodhur pas Revolucionit Francez të vitit 1789. Ndërsa para Revolucionit Francez konservatorizmi si semantikë është përdorur në kuptimin e mbrojtjes dhe sigurimit të parimeve të drejtësisë dhe civilizimit në përgjithësi.

Në këtë kontekst konservatorizmi si një lëvizje politike (ideologjike) dhe intelektuale lindë si reaksion i ndryshimeve kryesore dhe radikale të cilët ndodhën në sferën shoqërore, politike, ekonomike, kulturore dhe teknologjike. Kësaj Revolucionit

Francez Borgjez si një fenomen politik, shoqëror dhe ekonomik përbën gjeneratorin kryesor për provokimin e ndjenjave konservatore, jo vetëm tek klasa intelektuale, por edhe në mesin e qytetarëve të rëndomtë. Parë në esencë, konservatorizmi qoftë si lëvizje politike, qoftë si një lëvizje intelektuale a filozofike, paraqet një reaksion ndaj parimeve dhe vlerave të iluminizmit dhe paradigmës modern. Ky reaksion, më së miri vërehet në mendimin filozofik, të pishtarit të kësaj ideologjie, Edmund Burke, për të cilën do të flasëm pak më poshtë.

Studiues të ndryshëm të kësaj ideologjije apo lëvizjeje numërojnë tri burime themelore të cilët shkaktojnë lindjen konservatorizmit. Kështu autori turk, Dogu Ergil, mendon se mendimi Iluminist, Revolucionit Francez dhe Revolucionit Industrial janë tri ngjarjet të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë shpërfaqën ideologjinë konservatore në Evropë e më pas edhe në vendet tjera (Ergil: 1986, f.269). Parimet e reja politike sic ishin të drejtat dhe liritë e barabarta të qytetarit, shpërfaqja e sovranitetit të popullit të Revolucionit Francez kanë ndryshuar rrënjësisht sistemin politik të regjimit të vjetër. Ndarja e punës, prodhimi i kufizuar, konsumimi dhe shpërndarja dhe zbulimet teknologjike, kanë sjellë një mendësi krejtësisht të re në sferën ekonomike. Dhe së fundmi, parimi i racionalizmit që simbolizonë filozofinë iluministë ka zëvendësuar traditën dhe normat fetare, të cilët deri më atëherë orientonin individin dhe shoqërinë pothuajse në

të gjitha sferat.

Në këtë kontekst udhëheqësit dhe arkitektët të Revolucionit Frances në fillim u munduan që revolucionon ta shpërfaqin si rezultat i arsyes së pastër dhe përsoshmërisë, që në fakt të dy këto parime paraqesin fundamentin ontologjik të iluminizmit dhe modernitetit. Konservatorët kundërshtojnë formën e realizimit të revolucionit edhe pasojat e tij. Sepse sipas tyre, Revolucionit Frances ka shkaktuar çregullime duke zhvendosur ekuilibrat në shoqëri dhe kështu ka dëmtuar harmoninë shoqërore dhe strukturën tradicionale të shoqërisë. Koncepti i shoqërisë organike i cili ka ekzistuar dhe është përvetësuar me shekuj të tërë në Evropën Perëndimore me revolucionin Frances filloi të dekonstruohet dhe rezikohet dhe në vend të shoqërisë organike është imponuar koncepti i shoqërisë e cila subjektet racional. Ndërsa Revolucionit Industrial ka shkaktuar ndryshime të mëdha në sferën e ekonomisë dhe mënyrën e prodhimit, që çdo mënyrë të prodhimit më pas krijon një kulturë dhe mendësi tjetër. Pra Revolucionit industrial ka hapur rrugën për shkatërrimin e strukturave tradicionale siç është familja dhe komunitet fetare të cilat kanë pasur dhe akoma kanë një rëndësi të vacant për konservatorët. Marrdhëniet familjare dhe fqinjësore, pas revolucionit industrial dukshëm janë ndryshuar. Nga familja tradicionale është kaluar në familjen bërthamore. Transformimi i “gemeinschaft-it” (community) në “gesellschaft” (society) realishtë ka hapur rrugën e tëhuajimit të shoqërisë tradicionale. Kalimi ka komuniteti në shoqëri në fakt do të thotë krijimi i marrdhënieve shoqërore mbi baza të arsyes dhe jo hierarkisë vertikale. Gjithashtu bashkë me Revolucionin Industrial fshati si strukturë “konservatore” filloi të humbë rëndësinë, dhe hapsirat urbane zëvendësuan atë. Ndërsa në hapsirat urbane (qytetet) rëndësia e familjes dhe strukturave të ndryshme të mbullura humbin rëndësinë dhe domososhmërisht këto struktura ndeshen më një fenomen ku duhet hapur. Pra në hapsirat urbane struktura e komunitetit atomizohet kështu me këtë proces atomizohen edhe marrdhëniet tradicionale. Thënë shkurt në këtë periudhë atë që kanë mbrojtur konservatorët është shoqëria organike.

Tani logjikisht parashtrohet pyetja pse konservatorizmi lindi si reaksion i iluminizmit? Ose thënë ndryshe pse një njeri konservatorë kundërshton idetë iluministe dhe revolucionare? Konservatorizmi kundërshton dimensionin racional të iluminizmit dhe modernitetit. Iluminizmi dhe paradigma moderne në esencë jep përparsi arsyes para traditës dhe i gjithë konceptimi kozmologjik realizohet nëpërmjet arsyes duke mos i lënë vend traditës në ndërtimin e rendit social dhe politik. Për më tepër siç dihet iluminizmi si rrymë filozofike apo intelektuale është kundër gjithçka që asocion në *ancient regime* dhe

në vend të vlerave të sistemit të vjetër traditës, religjionit, komunitetit propozon vlerat e reja, siç janë racionalizmi, humanizmi ateizmi etj. Edmund Burke mendësinë iluministe e kritikon më këto fjalë: “*Ne nuk jemi dishepujt e Rousseau-s dhe Volterit: ne nuk mundë të themi që edhe Helvetius-i ka shënuar ndornjë progres të caktuar. Neve nuk mundë të na këshillojnë ateistët, të çmundurit nuk mundet neve të na vendosin rregulla*” (Burke, 2016: 52). Nga këtu shihet qartë që për ideologjinë konservatore është e papranueshëm konceptimi kozmologjik vetëm nëpërmjet arsyes. Sipas tyre në organizimin shoqërorë dhe politik duhet të merrën parasysh traditat, religjioni, kultura, historia e një shoqërie të caktuar. Pra shteti dhe shoqëria nuk mundë të formësohen vetëm nëpërmjet “arsyes së pastër”, koncept që është produkt i iluminizmit.

Pra qëllimi themelor i konservatorizmit nuk është të parashikoj revolucionin, por të parandaloj pasojat e tij të cilat janë shkatëruese për shoqërinë tradicionale. Në këtë kontekst fakti që koncepti i konservatorizmit tredon ndryshueshmëri varet nga struktura dhe kulturat e shoqërive dhe madje edhe refleksionet e ndryshme në një shoqëri të njëjtë por në periudha të ndryshme dëshmon për natyrën dhe cilsinë pragmatike të tij. Nga këtu mundë konkludojmë se ekziston një ambiguitet në përkufizimin e konservatorizmit.

KONSERVATORIZMI NJË IDEOLOGJI MODERNE

Me që në fillim theksuam se konservatorizmi lindi si reaksion ndaj iluminizmit dhe paradigme moderne, logjikisht parashtrohet pyetja a është e mundur `bashkëjetesa` ndërmjet konservatorizmit dhe modernitetit? Thënë ndryshe a është konservatorizmi i prirur të refuzoj tërsisht paradigmen moderne dhe vlerat iluministe? Para së të mundohemi të japëm përgjigje kësaj pyetjeje, menjëherë na duhet të theksojmë që konservatorizmi në esencë është një koncept elastik në kuptimin që është i hapur për ndryshime në kohë dhe hapsirë dhe ngërthen potencialin për tu përshtatur rrethanave specifike. Pra, me fjalë tjera, përdërisa mendimtarët konservatorë në periudhën fillë pas Revolucionit Francës kanë refuzuar pothuajse e gjithë paradigmen moderne dhe vlerat iluministe dhe kërkuan rikthimin e rendit të vjetër (ancient regime), konservatorët bashkëkohorë pranojnë dhe kanë përvetësuar pjesën të madhe të vlerave moderne dhe iluministe dhe përpjekjet e tyre janë në drejtim të thyerjes së dialektikës në mes konservatorizmit dhe modernitetit.

Sidoqoft konservatorizmi ka ruajtur disa vlera dhe parime statike dhe autentike që nga lindja e tij deri më sot. Kësisoj konservatorizmi nuk refuzon tërrësisht ndryshimin, por atë që mëton konservatorizmi është që ndryshimet shoqërore të realizo-

hen në mënyrë evolutive në emër të traditës dhe vlerave historike dhe jo në mënyrë revolucionaore. Për një konservator është shumë me rëndësi që të ruhet kontinuiteti historik i dukurive shoqërore, politike dhe ekonomike. Konservatorizmi në emër të kontinuitetit historik pranon ndryshimin, por me kusht që të mos ndodh shpërbërje esenciale-radikale ndërmjet fenomeneve. Për konservatorët ndryshimi me intensitet mesatar është i pranueshëm. Qëllimi esencial i këtij diskursi është se konservatorizmi nuk dëshiron të humbë kontrollin përgjat procesit të ndryshimit .

EDMUND BURKE

Edhe mendimi filozofik konservatorë i Edmund Burke në esencë është formësuar si kundërin e iluminizmit dhe racionalizmit. Burke në fakt mbron një epistemologji e ku në rëndë të parë janë konceptet sic janë imagjinata/fantazia, paragjykimi, instikti dhe tradita të cilët i vëndosë si alternative të aryes së pastër. Burke i cili rilindasit racionalist i cilësonë si “metafizikanë”, kundër produkteve të aryes së pastër vëndos produktet të historisë dhe traditës. Domethënë mendimet e Burkesë asesi nuk duhet interpretuar si refuzim të aryes, por ajo si një përpjekje për të dëshmuarë se arsyeja e cila paraqitet si e pavarur dhe privuarë nga çdo ndikim i jashtëm, në fakt është refleksion i pasioneve. Sepse sipas tij është e pamundur logjikimi i njeriut duke qenë plotësisht i privuarë nga paragjykimet dhe ndikimi i disa faktorëve, për më tepër faktorëve historik.

Nga këtu mundë të konstatojmë se konservatorizmin në rastin më ekstrem mundë të përkufizohet si një lëvizje anti-ideologji. Por edhe këto prirje anti-ideologji në asnjë mënyrë nuk mundë të konsiderohen si një mohim absolut të vlerave moderne dhe iluministe. Fakti që konservatorizmi kundërshton një pjesë e vlerave iluministe dhe moderne nuk do të thotë që duhet kuptuar dhe përkufizuar si një ideologji “anti-moderne”. Sepse në instanc të fundi konservatorizmi lindi në një periudhë të caktuar të ndryshimeve të mëdha sociale, politike dhe kononike, ndryshimet të cilat ishin pasojë direkte të paradigmës moderne në përgjithësi.

Përfundimisht një përkufizimin i logjikshëm do të ishte që konservatorizmi nuk është një ideologji reaksionare e cila mohon gjithçka që ka të bëjë me modernitetin dhe iluminizmin. Në vend të reaksionarizmi dhe lidhshmërinë me të kaluarën konservatorizmi është ngusht i lidhur e vlerat tradicionale. Qëllimi esencial i konservatorizmit është që përgjat procesit të ndryshimeve të merren parasysh vlerat tradicionale të një shoqërie të caktuar. Prandaj konservatorizmi nuk është një fenomen i ngrirë në të kaluarën, por është një ideologji koherente në kontinuitetin tradicional.

Ju prezantojmë me “stresin”, njëri prej gurëve kilometrikë të jetës sonë, shkaktarit të sëmundjeve, lënda e parë e dëshpërimit dhe arsyesimi i mos-sukseseve!..

Një profesor po u jepte nxënësve të vet mësim në lidhje me “menaxhimin e stresit”:

Ai ngriti lart një gotë të mbushur me ujë dhe i pyeti nxënësit: “Sipas jush, cila është pësja e kësaj gotë të mbushur me ujë?” Përgjigjet ndryshonin nga 200gr në 400gr. Pas kësaj, profesori tha: “Pësja reale nuk ka rëndësi. Situata ndryshon në bazë të kohës që ju e mbani atë në dorë. Nëse e mbaj për një minutë, nuk ka asnjë problem. Nëse e mbaj për një orë, krahu im do fillojë të më dhembë. Nëse e mbaj një ditë të tërë, mbase do të duhet të thërrisni një ambulancë. Në fakt, pësja është e njëjtë, por sa më shumë ta mbani, aq më shumë do fillojë të rëndojë.”

Padyshim se të gjithëve na ndodhin gjëra që ne i quajmë “ngarkesa” dhe të cilat shkaktojnë stres. Mirëpo, është e domosdoshme që “ngarkesën” tonë ta ulim për pak kohë, të çlodhemi, e kur të kemi marrë fuqi, ta vazhdojmë përsëri udhën tonë së bashku me to. Pra, kur kthehemi nga puna apo nga shkolla për në shtëpi, ne duhet t’i lëmë problemet tonë jashtë. Sidoqoftë, të nesërmen do t’i marrim prapë mbi supë. Mirëpo, kësaj here do t’i shohim gjërat më me gjakftohtësi dhe do të vëmë re se në fakt nuk është edhe ndonjë situatë që duhet ekzagjeruar edhe aq shumë.

Nëse krijoni një marrëdhënie midis përgjegjësisë tuaja dhe stresit që keni, do të thotë se bëni pjesë në njërin prej tre kategorive të mëposhtme:

1- Ata që mendojnë se janë “supermenë” dhe se gjithçka është në përgjegjësinë e tyre.

2- Ata që i ikën përgjegjësisë duke thënë: “Punë, punë natë e ditë, por deri kur? Edhe sikur të mos bëj gjë, bota do vazhdojë të rrotullohet!”

3- Ata që thonë: “Unë jam njeri i arritur, por ende s’ka lindur ai që do të zbulojë vlerën time!”

Ata që bëjnë pjesë në kategorinë e parë:

Edhe supermenët mund të stresohen. Pa-tjetër që edhe ju do e keni parë goftë një-rën prej serive të filmit “Supermen”. Personazhi kryesor, Klarku, është një njeri me punë dhe jetë të zakonshme. Ndërsa në situata të jashtëzakonshme, thotë, “më duhet të shkoj deri në tualet” dhe sapo del nga dera, vishet si Supermen dhe hidhet si rrufe për të shpëtuar situatën. Qëllimi i tij është të zgjidhë të gjitha problemet. Ky personazh, fluturon sa andej kënde dhe i zgjidh



I thoni stresit:

Një “*coffe break*” ju lutem!

— Aishe Kurudere —

të gjitha problemet me sukses. Ndërsa shokët e punës së Klarkut mahniten nga këto që ndodhin. Pasi e zgjidh problemin, Klarku, i lodhur e i rrskapitur kthehet në zyrën e tij si nëpunës. Shokët e punës, i thonë Klarkut, i cili u kthye pasi iku Supermeni:

“Fli ti fli! A e pe çfarë bëri Supermeni?”

“Ç’kemi Klark, duhej ta kishe parë Supermenin!”

“Ej Klark, kur do bësh ndonjë gjë të vlefshme?”, etj...

A ia del dot Supermeni në këtë jetë?

Edhe juve mund t’ju ndodh të punoni si Supermeni dhe të vlerësoheni si Klarku.

Në muzikën e filmit “SpiderMan/Njeriu Merimangë”, thuhet:

“*You say we’re not responsible, but we are, we are!*”

“*Ju thoni se nuk jemi përgjegjës, por ne jemi, ne jemi!*”

Ata që bëjnë pjesë në kategorinë e dytë dhe stresohen duke i ikur përgjegjësi:

Këta nuk mund t’i arrijnë ëndrrat e tyre, prandaj edhe nuk vendosin qëllime. Kjo është një nga sëmundjet më të mëdha të të rinjve të sotëm. Deri

në vitin e fundit të gjimnazit fle gjumë, e në fund të shkollës i fillon një stres provimesh dhe përpiqet të mësojë gjithçka për një kohë shumë të shkurtër. Megjithëse nuk është aspak realist, synimi i tij është “Mjekësia”. Këtë as vet s’e beson. Mirëpo ka një shpresë kot, “Po sikur!?”... Afër provimeve e kupton se kjo është e pamundur dhe merr vendimin se vitin tjetër do të përpiqet më shumë dhe do të përgatitet më mirë. Mirëpo, kësaj here fillon të stresohet me mendimin se a do ta lejojnë të shtëpisë të studiojë edhe një vit për të fituar shkollën e lartë. Ja pra, stresi fillon përsëri...

E në fakt, nëse çdo nxënës përpiqet t’i zgjidhë problemet e një viti, po atë vit, nuk do të mbetet më asnjë problem në fund të shkollës. Por kjo nuk është vetëm për shkollën. Nëse ne nuk bëhemi prej atyre që e lënë punën e sotme për nesër, shigjeta e problemeve do të bjerë në zero.

Dheee... kategorja e tretë... Ata që stresohen duke menduar se kanë shkuar dëm:

Kategoria e parë, stresohet dhe vështirësohet për shkak se janë të detyruar të bartin shumë peshë, ndërsa kategorja e dytë për shkak se nuk i marrin në kohën e duhur përgjegjësitë e jetës. Mirëpo gjendja e kategorisë së tretë, është pak më ndryshe. Ata dëshirojnë të marrin përgjegjësi. Dhe, duke e ditur aftësinë dhe potencialin e tyre, ata dëshirojnë t’i zgjerojnë kufijtë. E megjithatë, për shkak të faktorëve të jashtëm, ata ndjehen sikur janë të kufizuar brenda një kafazi. “Potenciali im në kafaz të artë, po shkon kot dalëngadalë!” - mendojnë ata.

Nëse e shfaqni pak më tepër veten, e nëse e ndihmoni pak atë që do t’ju zbulojë, as bota nuk do të privohet prej perlave si ju, e as ju nuk do të ikni nga kjo botë, duke thënë, “s’më dhanë asnjë mundësi në këtë nënqiell”...

Jemi të rinj, të bukur, të pashëm, energjikë, të preokupuar, por edhe të stresuar...

O ti i ri! I thua stresit, “një coffee break!” të lutem!...



Detyrat e rinisë myslimane

Ferit Piku

Profeti ynë Muhamedi (a.s) ka thënë: **“Shfrytëzoji pesë gjëra përpara se të vijnë pesë të tjera: rininë tënde përpara pleqërisë, shëndetin tënd përpara sëmundjes, pasurinë tënde përpara varfërisë, kohën e lirë përpara se të angazhohesh, shfrytëzoje jetën përpara se të vdesësh”.**

Në këtë temë do të shohim detyrat e rinisë myslimane, por nuk dua që dikush të mendoje se nuk është pjesë e rinisë. Njeriu quhet i ri deri kur arrin moshën 50 vjeç. Por kjo temë ka shumë lidhje edhe me atë person që i ka kapërcyer të 50-tat të cilëve u themi: “Puno me të vegjlit se ata shpejt bëhen rini dhe nëse nuk ke mundësi për këtë, atëherë të paktën lutu për të rinjtë, se e ardhmja e rinisë është e ardhmja e fesë, është e ardhmja e të gjithë popujve”.


Rinia është ajo forcë, e cila nuk njeh kurrë pengesa. Rini do të thotë: Gjak që vlon në damar, vullnet që nuk thyhet kurrë, është drita që duket në fund të tunelit.

Rinia ka edhe detyra në mënyrë që të mos fluturojmë në qiell me kokën mbi re, por ta shohim praktikisht Islamin bashkë me të drejtat dhe detyrimet që ka ai.

Jo çdo rini është e ardhme. Ka rini që është shka-

tërrim për të ardhmen e popujve. Unë flas për rininë myslimane, për atë rini që beson në Zot, që e ndjen se ka një mision të madh mbi supet e saj. Pra, cilat janë detyrat e kësaj rinie dhe çfarë pritet prej saj:

1- Detyra jonë e parë si myslimanë, djem apo vajza, është **të jemi krenarë për fenë e Zotit**, pra për Islamin. Këta të rinj duhet të jenë krenarë, sepse Zoti i ka zgjedhur si me dorë nga shumica e të rinjve të tjerë dhe i ka nderuar me këtë fe. Të jesh i sigurt, se në momentin që ke hyrë në xhami ke ardhur me ftesën e Zotit, pasi Ai të ka ftuar dhe ti i je përgjigjur ftesës. Ka shumë të tjerë që mund të jenë më të zgjuar dhe më të aftë se ti, madje kanë më shumë kohë të lirë por Zoti ka caktuar të jesh ti pjesëtar i kësaj feje dhe jo ata. Shpresojmë që Zoti t'i përfshijë edhe shumë të rinj të tjerë në këtë fe madhështore. Zoti të ka zgjedhur dhe të ka futur në shprehjen: **“O robtë e Mi”, “O ju që keni besuar”**. Kjo është thirrja më intime që Zoti i bën vetëm besimtarëve. Ai të ka ftuar dhe të ka bërë nga pasuesit e Muhamedit (a.s). Ji krenar, se Zoti të ka bërë dëshmitar për të gjithë njerëzit, që edhe sot në kohët më të vështira ti të jetosh si mysliman, të jetosh me Islamin, në mënyrë që njerëzit të mos thonë se është e pamundur të jesh mysliman sot, të mos thonë se është e vështirë ta jetosh jetën me hallall. Prandaj kur ti jeton me hallall, je dëshmitar



“Shfrytëzoji pesë gjëra përpara se të vijnë pesë të tjera: rininë tënde përpara pleqërisë, shëndetin tënd përpara sëmundjes, pasurinë tënde përpara varfërisë, kohën e lirë përpara se të angazhohesh, shfrytëzoje jetën përpara se të vdesësh”.

për të gjithë të tjerët. Duhet të jemi krenarë për këtë fe, ta dimë që është nder dhe dhuratë e madhe prej Zotit. Njerëzit krenohen sot para njëri – tjetrit se janë nga veriu apo nga jugu, se janë të djathtë apo të majtë, se kanë pasuri apo jo, se kanë karrierë apo jo. Në fakt karriera, pushteti dhe pasuria më e madhe është besimi në Zot, prandaj le të jemi krenarë që Zoti na ka bërë pjesë të fesë së Tij.

Selman Faresiu (r.a) nuk ishte arab, as Kurejsh as nga Medina. Kur myslimanët e parë pyesnin njëri – tjetrin se nga cili fis ishin, atëherë kur secili përmendte me krenari fisin e tij, Selmani (r.a) tha: “Unë jam bir i Islamit, nuk kam baba tjetër veç tij”. Profeti (a.s) i rrihte shpatullat Selmanit (r.a) dhe thoshte: “**Selmani është prej meje, prej banorëve të shtëpisë time, prej më të afërmeve të mi**”.

Kur flas për krenari, nuk duhet të tërhiqemi e të kemi turp se jemi myslimanë. Besimi mund të fshihet vetëm në dy raste: 1. Atëherë kur të rrezikohet jeta dhe 2. kur ke një interes shumë më të madh dhe për momentin nuk e deklaron. Përndryshe, nëse dikush të thotë: “Selam alejkum”, ti thuaj me krenari: “Ue alejhkum selam ue rahmetullah”. Nëse je me shami, mbaje me krenari, nëse fal namaz, thuaje me krenari sepse nëse e fsheh atë, ti bëhesh provë për njerëzit e tjerë.

Por krenaria për të cilën po cek, nuk është euforizëm, nuk është mendjemadhësi sepse të jesh mysliman do të thotë të jesh krenar dhe të kesh përgjegjësi, pra ta tregosh veten tënde jo me fjalë por me punë.

2- Detyra e dytë që na del si myslimanë është **ta kuptojmë drejt fenë e Zotit**. Islami është madhështor. Ai është prej Zotit por atë e zbaton njeriu. Islami është i pafajshëm, por fajtor është ai, i cili abuzon me Islamin. Prandaj mësoje mirë këtë fe, që të mos bëhesh shkak që njerëzit të largohen prej saj. Profeti (a.s) thoshte: “**Kur Zoti e do një njeri, e bën që ta kuptojë fenë e Zotit**”. Të kuptosh drejt Islamin do të thotë të jesh:

a) Larg ekstremizmit: Kjo fe nuk ka nevojë për ekstremizëm e për kokëfortësi. Ajo e ka brenda argumentin dhe forcën e saj.

b) Larg kapjes pas një pike: T`i mëshosh gjithë jetën vetëm një pjesë të fesë e ta lësh pjesën tjetër, ndërkohë që ajo është vetëm një pike e vogël e detit të madh të quajtur Islam. Një njeri i thjeshtë erdhi tek profeti (a.s) dhe e pyeti: “O profet i Zotit, çfarë detyrash ka caktuar Zoti ndaj meje”? Profeti (a.s) i përmendi shehadetin (dëshminë), namazin, agjërimin, zekatin dhe haxhin, si detyrat kryesore

të fesë. Atëherë ky njeri tha: “Vallahi as nuk do të shtoj e as nuk do të pakësoj” dhe pastaj u largua. Profeti (a.s) tha: **“Nëse i qëndron kësaj fjale, ai do të hyjë në xhenet”.**

c) Larg formalizmit: Shpeshherë e kemi nxjerrë Islamit si feja e rregullave, feja e pamjes së jashtme, a thua se në këtë fe nuk ka shpirt, nuk ka dashuri. Të krishterët krenohen se feja e tyre është feja e dashurisë, ndërkohë që gjatë gjithë historisë njerëzore feja e tyre ka qenë feja e rregullave të ngurta. Ajo është feja e murgjërve, të cilët nuk kanë dalë e nuk kanë pasur kontakt me të tjerët. Ndërsa Islami është feja e të gjithë popujve, fe e jetës dhe e dashurisë, fe e jetës së jetuar 24 orë në 24. Prandaj ftoj veten time dhe të gjithë të rinjtë myslimanë që të hyjmë thellë në këtë fe dhe t'i tregojmë botës së Islami është shumë më i madh sesa e mendon bota sot atë.

d) Larg fanatizmit: Fanatizëm do të thotë të kesh bindjen, se mendimi yt është 100% i saktë dhe mendimi i tjetrit është 100% i gabuar. Por përveç fjalës së Zotit dhe mendimit të profetit (a.s), mendimet e njerëzve të tjerë nuk janë 100% të sakta. Imam Shafiu, një dijetar i madh, thoshte: “Besoj se mendimi im është i saktë, por nuk është çudi që të jetë

edhe i gabuar. Besoj se mendimi i tjetrit është i gabuar, por nuk është çudi që të jetë edhe i saktë”. Ndërsa sot të rinjtë myslimanë thonë: “Mendimi im është më i saktë dhe kundërshtari e ka tërësisht gabim”. Prandaj kjo na ka bërë që të ndahemi në grupe e në xhemate dhe ta urrejmë njëri – tjetrin për gjëra shumë të vogla.

Në historinë islame ka pasur njerëz të rinj shumë besimtarë e të sinqertë, me dashuri të madhe ndaj Zotit, por ata nuk kishin kuptimin e fesë. Djeni se këta njerëz kanë qenë sprovë dhe shkatërrim më i madh për atë popull. Profeti (a.s) ka paralajmëruar për këta njerëz, duke thënë: **“Janë njerëzit më të këqij që ka krijuar Zoti”.** Hadithi këtu flet për havrixhët, të cilët u bënë shkak që të vriten myslimanë, thjesht për faktin se të tjerët mendonin ndryshe nga ata. Ata vranë imam Aliun (r.a), prijësin e myslima-

nëve, sepse ai nuk mendonte si ata. Prandaj kuptimi i gabuar i kësaj feje, mund ta shkatërrojë Islamit, myslimanët dhe mbarë botën.

3- Detyra e tretë e rinisë myslimane është **të mos nxitohet**. Është gjë e mirë kur ke pasion dhe dëshirë për ta përhapur Islamit, por mos i nxito dhe mos i bëj të tjerët armiq edhe pse i ke kundërshtarë. Jo të gjithë ata që flasin kundër Islamit janë armiq, sepse nuk e njohin atë. Jo të gjithë ata që të shajnë ty janë armiqtë e tu, sepse akoma nuk të kanë njohur. Fatkeqësisht rinia myslimane sot bën viktimën dhe thotë: “Gjithë bota janë armiqtë tanë, të gjithë na urrejnë, të gjithë na e duan të keqen”. Në fakt kjo s'ka qenë tradita e profetit (a.s). Në Medinë, çifutët ishin të zgjuar dhe kur e përshëndesnin profetin (a.s.) në vend që t'i thoshin “Es selamu alejkum – paqja qoftë mbi ty”, i thoshin “Es samu alejkum – vdekja qoftë mbi ty”. Ndërsa

ai që e kuptonte fare mirë se çfarë thoshin ata, ua kthente: “Ue alejkum – edhe mbi ju”. Një ditë Aishja (r.a), bashkëshortja e profetit (a.s), e dëgjoji këtë fjalë nga çifutët u kthye nga ata dhe u tha: “Mbi ju qoftë vdekja dhe mallkimi i Zotit o armiqtë e Zotit”. Por profeti (a.s) i tha: **“O Aishe, pse nxitohesh. Feja jonë është e butë dhe Zoti dëshiron që të jemi**

të butë në çdo situatë. Unë thjesht u thashë se edhe mua ashtu si ju, do të më marrë vdekja, prandaj mos u mërzi”. Le ta marrim profetin (a.s) si modelin më të mirë.

4- Detyra e katërt është **të shtojmë dijet**. Kjo është një detyrë shumë e madhe. Me dhimbje të plotë themi se sot fatkeqësisht pjesa më e madhe e botës islame është *botë e tretë* dhe po të kishte një kategori *“Bota e katërt”*, përsëri aty do të renditeshin myslimanët e sotëm. Islami akuzohet sot se është shkaktari kryesor i prapambetjes së myslimanëve. Ndërsa ne që falemë në xhami dhe e njohim këtë fe, jemi të sigurt se Islami nuk është shkaktar për prapambetje, përkundrazi ai fton për dituri, madje fjala e parë në Kuran ishte: “LEXO”, pra mëso, shtoji dituritë dhe njohuritë e tua. Ne jemi të sigurt se myslimanët nuk kanë qenë të tillë. Atëherë nëse të



O Aishe, pse nxitohesh.
Feja jonë është e butë dhe Zoti dëshiron
që të jemi të butë në çdo situatë.
Unë thjesht u thashë se edhe mua
ashtu si ju, do të më marrë vdekja,
prandaj mos u mërzi.





dhemb zemra për këtë fe, nëse je i sigurt se Islami nuk të pengon nga dituria, le të luftojmë që ta lar-gojmë këtë plagë, duke mësuar e lexuar ashtu siç kanë qenë dikur myslimanët e ditur. Të tregojmë me punë dhe jo me fjalë, se kjo është fe e diturisë, fe e njerëzve të mençur.

Ne duhet të shtojmë jo vetëm dijen fetare, pasi ekziston mendimi, se i ditur është vetëm ai që mëson për fe, ndërsa të tjerët punojnë për dynja. Dije dhe mësoje se në çdo punë ku ti e fiton riskun me hallall, me të cilën ti ushqen fëmijët e tu dhe i shërben shoqërisë, je në një rrugë që inshallah do të të çojë në xhenet dhe do t'ia shohësh hajrin në këtë botë dhe në botën tjetër.

Myslimanët dhe sidomos rinia myslimane është mjaft e zgjuar, por fatkeqësisht nuk kanë shumë vullnet dhe sidomos kur vjen puna tek dituria. Ndërsa të parët tanë kanë thënë kështu: “Nëse diturisë ia jep gjithë qenien tënde, do të të japë vetëm një pjesë të vogël të saj, por nëse i jep vetëm pak prej vetes tënde, ajo nuk të jep asgjë”. Të mos i shtojmë dituritë tona vetëm për të bërë karrierë, për të marrë një rrogë, por për t'i shërbyer shoqërisë tonë. Ajo që e dallon rininë tonë myslimane nga të rinjtë e tjerë, është se ne duam të mësojmë, me qëllim që t'i shërbejmë këtij vendi, këtyre njerëzve që kanë nevojë për ndihmën tonë dhe nuk marrim dituri thjesht për të ngrënë një copë bukë, se riskun tonë se merr askush tjetër veç nesh.

5- Një detyrë e madhe, në mos më e madhja se gjithçka që kam përmendur deri tani, e cila i del përballë rinisë myslimane, atyre prej të cilëve inshallah pritet e ardhmja dhe shpresa, është **OPTIMIZMI DHE SHPRESA PËR TË ARDHMEN**. Të jeni të sigurt se të gjithë njerëzit që kanë ndryshuar historinë e popujve, kanë qenë njerëz optimistë. Po të mos kishin besuar tek e ardhmja, do të rrinin bashkë me të tjerët dhe askush nuk do t'i kishte përmendur. Por ata besuan tek një e ardhme më e mirë, i përveshën krahët dhe e ndryshuan realitetin. Nëse ne kemi dëshirë të bëjmë diçka ndryshe, duhet të kemi shumë besim dhe optimizëm.

Nuk i ka hije një myslimani që të jetë pesimist, pasi pesimizmi është vëllai i mohimit (kufrit) dhe vetëm qafiri është pesimist. Një mysliman që është

në lulen e rinisë së tij, atëherë kur akoma nuk ka halle, nuk i shkon që të jetë pesimist, i mbyllur në vetvete. Sot dëgjon dialogë të tipit: “Si të shkojnë punët? - Ashtu, copë-copë, e shtyjmë disi jetën”. Me këto fjalë e kalojmë ditën, duke i vrrarë shpirtin dhe zemrën njëri – tjetrit. Kur rinia mezi e shtyn jetën, çfarë mund të themi për moshat e tjera.

Prandaj le të kemi më shumë shpresë dhe optimizëm tek e ardhmja e kësaj feje dhe gjithë njerëzisë, se jemi myslimanë që kanë besuar Zotin e gjithësisë, i Cili ka premtuar se do t'iu japë triumf besimtarëve të Tij. Kur myslimanët po kalonin momentet më të vështira, profeti (a.s) thoshte: **“Zoti është më i madhi, do të çlirohet Persia”**. Ai (a.s) karikon-te zemrat e të rinjve që edhe ata të bëhen burim shprese për njerëzit e tjerë.

Ne nuk besojmë vetëm në dynja, se ajo është shumë e vogël. Ne besojmë diçka që shkon përtej dynjasë, ne besojmë se ka Xhenet dhe ai që e beson këtë, e ka haram të jetë pesimist dhe t'i këpusë shpresat. Përkundrazi një person i tillë duhet të ketë bindje, se Zoti ka për ta ndryshuar këtë jetë për mirë dhe gjithashtu duhet të shpresojë që Zoti ta falë e ta fusë në Xhenet.

E mbyll këtë temë me një këshillë për veten time dhe për të gjithë ata që i lexojnë këto rreshta: **Mos u ndaj nga xhemati** (bashkësia islame), **mos u ndaj nga vëllezërit dhe motrat e tua, kushdo qofsh ti, sepse sado i zgjuar, i pasur, i sinqertë, i udhëzuar të jesh, ti je i dobët kur je vetëm, por je i fortë kur je përkrah vëllezërve të tu**. Profeti (a.s) ka thënë: **“Xhemati është mëshirë, ndarja është shkatërrim. Dora e Zotit dhe mëshira e Tij janë me xhematin dhe kush largohet nga xhemati, ka marrë rrugën për Xhehenem”**.

E lus Zotin, që ta shtojë vëllazërinë tonë, të na bëjë shkak për lartësimin e kësaj feje. O Zot bekoje, lartësoje dhe fisnikëroje rininë myslimane në këtë botë dhe në botën tjetër. Bëje atë burim shprese e optimizmi, bëje shkak për ndryshimin e situatës, drejt një të nesërmeje që është shumë më e mirë se kjo e sotmja, drejt një ahireti që është më i mirë se dynjaja. O Zot na përfshij në mëshirën Tënde dhe na bëj pjesë të Xhenetit Tënd.

Amin!..

Gratë punëtore që ndodheshin pranë Pejgamberit (a.s.)

— Melike Shahin —

Gjatë historisë islame kishte shumë shembuj të grave që punonin. E para nga këto ishte bashkëshortja e parë e Pejgamberit (a.s.), nëna jonë Hz. Hatixhe. Ajo e kishte bërë pasurinë në sajë të karvanëve tregtarë. Duke ndarë fitimin me njerëzit që kishte vendosur në krye të karvanëve dhe të cilët ushtronin tregtinë që sot quhet “Import-eksport ndërkombëtar”, vuri një pasuri me të vërtetë të konsiderueshme. Pesëmbëdhjetë vjet pas martesës që bëri me Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem, të Dërguarit të Allahut

i erdhi profecia dhe ajo që një nga gratë fatlume që e ktheu pasurinë e kësaj bote në kapital të Ahiretit duke e lënë të gjithë pasurinë në shërbimin e Pejgamberit (s.a.s), Diellit të dy botëve.

Nëna jonë, Hz. Ajshe e cila ishte njëra nga bashkëshortet që Pejgamberi donte më shumë, posedonte një horizont të gjerë inteligjence. Ajo me këtë kulturë të gjerë, memorien e pashoqe dhe inteligjencën dallohej nga gratë e kohës së saj. Qoftë në kohën kur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem jetonte, qoftë pas shtegimit të tij në botën tjetër, ajo që mësuese shembullore në tubimet e dijes. Për këtë arsye nganjëherë formoheshin vende qëndrimi në Meke dhe Medine për njerëzit që vinin nga zona të largëta dhe në këto çadra zhvillohej mësim i niveleve të ndryshme për gratë. Nëna jonë, Hz Ajshe, duke përfituar shumë nga burimi i profecisë së Pejgamberit (a.s.), e zhvilloi veten në mësimin e hadithit, tefsirit (ko-

محمد
صلى الله عليه وسلم



mentimit të Kuranit) e fikhut (jurispundencës Islame) dhe luajti rol parësor në përhapjen dhe zhvillimin e këtyre dijeve.

Po ashtu edhe gratë e tjera të Pejgamberit janë munduar të fitojnë të ardhura në mënyra të ndryshme si: një pjesë e tyre duke përpunuar lëkura, disa duke përdorur aftësitë e duarve dhe disa të tjera duke bërë qepje e qëndisje. Por me këto përpjekje, përveç fitimin e parave, kishin për qëllim të ishin të dobishme për shoqërinë, sepse të ardhurat që fitonin, gjithmonë i ndanin me njerëzit që ishin më të varfër se ato dhe pothuajse nuk ishin aspak të qeta nëse posedonin një pasuri sado të vogël të kësaj bote.

Në kohën e Hz. Ebu Bekrit e sidomos të Hz. Umerit, ata përpiqeshin t'i ndanin me të tjerët edhe rrogat që merrnin nga "Bejtu'l-Mal" (thesari i shtetit). Bujarinë e tyre në këtë çështje duam t'ju shprehim me këtë tregim shumë të bukur:

Ndërkohë që të ardhurat e thesarit shtoheshin, Hz Umeri kishte ndarë një buxhet vjetor për të përballuar nevojat e domosdoshme të disa sahabëve dhe sidomos familjes së Pejgamberit (a.s.). Mbështetjen e parë ia dha nënës sonë, Hz. Zejnep Bintu Xhahshit. Kur nëna jonë, Hz Zejnep pa gjithë këto para, u habit shumë dhe pyeti:

"Allahu e faltë Umerin! Edhe pjesa e motrave të mia janë brenda kësaj?"

Korieri që solli paratë tha:

"Jo, këto janë të gjitha tuajat!.."

Për këtë ajo tha:

"Subhanallah!.." dhe duke i mbuluar paratë me një copë, i tha shërbëtores:

"Fute dorën, merr një grusht nga këto para dhe dërgojua fëmijëve. Merr një grusht tjetër dhe dërgoja filanit." Në këtë mënyrë ua shpërndau të afërmeve dhe të mjerëve. Poshtë mbulesës nuk ngelën shumë para. Shërbëtorja i tha:

"O nëna e besimtarëve!.. Allahu ju faltë! Kemi edhe ne pjesë të këto para." Pas kësaj fjale, nëna jonë Zejnep tha:

"Ato që kanë ngelur poshtë copës, janë të tuat."

Kështu ajo i shpërndau të gjitha paratë që i erdhën. Kur shërbëtorja e ngriti mbulesën, poshtë saj kishin ngelur vetëm tetëdhjetë e pesë dirhem të cilat i mori. Nënës sonë Zejnepes nuk i ngeli asgjë nga këto para.

Kur halifeja i dytë i Islamit, Hz. Umeri dëgjoji për këtë ngjarje, shkoi te dera e saj, i dha selam dhe i tha:

"Dëgjova se i ke shpërndarë të gjithë dirhemët që të dërgova më parë. Të kam sjellë njëmijë dirhem që t'i mbash për vete."

Hz. Umeri i solli asaj edhe njëmijë dirhem të tjerë, por ajo veptoi ashtu si më parë duke i shpërndarë të gjitha.

Ajo ndërroi jetë para se të merrte paratë të cilat Hz. Umeri i dërgoi vitin tjetër si mbështetje për "nënat e besimtarëve".

Në ajetin fisnik gratë besimtare këshillohen që të qëndrojnë të ndershme në shtëpitë e tyre. Në ajetin 33 të sures Ahzab thuhet:

"Qëndroni në shtëpitë tuaja e mos i zbuloni stolitë tuaja ashtu siç zbuloheshin në kohën e padijes! Falni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni Allahut e të Dërguarit të Tij! O Familje e Profetit! Në të vërtetë Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."

Fjalët e këtij ajeti dhe të atij më përpara (el-Ahzab, 32.) së pari janë për gratë e Pejgamberit (a.s.). Edhe pse afrimiteti me Pejgamberin dhe gjendjet e tyre të veçanta janë theksuar me këto shprehje, dispozita është publike. Pra i përfshin të gjitha gratë besimtare. Çështja të cilën ka për qëllim ajeti fisnik është qëndrimi i grave në shtëpi dhe ruajtja e nderit, sepse Allahu i do më të pastra.

Më gjithë këtë, siç e shprehëm edhe më lart, ka shumë transmetime se në bazë të nevojave, edhe gratë e Pejgamberit (a.s.), edhe gratë e sahabëve kanë punuar në punë të ndryshme.

Kishte gra që bënë infermieren në luftëra, shpërndanin ujë te luftëtarët e plagosur në fushën e betejës, madje përdornin edhe shpatën e luftonin me armikun, ushqenin me gji dhe kujdeseshin për fëmijët e të tjerëve, punonin bashkë me bashkëshortin familjen në fushat e hurmave, merrnin pjesë në predikime e aktivitete të thirrjes në Islam, ngarkoheshin me detyrën e pastrimit të xhamisë, ushtronin zanate të ndryshme, interesoheshin me shqetësime të ndryshme që u përkasin grave, madje në kohën e Hz. Umerit kishte gra sahabe që inspektonin tregjet. Këta janë shembuj të gjallë që tregojnë se në ç'fusha ka nevojë Islami për gruan dhe me çfarë detyrash është ngarkuar ajo gjatë historisë.



Të jesh Zonjë në një familje

— Zahide Topçu —

Njerëzit të ditur kanë dhënë shumë këshilla të arta për gratë. Një pjesë të këtyre këshillave do t'i përmendim më poshtë:

“Edukimi fillon në familje. Vendi ku vajzat e reja marrin edukimin e parë, është familja e tyre. Zonjat që kanë marrë edukimin e familjes, u mundësojnë bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre një jetë parajsë. Ndërsa vatrën familjare që formojnë djemtë dhe vajzat që janë rritur pa edukimin e familjes, zakonisht bëhen vende ku përjetojnë shqetësime shumë serioze.

Në familje gruaja veçanërisht duhet të jetë e zgjuar, e urtë dhe e komunikueshme. Që në moshën e fëmijërisë duhet të marrë pjesë në tubimet e dijes dhe bisedave fetare, të mësohet ta dojë hyzmetin dhe të jetë bujare e të japë në rrugë të Allahut... Duhet të mësojë që çdo punë ta bëjë në kohën e duhur...

Allahu ia begaton ditën atij që ia di vlerën kohës! Ai që e ka të bekuar ditën, në kohë të shkurtër gjen rastin për të bërë shumë vepra të mira. Njeriu që i shërben fesë së Allahut, sado që të rëndë, nuk ndjen lodhje. Po ashtu ky njeri nuk ndjen kurrë shqetësim shpirtëror dhe zemrën e ka të gjerë. Bëhet i dashur e miqësor. Fytyra gjithmonë i përhap buzëqeshje dhe kur njerëzit e shohin, i harrojnë hallet e shqetësimet. Pikëllimi që kanë përbrenda u zhduket.

Siç thotë edhe Mevlana: “Mundohu të bëhesh balsam për zemrat dhe jo gjemb!..”

Gruaja e dashur dhe punëtore ia di vlerën çdo çasti dhe e vlerëson kohën me gjërat më të rëndësishme të atij momenti. Mundohet t'i mësojë ato që nuk i di dhe t'ua mësojë të tjerëve ato që di. Nuk i frekuenton bisedat që nuk janë të dobishme për këtë botë e për botën tjetër dhe qëndron larg vërdallisjeve e argëtimeve. Nuk e humb kohën me këto gjëra.

Pesë gjëra ia lumturojnë zemrën: Të qëndruarit vazhdimisht me abdest, të mësuarit e zemrës me dhikrin e Allahut, të qëndruarit zgjuar në agim, frekuentimi i bisedave fetare dhe përkujtimi i shpeshtë i vdekjes... Sepse përkujtimi i shpeshtë i vdekjes e pakëson dashurinë e kësaj bote.

Miqësia, shoqërimi dhe uniteti me gratë e devotshme është kusht... Sepse bisedat e njerëzve të mirë bazohen gjithmonë te mirësia. Ata gjithmonë flasin për Allahun (xh.xh.) dhe të Dërguarin e Tij, salallahu alejhi ve selem. Tregojnë për miqtë e Allahut, fjalët dhe kujtimet e tyre. Miqësimi me këta njerëz bëhet shkak për përfitimin nga gjendja e tyre.

Në të njëjtën mënyrë ka edhe pesë gjëra të tjera të cilat duhet të ndiqen për të edukuar nefsën: Të tregosh kujdes ndaj kufijve hallall-haram, të qëndrosh sa më larg gjërave të dyshuara, të hash pak, të flasësh pak...

Në ditët e sotme këtyre mund t'u shtojmë edhe “të shëtisësh pak”, sepse për fat të keq, në ditët e sotme, gratë, pasi përcjellin burrat dhe fëmijët, shëtisin jashtë nga mëngjesi, deri në mbrëmje. Në këtë mënyrë nuk gjejnë kohë për të zhvilluar veten dhe për t'u bashkuar me gratë e devotshme në bisedat që bëhen për hir të Allahut (xh.xh.).

Sa bukur këshillon Llukman Hakimi:

“Bëj kujdes ndaj asaj që fut në gojë dhe atyre që nxjerr nga goja... Dy gjëra harroji: Ligësinë që të kanë bërë dhe të mirën që ke bërë... Dhe mos harro dy gjëra: Përkujtimin e Allahut dhe vdekjen...”

I përkujtuam këto këshilla të vyera duke përfutuar nga ligjëratat e të ndjerit Musa Topbash. Allahu na mundësoftë që së pari t'i zbatojmë këto këshilla të arta te vetja jonë, pastaj te motrat tona që e lexojnë këtë material. Amin!



Si ta njohim më mirë njeriun me të cilin do të martohemi?

— Psig. Tylaj Kok —

Vajza, ju mund të pyesni veten: “Mos është e nevojshme që të kaloj më shumë kohë me njeriun me të cilin do të martohem, në mënyrë që ta njoh më mirë?” Mos harroni se nuk mund ta njihni një njeri duke u bazuar vetëm në mënyrën sesi silltet me ju. Njerëzit mund të ruhen kur janë me ju dhe të mos tregojnë karakterin e tyre të vërtetë. Për më tepër që një gjë e tillë mund të zgjasë me vite të tëra. Për këtë arsye, shpesh hasemi me çifte që kanë flirtuar për vite të tëra, kanë kaluar një fejesë të lumtur por që ndahen pas një periudhe të shkurtë martese. Nëse doni ta njihni më mirë njeriun me të cilin do të martoheni, vëzhgojeni me kujdes sesi silltet me njerëzit e tjerë dhe si vepron në ambiente të ndryshme.

Nëse një njeri është i paedukatë me nënën dhe babanë e vet, ashtu do të jetë edhe me bashkëshorten. Nuk mund të presësh drejtësi në jetën familjare nga një njeri që është i padrejtë në punë; kjo do të ishte vetëm një ëndërr e perealizueshme. Një njeri i pandjeshëm ndaj krijesave që ka përreth nuk mund të jetë i ndjeshëm ndaj shqetësimeve tona. Nëse lëmë pas dore sjelljet e njeriut në ambiente të ndryshme dhe ndaj njerëzve të ndryshëm, nuk do ta njohim atë mjaftueshëm.

- Si silltet në familje? A është i dashur me nënën, babanë dhe vëllezërit e motrat?
- A është i ndjeshëm ndaj gjallesave? Kur shikon një qen të uritur a ndjen dëshirën për ta ushqyer? A e respekton natyrën, pemët, lulet?
- Si silltet në punë? A bën thashetheme për kolegët e punës, a është i moralshëm dhe i drejtë, a punon në mënyrë që të meritojë rrogën që merr, a u bën padrejtësi të tjerëve?
- Si silltet me shoqërinë? A është njeri egoist dhe përfitues apo i besueshëm dhe i respektueshëm? A i ndihmon shokët pa prituri gjë në këmbim apo ka shoqëri me interes?
- A ka ndjenja të forta morale apo lufton vetëm për të mira materiale?

Nuk mjafton që të kalojmë një kohë të gjatë në shoqërinë e njeriut me të cilin do të martohemi, që ta njohim në atë mënyrë. Nëse bëjmë vëzhgimet dhe pyetjet e duhura, do ta njohim atë shumë lehtë.

Fejesa është parapërgatitje për martesë

Fejesa është koha që i jepet çiftit të ri për të bërë përgatitje për një jetë të përbashkët. Fejesa nuk duhet

shikuar si koha e njohjes mes dy palëve. Ajo është një pjesë e martesës. Ju fejojeni me njeriun me të cilin doni të martoheni dhe filloni të bëni planë për të ardhmen.

A është e nevojshme një fejesë e gjatë?

Një fejesë e zgjatur bëhet shkak për konsumimin e marrëdhënies, sepse çdo periudhë parapërgatitëse është stresuese. Njeriu kur është gati nuk ka përse të presë më gjatë. Sa ditë mund të rri në një shtëpi, sendet e së cilës i keni mbledhur dhe i keni futur në kutia? Sigurisht që dëshironi të shkoni sa më parë në banesën e re. Edhe periudha e fejesës është e ngjashme me këtë. Nëse i keni bërë të gjitha përgatitjet, nuk keni përse ta zgjasni më kot fejesën. Zgjatja e saj bëhet shkak për probleme në mes të çiftit i cili fillon të ngatërrohet edhe për gjëra krejt të vogla e të parëndësishme.

A jemi duke u martuar ne apo familjet tona?

Në momentin kur marrim vendimin për t'u martuar, duhet të kemi parasysh se ka shumë rëndësi që familjet e të dy palëve të mirëkuptohen me njëra-tjetrën. Mund të thoni: “Vajza është e mirë, por nëna e saj nuk durohet; djali është i mirë, por babai i tij nuk është njeri për së mbari.” Mos harroni se sjelljet e familjes tonë na duken normale. E thënë ndryshe, një vajzë me nënë të keqe i shikon veprimet e saj si normale dhe nuk i ka problem.

Para se të martoheni me një njeri që nuk ia pëlqeni familjen, mendohuni dhe njëherë. Një pikë tjetër e rëndësishme është edhe mendimi i familjeve për partnerin e fëmijës së tyre. Marrja e bekimit të dy familjeve respektive do të bëhet gur i fortë i themelimit të së ardhmes. Nëse kemi probleme me familjen e bashkëshortit, në rastin e krizës më të vogël nuk do të kemi askënd për të na përkrahur. Për më tepër që mungesa e mbështetjes nuk është asgjë përpara një armiqësie të mundshme e cila do të bëhet pengesë për zgjidhjen e problemit më të vogël. Mund të hapen diskutime të forta për një shkak krejt të parëndësishëm dhe mund të kthehen në kriza që sjellin divorcin.

Për të gjitha këto arsye, bashkëshortët duhet të kenë marrëdhënie të mira me familjen e vet dhe të bashkëshortit. Familjet duhen vizituar vazhdimisht dhe çifti duhet të ndajë kohë për to dhe duhet vrapuar në ndihmë në rastin e ndonjë problemi.



Bylmetet

të nevojshme

Konsumimi i deri tre porcioneve me prodhime bylmeti në ditë mund të jetë me përfitime për shëndetin. Ky është përfundimi i një studimi të kryer në Kanada. Studiuesit thonë se ky zbulim lidhet me nivelin e sëmundjeve kardiovaskulare. Por mjekët thonë se përfundimet e këtij studimi nuk e justifikojnë ndryshimin në masë të udhëzimeve të ushqyerjes, që këshillojnë pakësimin e bylmeteve me yndyrë të plotë.

Raporti i fundit lidhur me konsumimin e produkteve të bylmetit ndoqi mënyrën e ushqyerjes së 130 mijë njerëzve në 21 vende të botës, në mbi 5 kontinente, për një periudhë 9-vjeçare.

Një nga krahasimet kryesore të studimit ishte mes grupit të njerëzve që nuk konsumonin produkte bylmeti dhe atyre që konsumonin më tepër: deri në 3,2 porcione bylmeti në ditë. Doli se konsumatorët më të mëdhenj të bylmeteve ishin në Amerikën Veriore dhe në Europë, ku njerëzit konsumonin mbi katër porcione në ditë.

Sipas autorëve të studimit, një porcion normal bylmeti mund të jetë një gotë qumësh prej 244 militrash, një gotë kosi prej 244 militrash dhe një copë djathi prej 15 gramësh, ose një lugë e vogël gjalpë, prej 5 gramësh.

Ekipi i studjuesve të Universitetit McMaster arriti në përfundimin se grupi që konsumonte më tepër bylmet pati nivele më të ulëta të kolesterolit dhe prekej më pak nga ishemia cerebrale. Ky grup po ashtu kishte nivelin më të ulët të vdekshmërisë.

Studimi u përqendrua kryesisht tek njerëzit që nuk konsumojnë bylmet në dietën e tyre të përditshme:

Historia e yndyrave të saturuara ka filluar shumë kohë më parë: përfundimi ka qenë se produktet me nivel të lartë të tyre ngrënë nivelin e kolesterolit, që shkakton arteriosklerozën dhe kjo e fundit është përgjegjëse për sëmundjet koronare të zemrës; por

studimet e mëparshme nuk merrnin në konsideratë pasojat e yndyrave të saturuara tek komponentët e tjerë lipidë të gjakut, si dhe tek faktorët e tjerë të rrezikut.

Ky studim është në nivel vëzhgues, që do të thotë se studiuesit i nxorën konkluzionet të lidhura me faktorë të tjerë, pra ata nuk kanë hyrë në mekanizmat që sjellin këtë rezultat.

Sipas autorëve të Universitetit McMaster, ne harrojmë shumë nga komponentët e dobishëm që përmbajnë produktet e bylmetit. Në mesin e tyre janë amino acidet, vitaminat K1 dhe K2, si dhe kalçiumi, potasiumi dhe magnezi.

Është vërejtur se në mesin e personave që nuk konsumonin fare produkte bylmeti, rreziku i vdekshmërisë, apo i sëmundjeve kardiovaskulare, kryesisht ishemia cerebrale, vdekja nga sëmundjet kardiovaskulare dhe ato jo kardiovaskulare, është më i lartë.

Bazuar tek ky studim, njerëzit që konsumonin bylmet ishin 10 për qind më pak të rrezikuar nga shumica problemeve shëndetësore. Rreziku për ishemi cerebrale ishte 34 për qind më i vogël se tek personat që nuk konsumojnë bylmet. Por ajo shtoi se pjesëmarrësit në studim nuk konsumonin më tepër se tre porcione bylmeti të ditë.

Në kushtet kur flitet shumë për problemin e obezitetit, ky studim mund të shkaktojë konfuzion tek njerëzit. Por autorët thonë se ai nuk u bën thirrje njerëzve të konsumojnë në masë produkte me sasi të lartë yndyre, si djathi dhe gjalpi. Ata thonë se bylmetet janë një burim i rëndësishëm energjie, por kjo nuk do të thotë që njerëzit të konsumojnë shumë racione në ditë. Sipas studjuesve kanadezë, konsumimi me masë, i produkteve të bylmetit, është gjithmonë rruga që duhet ndjekur.

Vetitë shëruese të SHEGËS



Në fakt shega është një frutë e cila së bashku me ullirin; rrushin; fikun dhe hurmat janë ndër pemët e para të kultivuara në historinë e njerëzimit. Shkencëtarët mendojnë se pema e vogël e shegës me qëllim u mbjell së pari në Turqi dhe pjesët veriore të Iranit.

Shegat nuk janë vetëm të shëndetshme por edhe me veti simbolike!

DOMETHËNIA SIMBOLIKE

Shega përmendet në tre vende në Kuran, dy herë sikur dhurata nga Allahu azze ve xhel .

“Ai është që lëshoi nga lartë shiun e me të nxori bimën e çdo sendi dhe prej bimës gjelbërim dhe prej tij (prej gjelbërimit) kokrra të dendura në kallinj. E nga hurmet, nga sythat e tyre kalaveshë të afërt (për t'i vjelë). Edhe kopshte me hardhi, ullinj e shegë të ngjashme (në dukje) e të llojlojshme (në shije). Shikoni pra frutat e tyre kur i formojnë dhe kur piqen (të gjitha këto nga shiu). Edhe në këto ka fakte për njerëzit që besojnë.” (Kuran, 6:99)

“Ai (Allahu) është që krijoi kopshte (bimët e të cilave) të ngritura lart (në shtylla) dhe të rrafshëta (të shtrira në tokë), edhe hurmet dhe drithërat me frute (shije) të ndryshme; (krijoi) ullinj të gjelbra dhe shegë të ngjashme (nga forma) e jo të ngjashme (nga shija). Hani frutat e tyre kur të piqen dhe ditën e korris (të vjeljes) së frutave jepeni atë pjesë që është obligim (të varfërve e nevojtarëve) dhe (hani-jepni) mos teproni, pse Ai nuk i do shkapërderdhësit.” (Kuran, 6:141)

“Aty, në ata të dy, ka hurma dhe shegë” (Kuran, 55:68)

Ndoshta edhe nga ky fakt se përmendet tre herë në Kuran thuhet se ngrënia e vetëm tri shegëve brenda një viti mund të pengojë konjuktivitisin atë vit. Allahu xh.sh. e di më së miri.

PËRDORIMI NË SHËNDETËSI

Shega e pjekur është e nxehtë dhe e lagësht, i ndihmon fytit, mushkërive dhe bronkeve, vepron si lehtësues dhe qetësues i kollës dhe është i mirë për vrerin. Vepron si laksativ i lehtë, pengon kalbëzimin në lukth dhe është më e fuqishmja në mesin e kategorive të ngjashme të ushqimit si burim me vlera të shumta të substancave për tërë trupin. Shega tretet në lukth dhe thithet shpejt për shkak të temperamentit të saj të jashtë zakonshëm dhe të lehtë, e nxehtë lukthin ngadalë, i nxjerr jashtë gazrat e lukthit dhe e rrit sasinë e spermës, megjithatë shega nuk duhet të hahet kur njeriu ka temperaturë. Lëngu i shegës shuan etjen, rrit oreksin dhe i jep freski mendimit të njeriut për shkak të efektit pozitiv në sistemin nervor. Gjithashtu përdoret me sukses për heqjen e njollave dhe rrudhave të fytyrës.

Studimet e shumta kanë ardh në përfundim se lëngu i Shegës ka tre herë nivelin më të lartë të antioxidantëve se të rrushit të zi, çajit jeshil dhe se vera e kuqe. Përmban një sasi të lartë të përbërësve bioaktivë, flavonoide; anthocyane, thartirën phenol; polyphenole; të cilat kanë shumë rëndësi në rregullimin, ripërtirjen dhe zhvillimin e qelizave. Është edhe shumë e pasur me kalium, potas, hekur dhe Vitaminat A, C dhe E. Në lëvizshmëri dhe shegës ndodhet një substancë kurrëse që quhet Tanin e cila e shëron barkun. Gjatë studimeve më të reja janë ofruar të dhëna të reja se në lëngun e Shegës janë gjetur dobi të papritura deri më tash. E sidomos bën dobi të sëmundjet Kardiovaskulare – të zemrës, kanceri dhe artriti. Në veçanti janë Polyphenolet të cilat veprojnë si antioxidues, antinfektiv dhe antikarcinogjen dhe me anë të tyre arrihet mbrojtje kundër sëmundjeve të ndryshme. Gjatë përdorimit të shegës ose lëngut të shegës aktivizohen fuqitë autoimunitare të shërimit gjatë: infeksioneve, të kolesterolit të lartë në gjak, të shtypja e lartë e gjakut, të kanceri dhe të sëmundjet nervore .

Përbërësit që gjinden në shegë veprojnë në një mënyrë specifike në qelizat dhe organet e ndryshme. Disa qeliza ngadalësohen ose edhe eliminohen gjatë procesit të tyre, kurse te disa të tjera ndihmon të ripërtërihen dhe të mbrohen nga ndikimet negative.

Në studimet që vijuan në Qendrën e Zbulimeve në Haifa është zbuluar se lëngu i shegës zbërthen kolesterolin gati përgjysmë dhe kështu zvogëlon nivelin e kolesterolit në sëmndje (kolesterolina që i ngushton arteriet). Provat që janë bërë të minjtë vërtetuan se lëngu i shegëve ka zvogëluar në masë të madhe gëlqerëzimin e arterieve. Në gazetën e Shkollës të Kardiologëve është shkruar mbi studimet e ndikimit të lëngut të shegëve te pacientët me sëmundje ishemike të zemrës. 45 Persona testues kanë pirë mbi tre muaj për afërsisht 240 mililitër lëng të shegëve ose kanë marrë placebo. Gjatë matjes së qarkullimit të gjakut para dhe gjatë mundimeve fizike është vërtetuar se grupi që ka pirë lëngun e shegës kanë pas qarkullim më të lartë dhe efikas të gjakut. Dhe ashtu u vërtetua se një gotë e lëngut të shegëve në ditë e ndihmon dhe përshpejton qarkullimin e gjakut për një të tretën.

Përdorimi i ekstrakteve të shegës ndihmon edhe të sëmundjet koronare e krijuar nga stresi i lartë. Këtu është vërejtur gjatë studimeve vetëm pas tre muajve të përdorimit 17% qarkullim më i mirë i gjakut në muskulin e zemrës. Kurse numri i rasteve të Angina Pectoris është zvogëluar për 50 %.

Gjithashtu është vërtetuar se qelizat kancerogjene të kanceret e ndryshme, rriten shumë më ngadalë gjatë përdorimit të shegëve.

BLETËT FRYMËZIM PËR HULUMTUESIT E DRONËVE

Megjithë përparimet e mahnitshme në robotikë, makineritë e kanë të vështirë të arrijnë atë që është rutinë për insektet. Kështu që hulumtuesit e robotikës i janë përkushtuar eksperiencës miliarda vjeçare që ofron natyra. Ata po mësojnë nga bletët se si të ndërtojnë mjete fluturuese që mund të mësojnë dhe të drejtohen brenda mjedisit të tyre.

Truri i tyre mund të jetë i vockël por bletët mund të bëjnë shumë më tepër se dronët e sotëm, thotë shkencëtari Alex Deëar.

Bleta punëtore është në gjendje të dalë dhe të mësojë mjedisin, të gjejë lule, të mbledhë nektarin dhe të kthehet në fole. Pastaj këto të dhëna i komunikon tek bletët e tjera. Një dron me një kompjuter të fuqishëm që vetmësohet ka nevojë për bateri të fuqishme.

Nëse shtohet pesha, kontrolli bëhet më i vështirë, kërkon më shumë fuqi dhe kështu me radhë. Ideja është nëse mund të mësohet diçka nga bletët e mjalitit në veçanti, insektet në përgjithësi, në aspektin e energjisë efikase për kryer veprime autonome.

Projekti “Brains on Bord” studion trurin e insekteve dhe sjelljet e tyre, për përdorim si model tek dronët inteligjentë.

Për shembull, programuesit mund të mësojnë se si bletët orientoohen në mjedisin e tyre, thotë profesori Andy Philippides.

“Ato sillen rreth folesë gjë që i ndihmon të orientoohen në atë mjedis. Faza tjetër për ne është se si t’i përdorim këto të dhëna në dronët tanë për të strukturuar informacionin që vjen, që ta bëjmë sa më të lehtë procesin e vetmësimit dhe navigimit.”

Projekti ka mbledhur sëbashku biologë dhe ekspertë të teknologjisë kompjuterike dhe robotike.

Për momentin po studiohet bleta në shkallë të ndryshme. Përmes realitetit virtual po regjistrohem ato që ndodhin brenda neuroneve në një shkallë shumë të vogël.

Ekipi shpreson që brenda një viti do të ndërtojë një dron që fluturon në mënyrë autonome.



FORCA E RËNDESËS MUND TË JETË BURIM ENERGJIE TË RIPËRTËRITSHME

Në një botë që ka gjithmonë e më shumë nevojë për energji, shkencëtarët po studiojnë vazhdimisht të gjitha burimet e mundshme të ripërtëritshme, në përpjekje për identifikimin e rrugëve të rritjes së efikasitetit. Një studiues në Hollandë beson se edhe forca e rëndesës mund të përdoret për të prodhuar energji elektrike falas.

Disa materiale, si kristalet e kuarcit dhe disa qeramika, kur ekspozohen ndaj stresit mekanik prodhojnë sasi të vogla energjie. Ky efekt, që quhet piezo-efekt, përdoret në ndezësit e barbekyve për të krijuar shkëndijën që shkakton flakën.

Efekt mund të përdoret edhe për të krijuar sinjale zanore në bobinat fonike të kristalit dhe në mikrofonët me grimca kristali.

Por piezo-efekti funksionon vetëm kur forca e përdorur ndryshon nga presioni në çlirim. Nga ana tjetër forca e rëndesës është një forcë e vazhdueshme.

“Problemi me gravitetin është se vepron vetëm në një formë”.

Arkitekti hollandez, Janjaap Ruijssenaars e vuri re një gjë të tillë kur një shufër e gjatë vertikale

mbi një platformë të sheshtë, shtyhet duke humbur balancën, ka prirjen të luhet për një kohë të gjatë, duke ushtruar presion herë pas here në skajet e platformës.

Kjo shpikje, kjo paisje e energjisë nga forca e rëndesës realizon diçka të re. Pra kur graviteti shndërron në një forcë në ndryshim atëherë mund të prodhosh elektricitet.

Materiali piezoelektrik që vendoset mes platformës së luhatshme dhe terrenit të qëndrueshëm ekspozohet ndaj një presioni vazhdimisht në transformim, duke prodhuar elektricitet.

Me një ndërhyrje fare të lehtë, krijohet paqëndrueshmëri në sistem; rezultati diktohet nga forca e rëndesës.

Luhatja e shufrës mund të shkaktohet edhe kur ajri i nxehtë i krijuar nga një llambë, fillon të vërë në lëvizje një helikë të vogël.

Shkencëtarët thonë se i njëjti parim mund të përdoret në eksperimente me përmasa më të mëdha për të karikuar bateritë e makinave ose për të operuar gjeneratorë të pavarur energjie.

BOTA NË GARË PËR DOMINIM TEKNOLOGJIK

Ndërsa zhvillimet teknologjike po ecin me ritme të pashoqe, ekspertët thonë se bota po përjeton një revolucion të katërt industrial i cili do të nxitet nga inteligjenca artificiale dhe makinat që mund të analizojnë sasi të mëdha të dhënash nga pajisjet e kyçura në rrjet. Ekspertët gjithashtu paralajmërojnë se përveç të mirave, revolucioni mund t'i sjellë edhe dëme shoqërisë.

Inteligjenca artificiale, të dhënat e shumta dhe lidhja e pajisjeve fizike me botën dixhitale nëpërmjet internetit sjellin ndërlikime për vendet e pasura dhe ato në zhvillim.

Inteligjenca artificiale mund të zgjerohë hendekun, aq sa vendet e varfëra të mbeten shumë prapa. Gjithashtu është një shans që vendet e varfëra të kapërcejnë revolucionin industrial dhe të kompensojnë kohën e humbur.

Përfitimet e kësaj teknologjie do të shihen nëpër shumë industri.

“Mund të shpëtohen jetë dhe të identifikohen sëmundje. Mund të përdoren të dhënat nga stërviatja fizike për të zbuluar probleme shëndetësore shumë kohë para se të ndodhin.

Përkrah përfitimeve vijnë edhe reziqet nga një botë e ndërthurur. Ka shqetësime serioze për të cilat duhet të jemi të vetëdijshëm pasi ka lidhje me të gjitha të dhënat. Shumë janë të dhëna personale të identifikueshme, të dhëna ekonomike, shëndetësore apo gjenetike.

Inteligjenca artificiale po ashtu kërcënon vendet egzistuese të punës.

Në botën e korporatave po ato përballen me një zhdukje në masë. Që nga fillimi i shekullit, 52 përqind e kompanive më të mëdha janë zhdukur.

Në vend të tyre, kompani të modelit të ri si Uber dhe Airbnb janë shfaqur falë inteligjencës artificiale dhe të dhënave. Këto teknologji jo vetëm që po ndikojnë tek bota e korporatave, por mund të përbejnë kërcënim edhe për sigurinë kombëtare. Por mos ecja përpara mund të jetë po aq e rrezikshme. Për superfuqitë, revolucioni i ardhshëm do të jetë rreth garës për dominim teknologjik.





Aromë Trëndafili



KOPSHTI
“Aromë Trëndafili”!



**Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe i kontrolluar,
staf i kualifikuar, çmime të arsyeshme,
transporti është i garantuar.**

Ju mirëpresim!



1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR
(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË

I Gjithëmëshirshmi
ua ka mësuar Kuranin
(robërve të Tij),
ka krijuar njeriun
dhe i ka mësuar atij
të folurit e qartë.
Dielli dhe Hëna ndjekin
rrugën e caktuar,
Bimët dhe pemët
i përulen (Allahut).
Ai e ka ngritur
qiellin lart dhe
ka vënë Balancën
(për çdo gjë),
që ju të mos
e shkelni atë.

(Rrahman, 1-8)